

Biznes Start Qendra Tivar

Gratë që i lëvizin kufijtë

Shembuj të praktikave të mira në komunën e Tivarit

Prill, 2014.

Gratë që i lëvizin kufijtë
Shembuj të praktikave të mira në komunën e Tivarit

Botues:

Biznes Start Qendra Tivar (BSC Bar), Tivar, Mali i Zi

Autorë:

*Ivana Tomasheviq
Vesna Antuniqeviq
Sasha Jovanoviq*

Përkthyes:

Sabra Deceviq

Lektore:

Suzana Bulatoviq

Dizajn dhe grafikë:

Bojana Radoviq, OJQ SIT

Shtypi:

3M Makarije, Podgorica


Tirazhi:

300

Biznes Start Qendra Tivar

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e publikimit mund lirisht të shfrytëzohet dhe shumëzohet për qëllime jo komerciale, me kusht që çdo riprodhim i tillë të jetë i shoqëruar nga një tregues se burimi i të dhënave është BSQ Tivar.

Mendimet, përfundimet, konkluzionet dhe rekomandimet të paraqitura këtu i përkasin autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet dhe opinionin e Ambasadës së SHBA-së në Podgoricë.



Biznes Start Qendra Tivar

GRATË QË I LËVIZIN KUFIJTË

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA NË
KOMUNËN E TIVARIT

Prill, 2014.

GRATË QË LËVIZIN KUFIJTË

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA NË KOMUNËN E TIVARIT

Të dashur lexues dhe lexuese,

*Ju paraqesim publikimin „Gratë që i lëvizin kufijtë“ të cilin **Biznes Start Qendra - Tivar (BSC Bar)** e ka përgatitur në bashkëpunim me **Komunën e Tivarit dhe Ministrinë për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave në Mal të Zi.***

Qëllimi i këtij publikimi është të paraqesim gratë që me aktivitetet e tyre lëvizin kufijtë në sferën shoqëro-politike, kulturoro-arsimore dhe ekonomike, në komunën tonë. Me vetë aktivizmin e tyre dhe angazhimin profesional, këto gra kanë kontribuar zhvillimin e komunitetit lokal, duke lëvizur kufijtë e të kuptuarit tradicional të punëve të „meshkujve“ dhe „femrave“. Përmes rrëfimeve mbi eksperiencën e tyre, mënyrën se si kanë arritur të afirmohen në punë dhe arritjes së pavarësisë ekonomike; përmes rrëfimeve se si janë ballafaquar me barrierat dhe paragjykimet shoqërore, dëshirojmë të frymëzojmë edhe gratë e tjera që të jenë më aktive. Duhet theksuar që për zhvillimin e shoqërisë është shumë e rëndësishme pjesëmarrja aktive e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. Kemi vendosur të përpilojmë këtë publikim për shkak që hulumtimet e ndryshme tregojnë që gratë më së shumti motivohen dhe inspirohen nga shembuj të mirë nga jeta e përditshme e grave. Gjetja e inspirimit në komunitet lokal, në eksperiencën e grave me kulturë dhe moshë të ngjashme, të cilat rrjedhin nga mjediset e ngjashme, do të kontribuojë në rritjen e motivimit të grave, në të menduarit mbi ndryshimet për më mirë dhe zgjerimin e horizonteve të tyre. Shpresojmë që me këtë publikim si dhe me aktivitetet e projektit, do të *frymëzojmë gratë të jenë më aktive në fushën politike e veçanërisht në atë ekonomike*, që do të ndikonte dhe në zhvillimin e komunitetit lokal.

Gjatë përpilimit të këtij publikimi BSQ Tivar (BSC Bar)ka zhvilluar intervista me gra që janë anëtare të dalluara të komunitetit lokal, qoftë si artiste të afirmuara, sipërmarrëse, politikane, mjeke, fermere, sportiste, etj. Gjatë intervistave kemi

kërkuar të na paraqesin eksperiencën, barrierat dhe paragjykimet me të cilat janë ballafaquar, mënyrën e tejkalimit të tyre, si dhe të japin rekomandime për gratë që dëshirojnë të merren me profesione të njëjta apo të ngjashme me profesionin e tyre. BSC Tivar (BSC Bar) ka kontaktuar mbi 50 gra të suksesshme nga komuna jonë, nga të cilat 28 kanë pranuar të marrin pjesë në projektin tonë dhe të rrëfejnë mbi suksesin e tyre. Me këtë rast dëshirojmë të falënderojmë të gjitha gratë që pranuan të ndajnë eksperiencën dhe fshehtësinë e suksesit të tyre, si dhe të marrin pjesë në përpilimin dhe promovimin e këtij publikimi.

Me respekt,

Ivana Tomasheviq
Drejtoreshë e Biznes Start Qendrës – Tivar (BSC BAR)

Përmbajtja

HYRJE.....	9
Vendosja e barazisë gjinore në Mal të Zi	11
Gjendja e barazisë gjinore në Komunën e Tivarit	15
Gratë dhe veprimtaritë ekonomike	17
Fuqizimi ekonomik i grave në Komunën e Tivarit	20
Gratë dhe zhvillimi shoqëror	22
Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë	22
Barrierat me të cilat ballafaqohen gratë	23
Shembuj të praktikës së mirë	24
POLITIKA DHE VENDIMMARRJA	25
Formula e suksesit është që njeriu të zgjedh të punojë atë çfarë do	27
Pjesëmarrja në zhvillimin shoqëror të komunitetit lokal është obligim i çdo njeriu qëllimshëm	30
Me një organizim të mirë çdo gjë mund të arrihet	32
Vazhdimisht investoni në dijeninë tuaj	34
Me shembullin tuaj motivoni njerëzit përreth	36
ARSIMI	39
Me profesion kundër stereotipeve	41
Me dashuri të sinqertë ndaj profesionit dhe me përkushtim, do të arrini drejt suksesit	43
Sekreti i suksesit është në punën vetëmohuese	45
Jetoni (me) zanatin tuaj!	47
SHËNDETËSIA	49
Në jetë dhe në punë çdo gjë duhet punuar në mënyrën më të mirë që mundemi	51
Profesioni si dhe jeta juaj le të kenë një mision të qartë	53
Mos iu druani sfidave	55
Sekreti i suksesit është në komunikimin e suksesshëm me njerëzit që ju rrethojnë	57

KULTURA, MEDIAT DHE SPORTI	59
Ndiqni ëndrrat tuaja dhe këmbëngulni në realizimin e tyre	61
Ndiqni talentin tuaj	63
Në „shkallën muzikore të suksesit“ ekzistojnë pengesa, por nuk janë të pakapërcyeshme kur keni një vendim të qartë për profesionin tuaj	65
Me hapa të lehtë por të sigurt, ecni drejt qëllimit	67
Lidhni të bukurën dhe të dobishmen	69
Bëni praktikë të mirë duke qenë vullnetarë - vetëm kështu do të kuptoni se çfarë ju pret në punë	71
Thyeni barrierat	73
 EKONOMIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	 75
Lëvizni kufijtë e mundësive tuaja	77
Edhe hobi i juaj mund të shndërrohet në biznes të suksesshëm - bëhuni të guximshme dhe tregoni se çfarë mundeni	79
Forcë lëvizëse ndodhet tek ne	81
Sekreti i vogël i suksesit të madh/premtori më pak dhe jepni më shumë	83
Besoni në veten tuaj dhe asgjë nuk mund t'ju demoralizojë	86
Fuqia është në biznesin familjar	88
Nga blegtoria mund të jetohej	90
Jini aktive në shoqëri dhe ndihmoni familjen tuaj dhe komunitetin lokal	92

HYRJE

Biznes Start Qendra - Tivar (BSC Bar) në bashkëpunim me ***Komunën e Tivarit dhe Ministrinë për të drejtat e njeriut dhe pakicave në Mal të Zi***, në vitin 2013 filloi implementimin e projektit „Gratë e fuqizuara -shoqëria më e pasur“. Projekti u financua nga donacioni i Ambasadës së SHBA-së në Mal të Zi. Qëllimi i projektit është kontributi i fuqizimit të grave në aspektin politik dhe ekonomik në Komunën e Tivarit që të bëhen anëtare më aktive të jetës shoqërore në komunitetin lokal. Theks i veçantë është vendosur në fuqizimin e grave nga rajonet rurale të Tivarit (Ostros dhe Virpazar). Sipas kësaj realizohen aktivitete të ndryshme në sferën e fuqizimit të grave siç janë: edukime për fuqizim politik të grave, trajnime mbi aftësitë e biznesit, puntori praktike, organizimi i forumeve dhe panairë ndërmarrësish.

Aktiviteti i veçantë i projektit të cekur është dhe përpilimi i publikimit „***Gratë që lëvizin kufijtë***“, i cila paraqet gratë e suksesshme në territorin e Komunës së Tivarit, eksperiencën dhe rekomandimet e tyre. Publikimi përbëhet nga tri pjesë: **Në pjesën e parë** është shfaqur gjendja në Mal të Zi, veçanërisht në Tivar sa i përket statistikës së barazisë gjinore. Janë paraqitur dhe mekanizmat institucionale për mbështetjen e barazisë gjinore, si dhe strategji të rëndësishme dhe dokumentet e tjera të programit që u aprovuan në Komunën e Tivarit. **Në pjesën e dytë të publikimit** vëmendja është kushtuar fuqizimit politik dhe ekonomik të grave, dmth. nevojave, strategjive dhe programeve mbështetëse. Është theksuar rëndësia e pjesëmarrjes së grave në zhvillimin e shoqërisë nga aspekti i komunitetit lokal dhe i gjithë shoqërisë së një vendi. Janë paraqitur karakteristikat e grave dhe dallimet në krahasim me meshkujt, pastaj stereotipet që lidhen me profesionet e grave, barrierat me të cilat gratë ndeshen.

Në pjesën e tretë të publikimit janë paraqitur shembuj të praktikës së mirë – gratë që arritën të lëvizin kufijtë e kuptimit tradicional mbi punët dhe angazhimet e „meshkujve“ apo „grave“. Kjo pjesë e publikimit është ndarë në fusha sipas Planit lokal të veprimit mbi barazinë gjinore në Komunën e Tivarit, e ato janë: politika dhe vendimmarrja, arsimi, shëndetësia, kultura, mediat dhe sporti, ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Kjo lloj ndarjeje është bërë me qëllim që të shfaqen shembuj të praktikës së mirë në të gjithë sferat e jetës shoqërore, ekonomike dhe politike të komunitetit lokal.

Në përpilimin e publikimit morën pjesë një numër i konsiderueshëm i grave të suksesshme dhe aktive në Komunën e Tivarit të cilat ndanë eksperiencën e tyre, me tregime të shkurtra që i drejtohen grave të cilat dëshirojnë të merren me profesione të njëjta apo të ngjashme. Gjatë bisedave me gra jemi përpjekur të fitojmë informata se si kanë vendosur të merren me profesionin e tyre, çfarë i ka motivuar, cilat

barriera konkretisht kanë hasur në rrugën e tyre drejt suksesit. Ishte e rëndësishme të shihej se a kishin mbështetje të shoqërisë dhe familjes në këtë rrugë të suksesit. Pjesëmarrëset kanë ndarë me neve dhe tregime të shkurtra mbi paragjykimet që kanë takuar gjatë punës së tyre e që kanë lidhje me përkatësinë e tyre gjinore, por edhe për mënyrat se si kanë luftuar për pozitën e tyre në shoqëri. Nga bollëku i informacioneve të tjera që fitojmë nga komuniteti, shpesh mbet i lënë pas dore kontributi që ato gra kanë dhënë për komunitetin lokal të Tivarit. Me këtë rast kemi prezantuar eksperiencën e tyre dhe si ato me punën dhe angazhimin e tyre kanë ndikuar që shoqëria të orientohet drejt ndryshimeve dhe arritjes së barazisë gjinore në të gjitha nivelet.

Vendosja e barazisë gjinore në Mal të Zi

Vendosja e barazisë gjinore është një ndër qëllimet dhe prioritetet kryesorë të zhvillimit të çdo shoqërie moderne, poashtu edhe asaj malazeze. Sipas qëllimeve të politikës shtetërore mbi nxitjen e barazisë gjinore 2013-2017, afrimi tek koncepti i shoqërisë gjinore egalitare, në masë të madhe do të përcaktojë dinamikën e zhvillimit të shoqërisë në Mal të Zi, por edhe parakushtet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Vendosja e barazisë gjinore është njëri ndër objektivat dhe prioritetet kryesore të zhvillimit të secilës shoqëri bashkëkohore, pra edhe të asaj në Malin e Zi. Në mënyrë që të shfuqizohet diskriminimi gjinor, përkatësisht që afrimi drejt barazisë gjinore të realizohet sa më suksesshëm, viteve të fundit kanë filluar masa institucionale dhe ligjore, të cilat synojnë arritjen e anëtarësimit të plotë të Malit të Zi në BE, në harmoni me vlerat dhe aspiratat e demokracisë moderne evropiane e cila nënkupton barazinë e grave dhe meshkujve si njërën ndër vlerat themelore të të gjithë anëtarëve të komunitetit. Në mënyrë që t'i afrohet me sukses këtyre qëllimeve, Mali i Zi ka futur një sërë mekanizmesh të reja institucionale që duhet të lehtësojnë realizimin e objektivave të barazisë gjinore. Institucionalisht janë vendosur edhe mekanizmat e monitorimit, të zhvillimit dhe rregullimit të çështjeve të jo/barazisë gjinore. Kjo më së shumti i referohet themelimit të **Komitetit Parlamentar për Barazi Gjinore**, i cila është themeluar në vitin 2000 dhe **Zyrës për barazi gjinore** e cila u themelua më 27 mars 2003. Aprovimi i Kushtetutës¹ dhe Ligjit mbi barazinë gjinore² hapen mundësi të reja për intervenime në këtë lëmi në dy nivele: monitorimi i zbatimit të vetë Ligjit mbi Barazinë gjinore dhe aplikimi në të gjitha sferat ku legjislacioni e lejon këtë dhe nga ana tjetër - ndryshimi në legjislacionin përkatës nga fusha e punës dhe përshtatja me Kushtetutën dhe këtë ligj.

Kushtetuta e Malit të Zi qartë e trajton çështjen e diskriminimit: "Ndalohet çdo diskriminim i tërthortë apo i drejtpërdrejt, në çfarëdo rasti. Nuk do të konsiderohet si diskriminim legjislacioni dhe futja e masave të posaçme që synojnë krijimin e kushteve për realizimin e barazisë nacionale, gjinore dhe asaj të përgjithshme si dhe mbrojtja e personave që për çfarëdo arsye gjenden në pozitë të pabarabartë. Masa të veçanta mund të zbatohen vetëm derisa të realizohen objektivat për shkak të të cilave janë ndërmarrë këto masa."

Gjithashtu, Mali i Zi është nënshkrues i dokumenteve ndërkombëtare që e obligojnë të mbrojtë dhe zbatojë të drejtat e njeriut, pra edhe barazinë gjinore, siç është Konventa e OKB-së mbi eliminimin e çdo lloj diskriminimi ndaj grave (CEDAW), e cili iu dorëzua Komitetit për CEDAW në maj të vitit 2010. Konventa CEDAW në nenin 1 e definon diskriminimin e grave si "çdo diferencë, ç'kyçje apo kufizim të bërë në bazë të gjinisë, që ka si pasojë apo qëllim që grave t'u dëmtojë apo zhvlerësojë meritën, kënaqësinë apo shfrytëzimin e të drejtave njerëzore dhe liritë themelore në fushën po-

1 Kushtetuta e Malit të Zi, e aprovuar në mbledhjen e tretë, të sesionit të dytë të regullt, në v. 2007.

2 Ligji mbi barazinë gjinore e aprovuar në mbledhjen e Kuvendit, (korrik 2007), ka hyrë në fuqi me 8 gusht 2007 (Fl.Z. 46/07).

litike, ekonomike, sociale, kulturore, civile apo ndonjë fushë tjetër, pa marrë parasysh statusin e tyre martesorë, në bazë të barazisë së meshkujve dhe femrave. Gjithashtu edhe në Mal të Zi janë ndryshuar mekanizmat për barazi gjinore. Zyra për barazi gjinore, e cila ka funksionuar brenda Sekretariatit Gjeneral të Qeverisë, nga 1 Maji 2009 shndërrohet në Njësi speciale përgjegjës për punët e barazisë gjinore në Ministrinë e të drejtave të njeriut dhe pakicave, me ç' rast fiton fuqi më të mëdha politike që të ndikojë në krijimin e politikave zyrtare dhe zgjidhjeve legjislative. Në mbledhjen e shtatë të Qeverisë së Malit të Zi të mbajtur më 24 janar të vitit 2013, u miratua Plani i aktiviteteve për arritjen e barazisë gjinore 2013-2017.

Sot në Mal të Zi politika e barazisë gjinore ka karakter evropian. Ajo së pari njihet përmes Ligjit mbi barazinë gjinore, pastaj mekanizmat institucionale për zbatimin e politikës së lartpërmendur. Ligji paraqet një garanci të shmangies së të gjitha formave të diskriminimit me bazë gjinore, në formën në të cilën të drejtat e barabarta ende nuk nënkuptojnë edhe mundësi të barabarta për t'u realizuar; përfshinë elemente të politikës së mundësive të barabarta dhe nga kjo nxirren mekanizmat e mbrojtjes dhe të mbështetjes. Pra bëhet fjalë për të ashtuquajturin diskriminim pozitiv, përkatësisht veprim afirmativ të orientuar kah stimulimi i rritjes së numrit të grave dhe përparimit të tyre në sferën e punësimit dhe politikës e që në këtë rast do të thotë që gjatë emërimit të trupave të qeverisë shtetërorë, të pushtetit vendor dhe të autoriteteve të tjera publike, kufizon praninë e një gjinie në të paktën 30%.

Ligji mbi barazinë gjinore parasheh obligimet e Qeverisë dhe Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe pakicave. Qeveria harton një plan veprimi dhe programe për zbatimin e planit (çdo 4 vite), derisa obligimet e Ministrisë janë: të koordinoj aktivitetet, të përcjell zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare, të organizoj hulumtime dhe analizën e situatës, të raportoj mbi implementimin e obligimeve ndërkombëtare, të përgatisë Planin e aktiviteteve, të përgatisë programe mbi implementimin e këtij Plani, të bashkëpunoj me qeverinë lokale, me sektorin civil. Kësi strukture të mekanizmave në të gjitha nivelet dhe koordinimi i cili lidh veprimet e tyre me rrjetin e organizatave të grave (mbështetur në legjislacionin ekzistues), paraqesin parakushte solide për zgjidhjen e të gjitha formave të pabarazisë gjinore në shoqëri.

Shumë lehtë kishim nxjerrë përfundimin që një politikë e tillë dëshmon për shoqërinë në Mal të Zi si një shoqëri kryesisht moderne. Por megjithatë, duket që kujdesi sistemor mbi barazinë gjinore, ngajshëm si edhe në vendet e tjera postsocialiste, është një deklaratë më pak reale e nivelit të pritur të mbështetjes së vlerave moderne të shoqërisë, në mes cilave gjendet edhe barazia gjinore. Praktika e jetës së përditshme është ende në mospërputhje me përkatësitë politike. Gjegjësisht, hulumtimet e zbatuara në Evropën juglindore dhe në Mal të Zi, që merren me çështjet e barazisë gjinore (harmonizimin e amësisë dhe profesionit, ndarjen gjinore të punës në shtëpi, ndikimin e kalimit në modernizimin e roleve të grave në familje dhe shoqëri, tregun e punës dhe ndarjes gjinore të punës, seksizmit tradicionalë dhe modern, lidhjen midis seksizmit dhe religjionit, stereotipeve gjinore në arsim, etj), kanë treguar aspekte të ndryshme të diskriminimit gjinor në shoqëri në Mal të Zi.

Përbërja e tanishme e Kuvendit të Malit të Zi, ka shënuar një rekord kur është fjala për përfaqësimin e grave në 20 vitet e fundit, edhe pse vetë mund të karakterizohet si shumë i ulët.

Tabela nr. 1 – Përbërja e Kuvendit të Malit të Zi në v. 2012.

	Totali	Femra	Meshkuj	% e femrave	% e meshkujve
Përbërja e Kuvendit	81	11	70	13.6	86.4
Kryetari i Kuvendit	1	0	1	0	100
Nënkryetar/e e Kuvendit	2	0	2	0	100

Edhe pse Mali i Zi këtë vit ka futur në ligjet zgjedhore kuotën për gra, gjendet në vend të fundit në Evropë sa i përket numrit të grave në Parlament dhe në pushtetin ekzekutiv.

Numri i grave deputete në përbërjen e re të Parlamentit është shumë më i ulët nga kërkesat e standardeve ndërkombëtare: nga gjithsej 81 deputetë, 11 janë gra, që përbën 13.6%. Kjo përqindje paraqet ndryshim të konsiderueshëm të strukturës gjinore të Kuvendit të Malit të Zi, duke e krahasuar me përbërjen pas zgjedhjeve të para të lira parlamentare të mbajtura në vitin 1990, kur nga gjithsej 125 deputetë u zgjodhën 6 gra e që ishte 4,80%. Nuk mund të flitet për mosinteresimin e grave por për rezistencën e grave ndaj mekanizmave tashmë të qëndrueshëm politik të vepimit, të krijuara si strukture e fortë e meshkujve, me çrast gratë ballafaqohen me një mori pengesash në përpjekje për t'u marrë me politikë.

Sot në demokracinë parlamentare është evidente përcaktimi për paritet të grave dhe meshkujve, si parakusht i demokracisë së vërtetë. Nga ana tjetër, treguesit flasin që kjo gjë nuk është aspak e lehtë të arrihet, madje edhe kur ekziston konsensusi shoqëror.

Kur bëhet fjalë për Malin e Zi, mund të themi që falë qëndrueshmërisë së një pjese të shoqërisë të prirur kah vlerat më moderne shoqërore, sektorit civil dhe ndikimit të Evropës në krijimin e politikave të barazisë gjinore, shteti ynë ka zgjedhur rrugën demokratike të zgjidhjes së barazisë së grave dhe meshkujve. Gjatë vitit 2012 ishte i dukshëm ndryshimi i numrit të përgjithshëm të gjendjes së grave në procesin e emërtimit në ndonjë pozitë në nivelin republikan.

Është me rëndësi të ceket që përfaqësimi më i madh i përgjithshëm i grave në Qeveri, ka kontribuar që gratë të kryejnë sipas hierarkisë më shumë funksione ekzekutive. Kështu që gratë dukshëm përfaqësohen në pozitat e ndihmësve dhe atë ndër ndihmëse të ministrave me 41% dhe ndihmëse te drejtorëve me 44,8%.

Tabela nr. 2 - Struktura e Qeverisë së Malit të Zi, viti 2012

	Total	Femra	Meshkuj	Femra %	Meshkuj %
Kryeministri	1	0	1	0	100
Zëvendës-president	2	0	2	0	100
Ministër/Ministre	17	2	15	11.8	88.2
Ndihmës/se ministri	61	25	36	41.00	59.00
Sekretariati Gjeneral	2	3	5	60	40
TOTAL	86	30	56	34,90	65,10

Në organet punuese parlamentare ka vetëm 15.4% të femrave. Gratë përbëjnë shumicën në Këshillin për barazi gjinore (63.6%), derisa në organet e tjera punuese janë të përfaqësuar në përqindje dukshëm më të ulët (mes 12.5% dhe 20%). Këshillet dominante “mashkullore” janë Këshilli për siguri dhe mbrojtje, Këshilli për ekonomi, financa dhe buxhet dhe Këshilli Administrativ i Parlamentit ku nga 13 anëtarë asnjë nuk është femër.

Tabela Nr. 3 – Organet e punës së Kuvendit të Malit të Zi

	Total	Femra	Meshkuj	Femra %	Meshkuj %
Këshilli për çështje kushtetuese dhe legjislacion	13	2	11	15.14	84.60
Këshilli për sistem politik, gjyqësorë dhe administrim	13	2	11	15.14	84.60
Këshilli për siguri dhe mbrojtje	13	0	13	0.00	100.00
Këshilli për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritim Evropiane	15	2	13	13.30	86.70
Këshilli për ekonomi, financa dhe buxhet	13	0	13	0.00	100.00
Këshilli për të drejtat dhe liritë e njeriut	11	2	9	18.20	81.80
Këshilli për barazi gjinore	11	7	4	63.60	36.40
Këshilli për turizëm, ekologji dhe planifikim hapësinorë	13	2	11	15.40	84.60
Këshilli për arsim, kulturë, shkencë dhe sport	10	2	8	20.00	80.00
Këshilli për punë, shëndet dhe mirëqenie sociale	10	2	8	20.00	80.00
Këshilli Administrativ i Parlamentit	13	0	13	0.00	100.00
Këshilli për monitorim dhe përcjellje të veprimeve të privatizimit	8	1	7	12.50	87.50
TOTAL	143	22	121	15.40	84.60

Gjendja e barazisë gjinore në Komunën e Tivarit

Në pjesën më lart kemi paraqitur kornizën e barazisë gjinore, ilustruar nga shembuj praktik se deri ku ka arritur shoqëria e Malit të Zi në fushën e vendosjes së barazisë gjinore. Atë çfarë kemi mundur të vërejmë është që, praktika tregon devijim në krahasim me të planifikuarën, çfarë konfirmon që problemi nuk mund të zgjidhet thjesht dhe shpejt. Krahas pranimi formal, madje edhe avancimit të barazisë pa marrë parasysh gjininë, marrëdhënia ndaj grave në shoqëri ndjek logjikën e cila mund të njihet si tregues i zhvillimit të vetëdijes së individit në drejtim të respektimit të vlerave sociale tradicionale ose moderne. Në nivel të politikës akoma nuk janë arritur rezultatet e këndshme, por mund të vërejmë ndryshime pozitive.

Është me rëndësi të ceket që ndryshimet nuk ndodhin në të gjitha segmentet e shoqërisë me intensitet dhe shpejtësi të barabartë. Kjo veçmas vërehet tek niveli lokal, ku pjesëmarrja e grave në kuvendet komunale është zakonisht më e vogël, ndryshe nga vendet e Evropës ku zakonisht është më e lartë se mesatarja kombëtare.

Mesatarisht në nivelin e Malit të Zi, gratë përbëjnë 12.7% anëtarë të këshilltarëve në kuvendet e komunave. Numri më i madh i anëtarëve të kuvendit komunal është në komunën e Tivatit dhe Budvës (21.8%), derisa në komunën e Andrijeviçës gratë paraqesin 3.2% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të parlamentit lokal. Situata e ngjashme vërehet edhe tek pozitat vendimmarrëse në njësitë e qeverisë lokale: nga 21 komuna, vetëm në Kotor gruaja kryen funksionin e kryetares së komunës, derisa funksionin e nënkryetares së komunës e kryejnë gratë në komunën e Herceg Novit dhe Cetinës.

Tabela nr. 4 – Këshilltarët sipas gjinisë, nëpër komuna

Komuna	Këshilltarët			%	
	meshkuj	femra	total	meshkuj	femra
Tivat	25	7	32	78,20	21,80
Mojkovac	27	4	31	87,10	12,90
Pluzhine	27	4	31	87,10	12,90
Ulqin	31	2	33	93,90	6,10
Plavë	29	3	32	90,60	9,40
Herceg Novi	28	7	35	80,00	20,00
Cetinë	29	9	38	76,32	23,68

Plevle	33	2	35	94,30	5,70
Andrijevicë	30	1	31	96,80	3,20
Zhablak	25	6	31	80,70	19,30
Nikshiq	37	4	41	90,30	9,70
Berane	33	2	35	94,30	5,70
Danillovgrad	27	6	33	81,90	18,10
Rozhajë	30	3	33	91,00	9,00
Bijello Pole	34	4	38	89,50	10,50
Kollashin	25	6	31	80,70	19,30
Tivar	31	5	36	86,20	13,80
Budve	25	7	32	78,20	21,80
Kotorr	26	7	33	78,80	21,20
Podgoricë	47	8	55	85,50	14,50
Total	632	97	729	86,69	13,31

Siç shihet nga tabela për Komunën e Tivarit, është evidente që përfaqësia e grave në përqindje është diçka më e madhe se mesatarja në Mal të Zi. Vetë fakti që kryetarja e Kuvendit dhe Sekretarja e Komunës së Tivarit janë gra, tregon se gradualisht është duke u eliminuar dhe zvogëluar diskriminimi gjinor në Komunën e Tivarit. Gjithashtu, me rëndësi të përmendet është dhe fakti që në vitin 2013 në administratë të komunës janë të punësuar 288 persona (bashkë me sekretarët e bashkësive lokale). Nga ky numër 133 janë gra, dmth 46,18% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, ndërsa 509 persona janë të punësuar në ndërmarrjet publike (në vitin 2011). Duke vëzhguar të dhënat e 5 viteve të fundit, vërehet tendencë rritjeje në punësimin e femrave në institucionet publike dhe sociale.

Të gjitha partitë në parlamentit lokal janë nënshkruese të Deklaratës për barazi gjinore që nga viti 2006, megjithatë nga pikëpamja e relacionit ndaj barazisë gjinore akoma nuk janë realizuar ndryshime të rëndësishme në strukturat e tyre:


- - asnjë parti nuk ka 30% të femrave përfaqësuese të parlamentit
- pjesa më e madhe e anëtarëve të organeve më të larta partiake përbëhet nga meshkujt

Implementimi i Objektivave Zhvillimore të Mileniumit në Mal të Zi, në kuadër të Objektivit të tretë (Avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i pozitës së grave), si detyrë e veçantë parashikohet rritja e pjesëmarrjes së grave në organet e zgjedhura të qeverisë në nivelin lokal dhe shtetëror për 30%, deri në vitin 2015.

Gratë dhe veprimtaria ekonomike

Në shoqëritë e zhvilluara, gratë janë në një numër më të madh të përfaqësuara në pozitat udhëheqëse në kompanitë, në krahasim me shoqëritë më pak të zhvilluara. Megjithatë, ende janë pak të përfaqësuara në krahasim me meshkujt. Në SHBA 38% e gjithë kompanive janë në pronësi të grave, në Gjermani 31%, Kinë 25%, Japoni 23%. Gjendja në shtetet e zhvilluara të botës ndryshon, por mund të konstatohet që në Evropë 1/3 e kompanive janë në pronësi të grave, derisa tek neve gratë janë pronare të vetëm 9.6% të kompanive.

Grafikoni nr.1 - Përqindja e pjesëmarrjes së grave në pronësi ndaj bizneseve në disa vende³



Në aspektin historik pjesëmarrja e grave në rrjedhat shoqëro-ekonomike gjithmonë ka qenë në mënyrë të konsiderueshme më e ulët në krahasim me pjesëmarrjen e meshkujve. Fuqizimi ekonomik i grave dhe përfitimet që rrjedhin nga kjo, kanë rëndësi të madhe jo vetëm nga aspekti i të drejtave të femrave dhe arritjes së rezultateve të barazisë gjinore, por edhe nga aspekti i rritjes ekonomike dhe produktivitetit. Prandaj në kohën e fundit krijohen politika të ndryshme në nivelin nacional dhe global të cilët me qëllime dhe masa të veçanta planifikojnë fuqizimin ekonomik të grave dhe participimin më të madh të grave në rrjedhat ekonomike dhe politike. Në Mal të Zi politikat nacionale, politikat lokale dhe planet e veprimit si dhe Ligji mbi barazinë gjinore, gjithnjë e më shumë e theksojnë rëndësinë e barazisë së grave dhe meshkujve në fushën e vendimmarrjes dhe participimin në rrjedhat shoqërore e në ato ekonomike. Përveç kësaj, në nivelin global, objektivi i tretë i Mileniumit i referohet barazisë gjinore dhe


³ Gratë si ndërmarrëse në Mal të Zi, Ipsos Strategic Marketing, Podgoricë, dhjetor 2011, fq. 4..

fuqizimin e grave e me këtë lidhen indikatorët që i referohen arsimit, punësimit dhe vendimmarrjes. Pastaj, me Strategjinë e Lisbonës⁴, shtetet nënshkruese janë obliguar të rrisin pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës, ndërsa në Strategjinë për barazi të grave dhe meshkujve nga viti 2010-2015⁵ theksohet që për arritjen e objektivave të strategjisë Evropa 2020⁶, gjegjësisht për një zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe inkluziv, nevojitet shfrytëzimi më efikas i potencialeve dhe talenteve të femrave. Të gjitha këto politika dhe objektiva të vendosura justifikohen me faktin që pjesëmarrja e grave në vendim-marrje në jetën shoqëro-ekonomike dhe menaxhimin e biznesit të vet paraqet njërin ndër indikatorët e shoqërisë së zhvilluar moderne.

Kur bëhet fjalë për praktikën, sipas hulumtimeve të ndërmarrëseve në Mal të Zi, mund të konstatohet që bëhet fjalë për fazën e hershme të zhvillimit të ndërmarrësisë dhe që në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me ndërmarrësi për të shkak të nevojës. Dmth, bëhet fjalë për hyrjen në biznes jo për arsye të realizimit të biznes-idesë dhe të një projekti inovativ dhe jo në moshën e re (pas mbarimit të shkollës dhe studimeve), por në moshën më madhore, për arsye të vetë-punësimit dhe sigurimit të ekzistencës për familje (për shkak të mbetjes pa punë, alternativave nga pakënaqësia me vendin e punës, etj. Edhe pse sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 në Mal të Zi kishte më shumë femra se meshkuj, në udhëheqjen e biznesit të vet ka vetëm 9.6%, në pamundësi të kontrollimit të gjendjes reale, sepse jemi dëshmitarë të situatave jo të rralla ku gratë janë vetëm pronarë formal të biznesit.

Statistika nga Monstat tregon se në Mal të Zi në vitin 2011 kishte 21.127 subjekte biznesi aktiv. Prej këtij numri, 19.102 janë në pronësi të meshkujve dhe vetëm 2.025 në pronësi të femrave.

Grafikoni nr.2 - Bartësit e pronësisë së biznesit sipas gjinisë, në Mal të Zi⁷



4 <http://www.europarl.europa.eu/document/activities/cont/201107/20110718ATT24270/20110718ATT24270EN.pdf>,

5 <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0491:FIN:en:PDF>


6 Gratë si ndërmarrëse në Mal të Zi, Ipsos Strategic Marketing, Podgoricë, dhjetor 2011, fq. 85.

7 Bartësit e pronësisë së biznesit sipas gjinisë në Mal të Zi, në vitin 2011 Monstat, fq.5.

Shtrohet pyetja, cilët janë arsyet e statistikës së tillë, nëse mes personave të punësuar me nivel të lartë arsimit në Mal të Zi, gratë janë të përfaqësuara në përqindje më të madhe (33,2%) sesa meshkujt (26,2%).⁸

Statistika për Mal të Zi tregon botëkuptimin e ngulitur të ndarjes së profesioneve në ato femërorë dhe mashkullore. Kur bëhet fjalë për llojet e veprimtarive, statistika e Monstat-it tregon se gratë më së shumti janë të pranishme në veprimtaritë e amvisërisë si ndërmarrëse, gati 100%; pastaj me një përqindje prej 21% të përfaqësuara në sferën e mjekësisë dhe mbrojtjes sociale; pastaj në veprimtaritë shkencore dhe teknike 17%; në veprimtari të biznesit me patundshmëri 15% sikur edhe në administratën publike, mbrojtje dhe sigurim social. Në veprimtari të arsimit janë të përfaqësuara vetëm 13%, pak më shumë se në sferën e furnizimit me energji elektrike dhe fushën e ndërtimtarisë. Statistika tregon që gratë janë më pak të përfaqësuara në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, pastaj nxjerrjes së xeheve dhe gurit, transportit dhe magazinimit.

Grafikoni nr. 3 – Përqindja e subjekteve të biznesit sipas veprimtarive⁹



Konstatojmë se aspekti shoqëror, ekonomik, politik, kulturologjik, fetar dhe aspektet e tjera, krijojnë pabarazi duke vënë gratë në pozicion më pak të favorshëm në tregun e punës.


⁸ Vlerësimi i ambientit për biznes të grave në Mal të Zi, Unioni i punëdhënësve të Malit të Zi, Podgoricë, shtator 2013, fq. 29.

⁹ Bartësit e pronësisë së biznesit sipas gjinisë në Mal të Zi, në vitin 2011. Monstat, fq. 9

Fuqizimi ekonomik i grave në Komunën e Tivarit

Në nivelin lokal në të gjitha komunat malazeze kanë nisur aktivitete të ndryshme në fushën e fuqizimit ekonomik të grave, sepse përmirësimi i situatës sa i përket kësaj çështjeje, gjithsesi kërkon impulse nga mikro-niveli, përkatësisht nga niveli i cili është në lidhje direkte me gratë ndërmarrëse. Që të tregojmë gjendjen në komunat e Malit të Zi, kur bëhet fjalë për pronësinë e subjekteve të biznesit sipas gjinisë, në mënyrë grafike po paraqesim statistikën e më poshtme:

Grafikoni nr. 4 – Subjektet e biznesit në komunat e Malit të Zi¹⁰



Statistika e Monstat-it tregon se numri më i madh i bizneseve në pronësi të grave ekziston në komunën e Kollashinit (22%) dhe më i vogël në Shavnik (0%). Në Tivar përqindja e bizneseve në pronësi të grave është 9%. Është e nevojshme gjithashtu të shihen të dhënat mbi numrin e ndërmarrjeve të regjistruara nëpër komuna. Statistika tregon që në nivelin e komunave në Mal të Zi, më së shumti ndërmarrje janë të regjistruara në Podgoricë (33%), pastaj Budvë (10,9%), ndërsa Tivari me (9,9%) gjendet në vendin e tretë. Mund të përfundojmë që në komunën e Tivarit ekziston një numër i madh i ndërmarrjeve të regjistruara, por nga ana tjetër kur flasim mbi ndarjen gjinore të këtyre bizneseve, përqindja e bizneseve të grave është vetëm 9%.

Duke pasur parasysh të dhënat e cekura të statistikës si dhe faktin që shpërndarja joadekuate e mundësive, pjesëmarrjes dhe kontributit për zhvillim, pjesë-

¹⁰ Bartësit e pronësisë së biznesit sipas gjinisë në Mal të Zi, në vitin 2011. Monstat, fq.6.

marrjes së shpërndarjes së fitimit dhe pushtetit, në mes të grave dhe meshkujve në të gjitha nivelet e shoqërisë e veçanërisht në nivelin lokal, do të ndikojë në stagnimin dhe shfrytëzimin e pamjaftueshëm të kapaciteteve ekzistuese, Komuna e Tivarit ka miratuar Programin e fuqizimit ekonomik të grave. Fushat prioritare të këtij programi janë:

- Ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e pavarësisë ekonomike të grave
- Nxitja e punësimit të grave
- Stimulimi i vetëpunësimit të grave

Fushat e veprimtarisë në të cilat bazohet Programi i fuqizimit ekonomik të grave janë:

1. Krijimi i kushteve institucionale për zbatimin e programeve dhe koordinimin e politikave publike për barazinë gjinore
2. Krijimi i parakushteve për konkurrencën e femrave në zhvillimin e komunitetit përmes qasjes adekuate në njohuri dhe aftësi.
3. Rrjetëzimi i grave brenda komunitetit lokal
4. Qasja në financa
5. Mbështetja e kalimit nga ndihma sociale në punë të pavarur (vetëpunësim)
6. Mbështetja e grave nga komuniteti lokal që të bëhen politikëbërëse
7. Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve sociale
8. Aktivitete konsultative të drejtuar kah specifika e fuqizimit ekonomik të grave në zonat urbane dhe rurale
9. Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pavarësisë ekonomike të grave nga zonat rurale
10. Zhvillimi i strategjive të marketingut përmes Strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës, me theks në promovimin e grave në zhvillimin rural
11. Promovimi i Programit
12. Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm përmes një qasje të barabartë për gratë dhe burrat ndaj burimeve ekonomike dhe krijimin e mundësive të barabarta për përdorimin e tyre.

Komuna e Tivarit i ka plotësuar të gjitha parakushtet për fillimin e implementimit të Programit siç janë: krijimi i një grupi punues ndërsektorial, themelimi i Zyrës për barazi gjinore dhe emërimi i koordinatores. Programi realizohet sipas fushave të identifikuara të aktiviteteve, objektivave, masave dhe veprimeve. Për çdo fushë të caktuar të aktiviteteve, me Program janë identifikuar bartësit, rezultatet, burimet financiare si dhe afatet.

Gratë dhe zhvillimi shoqëror

Në kapitujt e mëparshëm kemi parë gjendjen e barazisë gjinore në nivelin e Malit të Zi dhe Komunës së Tivarit. Në këtë pjesë do të trajtohen nevojat për çështjet siç janë: përse nevojitet që gratë të kyçen më shumë në rrjedhat politike dhe ekonomike të komunitetit lokal. Qëllimi është të shihen se cilat janë përfitimet që do të realizojë komuniteti lokal, nëse gratë do të aktivizohen më shumë në krijimin dhe udhëheqjen e politikave lokale. Gjithashtu do të trajtohen dhe shembujt e praktikave të mira dhe eksperiencat e grave të cilat janë aktive në sferat e ndryshme të jetës shoqërore. Është fakt që objektivat e barazisë gjinore, veçanërisht në nivelin politik, ende nuk janë plotësuar në mënyrë të mjaftueshme, megjithatë ekzistojnë shembuj pozitiv të grave nga komuna e Tivarit që me aktivitetet e veta lanë gjurmë në vetë komunën dhe më gjerë, në nivel shtetërorë. Gratë në funksionet drejtuese: ministre, kryetare dhe anëtare të Kuvendit, kanë pranuar të na tregojnë se si ata luftuan me “murin prej xhamit”, se si i kanë lëvizur kufijtë dhe kanë hyrë në fushën e profesioneve të “meshkujve”.

Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë

Që një shtet të mund të arrijë barazinë gjinore dhe të fuqizojë gratë, është e nevojshme të rritet pjesëmarrja e grave në qeveri, kuvend dhe organet e vetëqeverisjes lokale. Pjesëmarrja më e madhe e grave në këto organe do të rrisë fuqizimin e grave si dhe mirëqenien e shtetit apo të komunitetit lokal. Dihet se gratë së pari kujdesen për familje dhe fëmijë dhe si rrjedhojë janë më të forta në avokimin e të drejtave të fëmijëve. Shembuj nga praktika tregojnë se në vendet ku ekziston pjesëmarrja më e madhe e grave në qeveri (Francë, Suedi, Holandë, etj), ligjet që aprovohen janë shumë më të volitshëm edhe për familje edhe për barazinë gjinore. Gjithashtu edhe çështjet sociale janë më mirë të zgjidhura, veçanërisht në sferën e shëndetësisë dhe arsimit.

Është karakteristike që gratë shpesh janë anëtare të grupeve dhe rrjeteve joformale shoqërore. Praktika ka treguar që këto rrjete joformale të grave kanë rëndësi të veçantë për përmirësimin e standardit jetësor, sepse ato kanë kontakt direkt me grupet e synimit dhe zgjedhin çështje të rëndësishme në fushën e shëndetësisë, arsimit, shpërndarjes së ndihmës, etj. Me fuqizimin e këtyre kolektiveve joformale të grave, kontribuojmë efikasitetit më të mirë në shpërndarjen e ndihmës për ato që kanë më së shumti nevojë.

Është evidente që roli i grave në politikën formale është i ulët gati në të gjitha vendet e botës. Megjithatë, në botë gjithnjë e më shumë mbizotëron argumenti

që pjesëmarrja e grave në nivelet e larta politike, është me rëndësi të madhe për cilësinë e politikës publike. Në mënyrë që të arrihet barazia gjinore në organet publike, shumë shtete pranojnë të ashtuquajturin “koncept i pasqyrave”¹¹ d.m.th. që prania e grave në këto organe, proporcionalisht i përgjigjet përqindjes së tyre në popullsi. Gratë kanë qasje tjetër ndaj institucioneve dhe politikës publike. Përveç kësaj, ato përbëjnë gjysmën apo edhe shumicën e popullsisë - andaj edhe krahas kësaj, sipas vetë konceptit të demokracisë, gratë meritojnë prani të barabartë në pozicionet udhëheqëse në shoqëri dhe me ndikim në legjislaturë.

Barrierat me të cilat gratë ballafaqohen

Ekzistojnë shumë barriera me të cilat gratë ballafaqohen kur dëshirojnë të hyjnë në politikë. Barrierat janë të rrënjosura në kuptimet tradicionale dhe stereotipet shoqërore të cilat lidhen me gratë, andaj është shumë vështirë të tejkalohen. Disa nga barrierat në shoqërinë malazeze i përkasin ndarjes në jetën private dhe atë publike. Në këtë rast, kuptimi tradicional në vendin tonë është që gruaja e ka vendin në sferën private, d.m.th. të kujdeset për familje, fëmijët dhe shtëpinë. Sfera publike, gjegjësisht vendi ku vjen në shprehje autoriteti politik, është i rezervuar për meshkuj. Ky kuptim i kufizon shumë gratë të hyjnë në fushën e jetës publike. Nëse ndodhë që gratë të gjenden në veprimtari ekstreme të meshkujve, siç është politika, praktika ka treguar që para së gjithash ato përqendrohen në tema të grave (arsimi, veprimtaritë shoqërore, mbrojtje sociale e të ngjashme). Këtu veçanërisht vërehet rregulli piramidial, sipas të cilës gratë gati po zhduken nga pozitat më të larta vendimmarrëse.

Përveç barrierës së cekur, në shoqërinë malazeze është gjithashtu e rrënjosur edhe ndarja jo adekuate e punës brenda vetë familjes, ku saktë janë të definuara rolet femërore dhe ata mashkullore. Brenda vetë familjes gratë janë bartëse të pjesës më të madhe të punës pa pagesë (mirëmbajtja e higjienës në shtëpi, përgatitja e shqimit, hekurosja, kujdesi për fëmijë) - që grave i lë pak kohë t'i dedikohen punës dhe jetës publike. Studimet tregojnë që kur merret në konsideratë edhe kjo punë e pa paguar, gratë mesatarisht punojnë 4 orë më gjatë se meshkujt.

Për gratë që merren me politikë, është shumë karakteristike që shoqëria edhe më tutje i vlerëson dhe vëzhgon përmes shikimit privat (“si duken dhe si vishen”). Me karakteristikat dhe sjelljet morale, gratë më shumë tërheqin vëmendjen e publikut sesa me qëndrimet që i përfaqësojnë në politikë. Është e rëndësishme të përmendet që gratë e martuara shpesh hasin në pyetje se si ato e balancojnë kujdesin për fëmijën dhe jetën publike. Kuptimi tradicional thotë që roli primar i gruas

11 Pjesëmarrja e grave në politikë është aq e rëndësishme saqë Kombet e Bashkuara kanë vendosë konceptin e pasqyrës (përfaqësia e barabartë e grave dhe meshkujve në organet politike) si qëllim për Konventën e eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

është të jetë para së gjithash nënë dhe pyetje siç ishte kjo më lart, kurrë nuk do t'i ishte drejtuar një mashkulli politikan. Për arsye të këtij koncepti ndaj gjërave, shoqëria pret që gratë gjithmonë do të zgjedhin ta lënë mënjatë karrierën politike për arsye të kujdesit ndaj familjes. Hulumtimet në vendet perëndimore tregojnë që politikanet shpesh janë më të moshuara sesa kolegët e vet politikanë, për arsye se kanë pritur që t'iu rriten fëmijët e pastaj t'i kushtohen politikës.

Njëra ndër barrierat është dhe stereotipi lidhur me ndarjen e aftësive mashkullore dhe femërore dhe kuptimi që aftësitë e femrave janë në konflikt me aftësitë udhëheqëse. Politika si veprimtari është shumë agresive dhe garuese prandaj mendohet që politikanët duhen të kenë më shumë veçori të meshkujve. Feminiteti si veçori, sipas kuptimit tradicional është i kundërt me aftësitë udhëheqëse. Ky mendim është shumë i rrënjësor në shoqëri, në të cilën që nga fëmijëria mësohet se politika është profesion ekskluzivisht i meshkujve.

Shembujt e praktikës së mirë

Në kuadër të Planit lokal të veprimit për arritjen e barazisë gjinore, Komuna e Tivarit ka njohur nevojën për angazhimin politik të grave dhe si objektivë të 5. strategjikë ka vendosur: Pjesëmarrjen e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Që të arrihet kjo objektivë, Komuna në bashkëpunim me partitë politike, sektorin OJQ, mediat dhe aktorët e tjerë lokal, kanë përgatitur planin e aktiviteteve për edukimin e grave dhe aprovimin e akteve ligjore. Si fusha prioritare të këtij programi janë definuar: arsimi (1), shëndeti (2), dhuna ndaj grave dhe fëmijëve (3), ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm (4), politika dhe vendimmarrja (5), mediat, kultura dhe sporti (6).

Edhe pse treguesit ende nuk janë në nivel të Bashkimit Evropian, ekzistojnë shumë shembuj të mirë nga praktika, për gratë që kanë lëvizur kufijtë e normave shoqërore dhe kanë arritur të bëhen anëtare të afirmuara të shoqërisë, në fushat të cilat tradicionalisht ishin të rezervuar për meshkuj. Në vazhdim të këtij kapitulli, të ndarë sipas fushave të veprimit, janë prezantuar eksperiencat e disa prej këtyre grave.

POLITIKA DHE VENDIMMARRJA

Për nevojën e fuqizimit politik të grave, barrierat me të cilat ato ballafaqohen dhe për politikat shtetërore për këtë çështje, kemi folur më shumë në kapitujt e mëparshëm. Në nivelin e komunës së Tivarit ekziston nevoja të shihet se cilat janë ato masa të cilat mund të zbatohen në nivelin lokal, me qëllim të realizimit të objektivave që shteti i ka parashikuar me ligj. Sipas Planit lokal të veprimit të barazisë gjinore është parashikuar krijimi i një baze të të dhënave sipas gjinisë, që të mund të përcillet ndikimi i masave në zhvillim të shoqërisë. Gjithashtu janë parashikuar edhe masa aktive, si psh. fuqizimi i grave dhe pjesëmarrja në prurjen e vendimeve përmes aktivitetit “Gratë në parlament”. Përmes shembujve të praktikës së mirë, në vijim mund të shohim si disa gra nga komuna jonë kanë arritur të afirmohen në jetën politike dhe publike.

Formula për sukses është që njeriu të zgjedh atë çfarë do



Sanja Vllahović
Ministre e shkencës në Qeverinë e Malit të Zi

Ministrja e shkencës në Qeverinë e Malit të Zi, prof. dr Sanja Vllahović lindi në Tivar. Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në vendlindje dhe në Londër. Studimet i ka filluar në Fakultetin e menaxhimit në Beograd dhe si bursiste ka vazhduar shkollimin në fakultetin ekonomik në Dublin dhe Toronto, kurse studimet e doktoratës edhe në Universitetin e Bolonjës. Ka diplomuar në vitin 1996, ndërsa më 1998 ka magjistruar në sferën e lidërshiptit. Ka doktoruar në vitin 2006 në temën “Lidërshipi si përcaktues i suksesit të organizatave moderne”. Ka kryer Akademinë Ndërkombëtare të diplomacisë, si dhe akademinë diplomatike “Gavro Vuković” në Podgoricë, me notën më të lartë. Jep mësim në Fakultetin për turizëm në Tivar të Universitetit “Maditeran”, ku ishte edhe dekane nga viti 2009 deri me emërimin në funksionin e Ministres. Është e angazhuar në studimet postdiplomike të Fakultetit ekonomik të Universitetit të Malit të Zi dhe studimet e doktoraturës në Universitetin Singidunum në Beograd. Ka mbajtur ligjërata në universitetet në Holandë, Hungari, Poloni, Itali dhe SHBA. Ka publikuar librat: “Lidërshipi në organizatat moderne”, “Menaxhimi”, “Drejt rrugës së verës, ullinjve dhe

”Mendoj se formula e suksesit është që njeriu të zgjedh të punoj atë çfarë do dhe nëse kjo ndodhë, të gjithë që janë të lidhur më këtë rreth, do ta ndiejnë energjinë e mirë dhe entuziazmin. Në shekullin XXI, mediokritetet nuk ecin - kërkohet veçanti në punë dhe këtë nuk mund ta arrini nëse nuk jeni të motivuar dhe nuk gjeni kënaqësi në atë çfarë punoni”

agrumëve - zhvillimi i turizmit dhe bujqësisë në Tivar”, si dhe një sërë studimesh, strategjive dhe punimeve shkencore dhe specialistike nga lëmia e turizmit dhe lidërshiptit. Me studentët e vet dhe doktorantët, ka përpiluar strategjinë e zhvillimit të turizmit të Tivarit, Rozhajes dhe Cetinës. Shumë shpejt me studentë e vet do të publikojë edhe studimet mbi zhvillimin e turizmit sportiv në Tivar dhe turizmit kulturor në Cetinë. Rrjedhshëm flet anglisht dhe italisht, por zotëron edhe gjuhën franceze.

Zonja Vllahoviq thekson se nuk ka planifikuar të merret me politikë dhe veten nuk e shikon si një politikane. Gjithmonë e ka ndërtuar veten për profesionin që i pëlqen dhe të cilit i dedikohet e ky është profili i profesorit. Megjithatë, nuk e kishte të panjohur të merret me menaxhim dhe organizim. Për këtë arsye edhe e ka pranuar në atë kohë pozitën e Dekanit të fakultetit për turizëm në Tivar. Në politikë ka hyrë përmes organizatave rinore dhe Këshillit të të rinjve që nga viti 1997, duke dashur që kolegëve të rinj t’iu përcjellë eksperiencat nga fusha e lidërshiptit dhe menaxhimit, të cilat i ka përvetësuar deri atëherë nëpër botë, por edhe që të ndihmojë shtetin të vet në momentet më të rëndësishme për të ardhmen e tij (që i ka paraprirë referendumit për pavarësi). *“Ideja mbi pavarësinë dhe besimi në njerëzit të cilët udhëhoqën Malin e Zi drejt kësaj rruge, ishin pishtarë dhe motiv i kyçjes sime në organizatat politike. Megjithatë, kisha planifikuar që vetëm të ndihmoj dhe pas realizimit të këtij qëllimi të tërhiqem nga këto aktivitete”*- theksoi Sanja. Kështu edhe ndodhi, që më 2007 kam lënë politikën pas vetes, duke ndihmuar shtetin edhe më tutje në projekte të shumta nga sferat ku kam mundur të kontribuojë. Me kolegë nga universiteti i sajë por edhe nga universitetet e tjera, ka punuar studime të shumta mbi zhvillimin e turizmit, projekte që kanë ndihmuar Qeverinë të ndër marrë vendime të rëndësishme nga sfera e turizmit, arsimit të lartë, shkencës dhe hulumtimeve. Në momentin kur është vendosur të formohet ministria e re në Qeveri - Ministria e shkencës, është ftuar që të marrë pjesë në këtë projekt. *“Kjo ishte sfidë në dy drejtime: së pari, për mua si preson nga bota e shkencës dhe arsimit të lartë të krijoj një institucion të ri në kuadër të administratës shtetërore, por edhe më e rëndësishme, të marrë pjesë në krijimin e politikës së re nga sfera e shkencës dhe hulumtimeve në Mal të Zi.”*

Sanja në rrugën e sajë profesionale, në 20 vitet e fundit, kurrë nuk ka përjetuar ndonjë barrierë të nxitur nga josensibiliteti gjinor apo paragjykime lidhur me barazinë gjinore. Në mandatin e parë në Qeveri, në përdhën e caktuar ishte femra e vetme, por për këtë arsye nuk ka ndjerë kurrfarë dallimi në trajtim nga ana e kolegëve meshkuj. Përkundrazi, siç thekson, kolegët kryesisht janë përpjekur ta përkrahin, posaçërisht ata që kishin përvojë në kryerjen e punëve të ministrisë. *“Sinqerisht, nuk pretendoj që këtë botë ta ndajë në mashkullorë-femërore dhe në sjelljen time kjo diferencë në kontekstin profesional kurrë nuk vendoset në plan të parë. Më besoni, shpesh më ndodhë të jem gruaja e vetme në mbledhje e të mos e vërejë aspak këtë. Thjeshtë, nuk mendoj për këto kategori. Të vetmin dallim e bëjë sipas asaj kush ka dije dhe qëndrim pozitiv ndaj punës të cilën e kryen dhe dallimet e tjera aspak nuk më ngarkojnë”*.

Udhëzuesi i Sanjës gjatë jetës është energjia pozitive dhe optimizmi, si dhe dashuria e madhe ndaj punës të cilën e punon. Gjithmonë mundohet që të shoh anën pozitive të gjërave dhe kjo gjë e inspiron dhe e motivon për sfida të reja. Beson se edhe vajzën e vet do ta orientojë që të zgjedh punën që do, sepse ajo është e vetmja rrugë për arritjen e suksesit.

Pozita në të cilën tani punon është një punë e vështirë dhe shumë sfidues, posaçërisht për gratë që tentojnë të kombinojnë më shumë role jetësore. *“Nuk është e lehtë të vendosësh balancën e vërtetë dhe të jesh nënë e shkëlqyer dhe profesioniste e suksesshme. Megjithatë, neve grave afariste, na ndihmon fakti që fëmijët e sodit janë të orientuar ashtu që kanë obligimet e veta dhe faktikisht shumë më mirë i përcillni, nëse edhe vetë jeni të angazhuar. Fëmijët e sodit duan dinamikë dhe me sa duket edhe iu konvenon kur prindërit i kanë të tillë. Kam fat që me vajzën time kam një relacion të shkëlqyeshëm, plot mirëkuptim dhe mbështetje të përbashkët për atë çfarë të dyja bëjmë. Vajza ime Darja ka energji të ngjashme me timen, kështu që ashtu të lodhura dhe të kënaqura për shkak të një dite dinamike pune, çdonjëra me impresionet e veta, diku në orët e hershme të mbrëmjes, gjendemi në shtëpi me dëshirë që të shkëmbejmë sa më shumë energji të mirë dhe mbresa nga dita që përfundoi. Kënaqemi në momentet kur jemi bashkë dhe i shfrytëzojmë në kapacitet të plotë: udhëtojmë, shëtisim, shoqërohemi, luajmë në piano, lexojmë së bashku, shikojmë filma....dhe pastaj njëra tjetrën e përcjellim drejt obligimeve të reja, duke kuptuar që kjo është dinamika të cilën me vete e bartë shekulli XXI dhe duke u gëzuar momenteve të reja që do t'i kalojmë së bashku.”* Obligimet e tjera janë çështje të organizimit të mirë, por kjo për Sanjën, si profesoreshë e menaxhimit, absolutisht nuk është vështirë.

Pjesëmarrja në zhvillimin shoqërorë të komunitetit lokal është obligim i çdo njeriu qëllimshëm

Branka Nikeziq
Kryetare e Kuvendit të komunës së Tivarit



Njëra ndër gratë e suksesshme të cilën për çdo ditë e shohim dhe dëgjojmë në emetimet e mbledhjeve të Kuvendit lokal në Tivarë, është zonja Branka Nikeziq. Një fuqi intelektuale, qëndrueshmëri dhe fitoret jetësore të kësaj gruaje meritojnë të jenë të shënuara dhe t'i paraqiten publikut, duke u bërë inspirim për ato gra që dëshirojnë të bëhen aktive në politikë dhe që me angazhimin e tyre dëshirojnë t'i kontribuojnë mirësisë së komunitetit lokal. Në karrierën politike gratë do të hasin në barriera të shumta, vështirësi dhe paragjykime drejt rrugës së suksesit, por është me rëndësi të jesh e qëndrueshme dhe të kesh sukses në qëllimin e vet për arsye se, siç thotë Branka, ekziston një thënie e popullit e cila vlen edhe për meshkuj edhe për femra e kjo është që “Kush mundohete fiton mundësinë”.

Branka Nikeziq ka lindur në Sarajevë më 1947. Shkollën fillore e kreu në Beograd, ndërsa gjimnazin në Tivarë. Ka studiuar në Fakultetin e drejtësisë në Podgoricë. Ka dy djem dhe 6 nipër. Angazhimin në punë e filloi në Entin për arsim, kulturë dhe edukatë fizike, pastaj punoi në shkollën fillore “Jugosllavia” në Tivar, pastaj në Komunën e Tivarit si sekretare e Sekretariatit për veprimtari shoqërore dhe nënkryetare e Komunës. Me politikë ka filluar të merret kaheerë dhe atë disi në mënyrë spontane ftesa për angazhim i është bërë edhe profe-

Këshillë për gratë:

„Angazhohuni në komunitetin tuaj. Provoni që me angazhimin tuaj t'i kontribuoni shoqërisë.“

sion. Sot Zonja Nikeziq është kryetare e kuvendit të komunës së Tivarit dhe me sukses udhëheq mbledhjet e Kuvendit, në përbërje të të cilit ka vetëm 13,8% gra. Është kryetare e Këshillit të gjimnazit „Niko Rolloviq”.

Situata politike gjatë viteve 80 dhe 90-ta ishte pika kthesë për karrierën e zonjës Nikeziq. Ka konsideruar që pjesëmarrja pozitive në ndodhitë shoqërore gjatë këtyre viteve paraqiste obligim të çdo qytetari me qëllime të mira dhe këtë e demonstroi me shembullin e vet. Gjatë karrierës shumëvjeçare politike ka hasur në barriera të ndryshme, megjithatë i ka luftuar - *“Pozita e Kryetares së Kuvendit të Komunës ka kërkesa – kështu duket. Por kjo është një ndërveprim shumë kompleks i marrëdhënieve ndër-partiake, e cila tejkalohet ose me demagogji ose me diskutim. Unë kam zgjedhur këtë të dytën, me qëndrime parimore”* thekson Branka.

Ajo konsideron që më së shumti i ka kontribuar komunitetit lokal me pjesëmarrjen aktive në zhvillimin shoqëror të Komunës, përmes angazhimit në Kuvend dhe në organet politike. Mendon që për kuptim të nevojave të komunitetit lokal, ishte shumë domethënës kontakti i mirë me qytetarët dhe marrëdhënia korrekte ndaj tyre. Duke kuptuar nevojat e qytetarëve përmes një komunikimi të hapët dhe të qartë, me fuqi të përbashkëta mund të kontribuohet në zhvillimin e komunitetit.

Branka thyen paragjykimet që gruaja duhet të rrijë në hije, në heshtje, e heshtur, e lidhur me zinxhir ligjor që ia imponon vetë natyra e saj femërore, por edhe sistemi patriarkal. Në punë, pozicioni i tanishëm paraqet arritjen e saj më të madhe, ndërsa në jetë arritja e sajë më e madhe janë fëmijët të cilët gjithmonë i kanë dhënë përkrahje në punë. *“Të merresh me politikë në Mal të Zi nuk është aspak e lehtë, edhe për sukses edhe për mosesukses, me rëndësi është përkrahja e familjes. Gjithmonë jam munduar t’i luftoj stereotipet rreth marrëdhënieve gjinore në aspektin e ligjeve të pashkruara, të rrënjosura thellë, sipas të cilëve gratë politikane gjithmonë gjenden, “të dytat” në hije, por gjithmonë të parat të cilat harresa i mbulon”*.

Sekreti i suksesit të Brankës në politikë është qëndrimi kategorik duke respektuar fleksibilitetin, dhe siç thotë ajo kjo është *“e çuditshme, por e saktë.”* Sa i përket harmonizimit të jetës private dhe profesionale, ajo thotë se ka pasur mbështetjen e familjes, që është bazë dhe domosdoshmëri për një funksionim normal në sferën publike.

Me një organizim të mirë çdo gjë mund të arrihet

Doc. dr Draginja Vuksanoviq
Deputete e Kuvendit të Malit të Zi,
këshilltare në Kuvendin komunal të Tivarit



Doc. dr Draginja Vuksanoviq me profesion është juriste dhe profesoreshë në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Malit të Zi dhe në fakultetin e arteve të dramës në Cetinë. Merret me punë politike dhe është deputete në Kuvendin e Malit të Zi, gjithashtu edhe këshilltare në Kuvendin komunal të Tivarit, anëtare e Bordit kryesorë të partisë Socialdemokrate të Malit të Zi dhe nënkryetare e Forumit të grave të kësaj partie; anëtare e Maticës malazeze.

Zonja Vuksanoviq lindi me 1978 në Tivar, në qytetin në të cilin, siç thekson, “është privilegj të jetosh dhe të lindësh”. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Malit të Zi si studentja më e mirë e Universitetit, me notë mesatare 10. Në gjeneratën e sajë ishin shtatë kolegë, me notë mesatare mbi 8,5. Ka magjistruar në Beograd, dhe ka doktoruar në Podgoricë. Rruga e sajë drejt suksesit është e karakterizuar me mundë të madh dhe me 14 vjet pune në përkryerjen profesionale, nga regjistrimi në fakultet deri tek marrja e titullit akademik doktor i shkencave. Të zgjedh këtë profesion e ka shtyrë dëshira të njoh të drejtën përmes dy aspekteve: përgjegjësia dhe dituria profesionale - “Fjalë e shkurtër, e cila në vete përmban një peshë të madhe dhe për atë që duhet te gjykoj, përgjegjësi e madhe dhe njohje e lëmisë”. Eksperiencia i ka treguar që normat dhe shkencat juridike e cila thuret nga normat, janë më të përsosura në libra. “Është një vlerë e madhe të kesh dituri mbi normat, thelbin e të cilave duhet përdorur në jetë përmes zbatimit të rre-

“E njohë veten si një grua që i pëlqen të jetoj dhe të krijoj për familje, shoqëri dhe veten time. Në këtë rrugë udhëhiqem me dëshirën dhe qëllimin tim, idenë udhëzuese që vjen nga virtytet, por edhe nga mangësitë e mia. E rëndësishme është që në çdo hap më përcjellin qëllimet e sinqerta dhe vullneti i mirë ndaj detyrave të cilat i kam vendosur edhe ndaj të tjerëve me të cilët ndaj jetën - në vendin e parë familja nga njëra anë, dhe shoqëria nga ana tjetër”.

gullave. Por fat është të dish t'u përcjellësh të rinjve këtë dituri, të cilët nesër si gjyqtarë, avokatë, notarë,... do t'i zbatojnë këto norma”, thekson Draginja.

Të merret me politikë ka vendosur sepse kjo e ka tërhequr që në fëmijëri, kur ka përcjellë çdo seancë të parlamentit dhe nënën e vet e cila në atë kohe ishte deputete në parlament. Në vete gjithmonë ka bartë idetë e partisë të cilat i mbështet, prandaj dhe ka zgjedhur këtë angazhim. “Kjo gjithmonë ka qenë dhe do të jetë pjesë e qenies sime e cila bën zgjedhje të barabartë ndaj çdo njeriu të mirë, pa marrë parasysh se si ai deklarohet nga ana e fesë apo nacionalitetit”. Kontributi ndaj komunitetit lokal ishte njëri ndër motivet e angazhimit të sajë politik dhe vazhdimisht, aq sa ia lejon dituria dhe aftësitë e saj, mundohet t'i kontribuojë zhvillimit të vetë komunitetit. Konsideron që njeriu është qenie sociale dhe gjithmonë duhet të japim kontributin komunitetit në të cilin jetojmë që së bashku t'i tejkalojmë problemet dhe të ndërtojmë një botë të thurur nga dëshirat tona dhe nga përkushtimi në punë.

Në rrugën e sajë ka hasur në shumë barriera. Pavarësisht nga pengesat gjithmonë është munduar të punojë me përkushtim, drejtë dhe vetëm me mund të vet të arrijë te suksesi. “*Me siguri, kur keni një qëllim dhe mundoheni ta realizoni “I gjithë universi bën komplot, që t’ju përmbush dëshirën” (Paolo Koelo). Mua, në arritjen e këtij qëllimi, askush nuk ka mundur të më ndalë. Në rrugën drejt suksesit gjithmonë hasim në pengesa, por rrugën tonë jetësore e stolisin edhe përvojat me njerëz të mirë dhe të fortë të cilët do t'i njohin dhe çmojnë vlerat tona”.*

Angazhimi profesional i Draginjes është plot suksese të shumta, por arritjen e saj më të madhe dhe rolin më përgjegjës në jetë e konsideron rolin e sajë si nënë dhe prind. Vajza e saj Ksenija tani është 12 vjeçare. Të jesh prind është art - “*Art i*

ofrimit të dashurisë – pastaj Arti i të ofruarit të dashurisë, vëmendjes, kujdesit, mirëkuptimit dhe simpatisë me fëmijën e vet në çdo kohë. Të qenit prind është vlerë e cila nuk ka masë, pasuri e cila nuk është materiale, por ndjenjë shpirtërore e cila nuk njihet për ta përcaktuar. Për cilësinë e jetës së Draginjes me rëndësi është që ka arrit të vendos balancën mes jetës private dhe biznesit dhe gjithmonë përpiqet ta mbajë këtë balancë. Për suksesin e

„Për mua gratë janë gjinia më e fortë. Fuqinë dhe karizmin e grave, asnjë mashkull nuk mund ta ketë dhe ta posedojë. Meshkujt janë fizikisht më të fuqishëm dhe atë jo të gjithë dhe në çdo moment. Por jetën nuk e bën fuqia fizike, por fuqia e cila është shtylla e familjes e kjo është gruaja, bartëse e vlerave shpirtërore, morale dhe tradicionale. Çdo grua duhet ta njoh vlerën e vet, dhe duke dëgjuar dëshirat e veta të ecë drejt qëllimit të vet, duke mos harruar kurrë rolin e vet që ka në familje. Kjo është ajo vlera e vërtetë tradicionale që stolis gruan dhe nënën malazeze.

saj, vendimtare është mbështetja e familjes e cila është pran sajë të ndajë me të edhe momentet e bukura dhe të këqija, ta kuptojë kur bën gabim, por edhe ta kritikojë në mënyrë që gjithmonë të jetë e gatshme të gjejë zgjidhjen më të mirë.

Sekreti i suksesit të Draginjes është energjia e pashterrur dhe organizimi i mirë: “*Ndodhë të punoj edhe pesëmbëdhjetë deri njëzet orë në ditë, por çdo here jam e pajisur me buzëqeshje dhe kurrë nuk do të më dëgjoni të them - jam e lodhur!*”

Investoni vazhdimisht në diturinë tuaj

Neda Ivanoviq
Drejtoreshë e organizatës turistike Tivar



Zonja Neda Ivanoviq lindi në Tivar, shkollën fillore e kreu në Virpazarë, gjimnazin në Podgoricë. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematiko – Natyrore në Beograd në degën për turizëm. Pas mbarimit të studimeve është kthyer në Mal të Zi dhe për 4 vite ka punuar si recepcioniste në NTH “Korali”. Pas kësaj përvoje ka punuar si referente e pavarur për propagandë dhe informim dhe redaktore e gazetës së komunës për transport “Bartranzit”. Nga janari i viti 1997 deri më 2005 ka punuar si drejtoreshë e qendrës turistike Tivar dhe nën patronazhin e organizatës turistike të Malit të Zi ka realizuar aktivitete të shumta në promovimin e komunës së vet. Aktiviteti më i rëndësishëm në këtë periudhë ishte realizimi i TV festivalit Internacional, në vitet 1998 dhe 1999. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në riorganizimin e Qendrës turistike Tivar dhe kthimin e sajë nën kujdesin e Komunës me emër Organizata turistike e komunës së Tivarit. Si drejtoreshë e Organizatës turistike të Komunës së Tivarit, në periudhën nga viti 2005 deri më vitin 2014, së bashku me ekipin e të punësuarve, me aktivitete shumëvjeçare, me sukses arriti të pozicionojë përsëri ofertën turistike të komunës sipas tendencave moderne në tregun turistik botëror. Kontributi i saj për komunitetin lokal pasqyrohet në realizimin e projekteve të shumta ndërkombëtare të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në këtë territor, angazhim në përgatitjen

NIJE PREVEDENO NA ALBANSKI...

e punimeve shkencore dhe profesionale, pastaj zgjidhjeve inovative për destinacionin e Tivarit. Kuvendi i Organizatës Nacionale turistike të Malit të Zi (NTO CG) e ka zgjedhur si anëtare të Bordit Ekzekutiv për periudhën nga viti 2010 - 2014. Zonja Ivanoviq flet gjuhën ruse, angleze dhe atë franceze.

Bruga e suksesit ishte plot ferra. Në punën e saj Neda ka hasur në barriera të ndryshme. Kryesisht këto ishin barriera në formë të stereotipeve kur bëhet fjalë për gratë në pozicionet udhëheqëse në Mal të Zi. Megjithatë, me një qëllim të qartë, vullnet dhe ngulim që të arrijë „*të gjitha barrierat kanë rënë në ujë*”. Me rëndësi është të merreni me punën që ju pëlqen dhe kjo ju jep fuqi dhe ju motivon në mënyrë të veçantë të ballafaqoheni me të gjitha vështirësitë. „*Çdo punë e kryer me sukses me motivon për ide të reja, ndërsa kreativiteti të cilin e posedoj është garanci për këto*”.

Arritjen më të madhe në planin profesional Neda i konsideron aktivitetet që kanë sjellë njohje e Tivarit si destinacion „*me dy bregdete njëlloj të bukura*“, si dhe çmimin „Wild Beauty Award“. Puna me të cilën merret i mundëson që dita ditës të jap kontributin e vet në zhvillimin e komunitetit lokal, sepse ndikon në promovimin ndërkombëtarë të qytetit të Tivarit dhe në ripozicionimin e Tivarit nga imazhi i qytetit port në destinacion të njohur turistik. Afirmimin për punën e vet e fiton përmes donacioneve të shumta financiare dhe jo financiare që i vijnë Organizatës turistike. Të gjitha paratë investohen në promovimin e Tivarit dhe ofertës së përgjithshme të komunës, ndërsa përfitimet i marrin të gjithë anëtarët e shoqërisë, edhe ato fizik edhe ato juridikë.

Njëra ndër detyrat më të vështira, në kohën kur u zhvillua organizata turistike, ishte balancimi në mes jetës private dhe biznesit. Shpesh për nevoja të punës është dashur të marrë vendime në dëm të jetës private. Natyrisht, me kohë ashtu si është zhvilluar organizata, çdo gjë për nuancë ishte më e lehtë. Puna të cilën adhuron e ka orientuar edhe në planin privat, kështu që ajo sot në kohën e lirë kënaqet në udhëtime, por me dashuri edhe prodhon verë në pronën familjare në Limlanë. Sekretin e suksesit të Nedës është në punë, dedikim, këmbëngulje, durim dhe në dashuri ndaj punës me të cilën merret.

Me shembullin e vet motivoni njerëzit rreth jush

*Nedelka Nena Orllandiq
Drejtoreshë e përgjithshme e
NP „Veprimtaritë komunale“ Tivar*



Zonja Nedelka Orllandiq ka lindur më 1955 në Tivar. Aty ka përfunduar shkollën fillore dhe gjimnazin. Sipas profesionit është ekonomiste, ka diplomuar fakultetin ekonomik në Beograd. Vite me radhë, saktësisht që nga viti 1993 punon në ndërmarrjen publike “Veprimtaritë komunale” Tivar. Punën në këtë kompani e ka nisur si drejtoreshë e sektorit financiar që më vonë ka kaluar në pozicionin e zëvendës-drejtoreshës, ndërsa tani punon në pozicionin e drejtoreshës së përgjithshme të ndërmarrjes. Posedon eksperiencë profesionale të konsiderueshme dhe edukim në fushën e financave dhe kontabilitetit si dhe çertifikata e tituj të ndryshëm: Kontabiliste e pavarur - Agjensioni për edukim dhe konsultim Beograd; menaxhimin e financave moderne - Instituti i kontabilistëve të çertifikuar të Malit të Zi; kontabiliste e autorizuar, si dhe licencën e specializuar nga Instituti i kontabilistëve të çertifikuar të Malit të Zi “Revizor intern”, pasi i ka përmbushur standardet profesionale dhe etike për zbatimin e kësaj praktike. Zonja Orllandiq është gjithashtu e angazhuar edhe në politikë dhe është anëtare e këshillit komunal të partisë DPS në Tivarë. Është e martuar dhe ka dy djem.

Shumë herët ka bërë zgjedhjen e profesionit të vet dhe diturinë e vet e ka plotësuar me edukim nga fusha e financave - është shkolluar dhe orientuar kah ky profesion. Puna me financa dhe menaxhimin e financave, me të cilën është marrë vite me radhë, është shumë e vështirë dhe kërkon shumë përgjegjësi. Kur e ka zgjedhur profesionin e vet ka ditur që kurrë nuk do të mund të llogarisë në orarin 8 orësh të

punës, por edhe që pozicioni i saj do të kërkoj dorëheqje nga gjërat e caktuara. „Që të merresh me këtë, me rëndësi është dashuria ndaj punës dhe atëherë nuk mund të flasim për heqje dore“, thekson Nedelka. Është rritur në familje në të cilën gjithmonë janë shikuar në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat, duke mos njohur stereotipe të tilla. Familjen e vet e ka edukuar në këtë rrjedhë. Duke pasur parasysh që puna e sajë gjithmonë ka kërkuar shumë, çelësi i suksesit ishte mbështetja e familjes me ndihmën dhe mirëkuptimin e së cilës ka arritur të balancojë jetën private dhe atë të biznesit. Në pozicionin e drejtoreshës ka pasur mundësi të bashkëpunoj me gra dhe meshku dhe kurrë nuk i ka ndarë të punësuarit sipas gjinisë, por punën e kryer e ka vlerësuar sipas mundit dhe dedikimeve të tyre. Me shembullin e vet ka provuar që gratë mund të jene drejtoresha të suksesshme të kompanive publike sepse udhëheq ndërmarrjen e cila ka rreth 300 të punësuar dhe 9 sektorë. Gjithashtu me rëndësi të përmendet është edhe kontributi i Nedelkës për qytetin e Tivarit i cili nën udhëheqjen e saj gjithmonë ka fituar çmime si qyteti më i pastër në Mal të Zi. Me rëndësi është edhe kontributi i saj në nismën e riciklimit në Tivar, të cilën e ka realizuar në bashkëpunim me subjektet e biznesit.

Me përpjekjet e veta ka kontribuar që qyteti i Tivarit të duket më i bukur dhe më i pastër si dhe të ndërrohet kultura e qytetarëve në sensin e sjellës më të mirë ndaj qytetit të vet dhe të ruajnë më mirë mjedisin. Gjithmonë është e gatshme për sfida të reja dhe arritjen e standardeve të cilat i kërkon Bashkimi Evropian. Për komunikim të hapur dhe gatishmëri të bashkëpunojë, dëshmojnë projektet ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë NP „Veprimtaritë komunale“. Me këto projekte ndërmarrja është avancuar, por edhe vetë qyteti (mjete të reja, kontejnerë, qasje e re ndaj riciklimit e të ngjashme).

Nedelka konsideron që për sukses në punë të çdo lloji, me rëndësi është dedikimi si dhe shprehitë e punës. Gjithmonë i ka respektuar njerëzit punëtorë dhe personat të cilët „nuk rrinë ulur por kërkojnë mënyra të reja të zgjidhin problemet“. Për vete thotë që shpesh i flasin që është „një energji e paparë të cilën është vështirë ta ndjekësh“, por konsideron që bashkëpunëtorët e sajë janë mësuar në ritmin e saj të punës dhe me kohë kanë filluar të ndjekin shembullin e saj. Këshilla që iu kishte dhënë grave të cilat nisin biznesin e vet, është që të fillojnë nga baza dhe ngadalë të avancojnë dijeninë e tyre - „duke investuar në vete njerëzit bëjnë ndryshime të rëndësishme. Nuk është e thjeshtë të hyjsh dhe të fitosh pozitën e drejtorit, ekziston rruga e cila duhet të kalohet dhe shumë gjëra që duhet mësuar para se të merret përgjegjësia e tillë“. Zhvillimi i saj përmes kompanisë, e ka mësuar të çmojë punën e punëtorëve të vet, t'i ndihmojë kur hasin në probleme, si dhe të ketë mirëkuptim për to.

„Besoj se çdokush mund të ndërrohet dhe të bëhet më i mirë dhe më i suksesshëm. Nëse diçka me të vërtetë dëshirojmë, zakonisht atë edhe e arrijmë“. Grave iu kishte rekomanduar të zhvillojnë veten, të investojnë në dituri dhe arsim, të mësojnë mirë punën e vet që të mund të ndihmojnë veten dhe të punësuarit e tyre dhe me shembullin e vet të mësojnë dhe motivojnë njerëzit rreth vetes.

ARSIMI

Sikur dhe në të gjitha sferat tjera ashtu edhe në sferën e arsimit, shumë e rëndësishme është arritja e barazisë gjinore. Gjegjesisht, këtu diskriminimi zhvillohet në dy nivele, kështu që me Planin e veprimit dhe programet është e nevojshme të planifikohen dy nivele të veprimit. Niveli i parë i diskriminimit i referohet vetë qasjes ndaj arsimit. Arsimin në Mal të Zi e karakterizon situata që gratë akoma shkollohen për profesione të “grave” dhe meshkujt për profesione të “meshkujve”. Në procesin e sinjalizimit të hershëm i cili zhvillohet në familje, fëmijët mësohen të pranojnë si të natyrshëm profesionet në të cilat gratë “kujdesen” për të tjerët, si dhe të pranojnë “si gjendje normale” që gratë të ç’kyçen sa më shumë nga hierarkia, sa më i lartë të jetë niveli. . Kjo çon padyshim në ndarjen e profileve arsimore, që më tutje ndikon në punësim. Gjithashtu, vijmë deri te

situatat në të cilat gratë, nëse kanë obligime ndaj familjes, e braktisin edukimin e mëtejshëm - qoftë me kërkesën e tyre apo të familjarëve. Sigurisht, që situata të ndërrohet është e nevojshme që në shkollën fillore të fillohet me edukim mbi barazinë gjinore edhe për fëmijë edhe për prindër. Komuna e Tivarit në Planin Lokal të Veprimit ka planifikuar aktivitete të këtij lloji, si dhe aktivitete për promovimin e arsimit të përfaqësuesve të komunitetit të romëve, programeve të përvetësimit shkrim dhe këndim, si dhe programe të përvetësimit të aftësive bazë në informatikë. Niveli i dytë i diskriminimit i referohet menaxhimit të institucioneve arsimore, ku gratë zakonisht nuk janë në pozita udhëheqëse. Statistika tregon që në Mal të Zi gratë përfaqësojnë 30,40% të drejtoreshave të shkollave fillore, edhe pse në këto institucione punojnë shumë më tepër gra sesa meshkuj (78% të punësuarve janë gra). Në shkollat fillore 60% të punësuarve janë gra, ndërsa vetëm 16,67% punojnë në pozitën e drejtoreshës të shkollës së mesme . E paraqitur në numra: çdo e 134-ta grua në arsim është drejtoreshë, ndërsa çdo i 18-i mashkull është drejtor. Në Tivar kemi gra që kanë dhënë, apo akoma japin kontributin e vet në pozitë udhëheqëse në shkolla dhe çerdhe. Përvoja dhe puna e tyre, pengesat me të cilat hasen në këtë punë (që është dominuese nga meshkujt në pozitë udhëheqëse të institucioneve arsimore), mund t'u shërbejë grave të tjera si frymëzim.

Me profesion kundër stereotipeve

Ramiza Kallamperoviq
Drejtoreshë e shkollës së mesme
ekonomiko- hoteliere në Tivar



Zonja Ramiza Kallamperoviq jeton dhe punon në Tivar. Me profesion është profesoreshë e historisë dhe ka kryer Fakultetin filozofik në Sarajevë, në degën e historisë. Për 26 vite ka punuar si profesoreshë e historisë në Ulqin dhe Tivar. Në pozitën e ndihmës-drejtorit të Gjimnazit në Tivar ka punuar më shumë se dy vite dhe pastaj, në vitin 2003 u emërua drejtoreshë e shkollës së mesme ekonomiko-hoteliere. Për profesionin e vet ka vendosur për shkak të dëshirës që të edukojë dhe arsimojë gjeneratat e reja si dhe të nxisë bashkëqytetarët e vet të shkollohen dhe të punojnë. Në atë periudhë nuk kishte shumë gra që kanë kryer shkollë të lartë dhe kanë punuar në profesionin e vet - ka pasur dëshirë që të ndajë eksperiencën e vet me të tjerët. Në fushën e arsimit si dhe në fushën e menaxhimit në arsim, me shembullin e vet ka treguar se meshkujt dhe femrat janë të barabartë. Statistikat tregojnë se në Mal të Zi vetëm 16,67% të grave janë në pozitat e drejtoreshave të shkollave të mesme, kështu që gratë edhe në arsim si dhe në fushat e tjera nuk përfshihen në pozitat udhëheqëse. Zonja Kallamperoviq ka treguar që me punë të vazhdueshme dhe përpjekje, mund të shmangët ky lloj diskriminimi.

Dashuria ndaj punës dhe dëshira të kontribuoj në komunitetin e vet, e kanë shtyrë të përpilojë mënyra të reja me të cilat do të avancohej arsimi në Tivar. Ka pasur dëshirë të themelonte një shkollë profesionale ekonomiko-hoteliere në komunën e vet. Nevoja për këtë lloj edukimi ishte e madhe, duke pasur parasysh që Tivari është vend turistik

„Sekreti i suksesit tim është dëshira dhe nevoja që diçka të vlefshme të sigurojë për qytetin tim dhe që ta realizojë këtë më ka ndihmuar durimi im, mirëkuptimi dhe dashuria ndaj profesionit“.

dhe bregdetarë, por oferta në arsim nuk ka pas. Marrjen e këtij vendimi dhe fillimin e punës për themelimin e shkollës, ajo e konsideron si pikë-kthesë në jetën e vet. Në punë ka hasur në shumë pengesa sepse themelimit të shkollës ia ka nisë nga „zeroja“; nuk ka pasur ndërtesë, kuadrin dhe kabinetet, kurse ishte e nevojshme të regjistroheshin nxënësit. Barrierat i ka tejkaluar ashtu që ka kërkuar ndihmë nga shoqëria: Ministria e arsimit, komunitetit lokal dhe bashkëpunëtorëve të sajë. Gjithmonë e ka fituar ndihmën të cilën e ka kërkuar, sepse ka pasur qëllim të qartë, nevojën të identifikuar qartë nga ana e të rinjve dhe këmbëngulje që të realizoj të gjithë këtë. Ka plot 10 vite që udhëheq Shkollën e mesme ekonomiko-hoteliere. Sot kjo është shkolla me numër më të madh të nxënësve (rreth 900 nxënës), ka staf të mjaftueshëm dhe çfarë është më e rëndësishme i jep mundësinë fëmijëve, të cilët është dashur të udhëtojnë e të shkollohen në komunat fqinje, të arsimohen në vendin e vet. Punën në themelimin e kësaj shkolle dhe suksesin e nxënësve të cilët shkollohen the fitojnë çmime të ndryshme në gara të shumta, i konsideron kontributin e vet më të madh për zhvillimin e komunitetit lokal. Sot shkolla me sukses promovon komunitetin lokal dhe qytetin e Tivarit, është e njohur në Mal të Zi dhe regjion; jep kontribut në avancimin e arsimit përmes shkëmbimit të eksperiencave profesionale të stafit, me partnerët nga vendi dhe shtetet e jashtme. Me angazhimin e vet Ramiza ka kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë me shkollat jashtë vendit si dhe në zhvillimin e programit të ngritjes profesional të stafit jashtë vendit.

Gjatë punës ka hasur edhe stereotipe - duke filluar nga fakti që jo shumë njerëz kanë besuar se ajo, si grua, do të ketë sukses të gjendet në rolin e menaxheres i cili është ndryshe nga puna e punëtores në arsim. Me punë ka luftuar për pozitën e vet në punë dhe shoqëri. Sot i pëlqen t'i kthehet këtyre stereotipeve interesante në të cilët ka hasur, me një buzëqeshje. Të gjitha grave që kanë dëshirë të merren me profesionin e sajë iu rekomandon se duhet të kenë aftësi profesionale teknike si dhe kushte bazë, megjithatë që të jenë të suksesshme duhet të jenë të gatshme të sakrifikojnë dhe duhet të kenë dashuri ndaj profesionit.

Me dashuri të singertë ndaj profesionit dhe me përkushtim, do të arrini sukses



Svetllana Macanoviq
Drejtoreshë e SHF „Blazho Jokov Orlandiq“

Zonja Svetllana Macanoviq lindi me 1968 në Tivar, „qyteti blu dhe i gjelbër, të cilin e përfjetoj si portin e vet. Kujtimet më të bukura dhe emocionet e pastra, më lidhin me fije të padukshme por ekzistuese për këtë qytet“. Në Tivar ka kryer arsimin fillorë dhe atë të mesmin, ndërsa studimet e letërsisë i ka kryer në Fakultetin filozofik në Beograd. Pas kthimit në Tivar, ka filluar të merret me profesionin e vet dhe të realizojë mësimin në shkollat fillore „Jugosllavia“, „Anto Gjedoviq“ dhe në Gjumnazin „Niko Rollovici“. Në pozitën e drejtoreshës së SHF „Blazho Jokov Orlandiq“ është që nga viti 2002.

Për punë pedagogjike ka vendosur vetëm nga dashuria. *„Edhe sot mendoj kështu - krahas afiniteteve për ndonjë punë, kushti kryesorë është që ta doni, në të kundërtën, do të jeni të pa motivuar, të pafat dhe të parealizuar. Kur me gëzim shkoni në punë, ajo ndjenjë është e papërshkrueshme dhe e pakrahasueshme“*, thekson Svetllana. Ngjarja e cila e ka rifokusuar karrierën e Svetllanës, ishte largimi nga Gjumnazi dhe pamundësia të vazhdoj të punoj si profesoreshë në vendin e punës, e që për te ishte plotësim i dëshirave dhe shpresave të saj. *„Ky ishte një ndër momentet më të vështira të jetës sime, por nuk e kam humbur kurajon. Nxënësve shpesh u kam folur që vetëm me luftë njeriu mund të jetë fitimtarë dhe këtë është dashtë edhe me përvojë të vet ta vërtetojë“*. Shpejt pas kësaj u emërua për drejtoreshë të SHF „Blazho Jokov Orlandiq“.

Njëra ndër kënaqësitë më të mëdha profesionale, ishte besimi të cilin ma dhanë me këtë rast, edhe pse akoma në zemër mban titullin e profesoreshës dhe mendon që nxënësit do të kishin përfituar

„Barrierat dhe problemet janë pjesë përbërëse e çdo pune... Kur me kujdes dhe në mënyrë analitike e konsiderojmë situatën nga të gjitha aspektet, do të vijmë deri te zgjidhja si dhe te njohuria se nuk ekzistojnë vështirësi të pakapërcyeshme. Nuk duhet pritur që dikush tjetër do të zgjidh problemet tona, por duhet të mbështetemi në fuqitë tona“.

më shumë nga ajo si arsimtare, sesa nga ajo si drejtoreshë. Pengesat dhe problemet janë pjesë përbërëse e punës dhe sipas mendimit të Svetllanës, duhet të kuptohen si sfidë profesionale. Realizimin e saj më të madhe e përjeton atë çfarë ka arritur në klasë - që kur i takon nxënësit e sajë të dikurshëm, të shoh se ata sinqerisht kanë dashuruar letërsinë, e cila e bën më fisnik dhe e pasuron njeriun, „që i kanë pranuar vlerat universale jetësore të cilat jam munduar t'i interpretoj dhe t'iu përcjell, që kanë kuptuar rëndësinë e arsimit dhe shprehjes koncize, të saktë dhe të qartë...“ Afirmimin e nxënësve të vet dhe të kuptuarit që puna e sajë ka dhënë fryte, Svetllana e konsideron arritjen e sajë më të madhe. Edukimin të cilin iu ka mundësuar nxënësve dhe puna e ndërgjegjshme në pozitën e drejtoreshës, paraqesin kontributin e saj më të madh shoqëror. Svetllana për çdo ditë mundohet të sigurojë edukim sa më të mirë (përmes programeve të reja edukative për staf dhe nxënës) dhe kushte për punë (përmes investimeve të ndryshme në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të shkollës), në shkollën të cilën e menaxhon.

Duke pasur parasysh se ajo është grua-menaxhere, në punën e saj ka hasur në stereotipe të cilat kryesisht bazohen në historinë e Malit të Zi, traditën, zakonet, kul-

turën. „Kur e fitova mandatin të menaxhoj shkollën në qendër të qytetit, isha 34 vjeçare dhe shumë njerëz konsideronin që jam shumë e re dhe pa eksperiencë për këtë pozitë, që nuk do të mund tu përgjigjem sfidave të menaxhimit të shkollës e cila ka numëru-

„Vullnetarizmin e mbështes dhe mendoj që tek ne nuk është i zhvilluar. Thellë në vete besoj që obligimi i të gjithë neve është të sigurojmë më shumë dhe të bëjmë më shumë. Këtë ia kemi borxh komunitetit tonë, por edhe ndaj vetë neve. Ai që mund të jap dhe të ndajë është njeri me fat.“

ar 1000 nxënës dhe 65 të punësuar. Me të vërtetë kam investuar punë të madhe, mundë dhe energji që çdo gjë të funksionojë siç duhet“. Ka zgjedhur mënyrën që të mos e pengojë stereotipi lidhur me profesionin e saj, por ta motivojë të punojë edhe më me sukses. Deri te suksesi ka arritur me një punë të vazhdueshme, të planifikuar mirë dhe me angazhim. „Mundohem t'i shmangem veprimit të pamenduar, sipërfaqësor, shtyrjeve, sepse punën e kuptoj shumë seriozisht“, thekson Svetllana. Në punë udhëhiqet me maksimën e çuditshme - në të gjitha situatat e pafavorshme niset nga pozita që ajo diku ka bërë gabim, sepse si drejtoreshë që është, sipas hierarkisë ka përgjegjësi për çdo gjë. Sigurisht, kur i sheh gabimet e të tjerëve por edhe gabimet e veta, shumë shpejt gjendet rrugëdalja - „Nuk ka sekrete dhe as magji“.

Svetllana konsideron që gjithmonë është e nevojshme të planifikohet jeta e vet. Në punë dhe jetë private gjithmonë me kujdes planifikon kohën e vet gjë që e ndihmon në balancimin në mes jetës private dhe punës. „Më pëlqen rregulli dhe e kam zakon të them se edhe në kaos duhet të ekzistojë rregulli“. Sa e rëndësishme për te është jeta profesionale, aq është e rëndësishme edhe jeta shpirtërore. Konsideron se nuk duhet lënë pas dore jetën shpirtërore, por duhet gjithmonë të ndahet koha për aktivitete të cilat ju bëjnë më fisnik dhe më të lumtur. Këshilli i Svetllanës për sukses është i thjeshtë: „Secili duhet të ketë stilin e vet, të thurur sipas afiniteteve personale, dëshirave, besimeve, parimeve, kodeksit...të krijoj shembullin e vet, sepse është vështirë dhe jo natyrale të ndjekësh shembullin e tjetrit, dhe kjo shpesh rezulton me mossakses dhe pakënaqësi“.

Sekreti i suksesit është në punën vetëmohuese

Vera Kovaçeviq
Presidente e SHKA „Jedinstvo“ dhe ish drejtoreshë e SHF „Jugosllavija“



Zonja Vera Kovaçeviq gjithë jetën e ka kaluar në arsim. Në shkollë ka punuar si arsimtare e fizikës, kimisë dhe matematikës, ndërsa 25 vitet e fundit ka kryer edhe punët e drejtoreshës në SHF „Blazho Jokov Orlandiq“, çerdhes „Vukosava Ivanoviq Mashanoviq“ dhe SHF „Jugosllavija“. Karrierën e vet e ka nisë në SHF „Sutomore“ (sot SHF „Kekec“) dhe në SHF „Meksiko“, dhe ka përfunduar në SHF „Jugosllavija“. Kur ka nisur zanatin e mësimdhënëses, ka pasur fat që në të gjitha këto shkolla kanë ekzistuar njerëz prej të cilëve kishte mundësi të mësonte. „Këto njerëz ishin institucion dhe unë kam pasur dëshirë të pyes, të mësoj nga ata dhe të kopjoj“, thekson Vera.

Vera pa masë e do punën me të cilën është marrë. Gjithmonë ka pasur ndje-

njën që posedon aftësinë e bartjes së dijes dhe kjo njohuri goxha ka ndikuar në zgjedhjen e profesionit të saj. Me dashuri flet për relacionin me nxënësit - „Socializimi me rini krijon një energji pozitive brenda njeriut dhe kjo energji mundëson të vihet në pah kreativiteti. Dashurinë të cilën nxënësit e fitojnë gjatë shkollimit, gjithmonë jua

„I dua dhe i respektoj gratë e urëta dhe punëtore. Këshilloj që me hapa të vegjël më shpejt të mbërrihet deri te qëllimi. Gruaja gjithmonë mbanë barrën më të madhe dhe ka shumë obligime. Ekzistojnë situata të veçanta ku askush nuk mund ta ndërroj. Unë besoj në familje dhe nëna është shtylla e familjes. Pas kësaj vjen profesioni dhe biznesi. Gratë moderne që vijnë, kanë fuqi dhe aftësi të harmonizojnë obligimet dhe të jenë të suksesshme në jetë.“

kthejnë gjatë takimeve me ta. Këto takime kanë magji të veçantë. Ato ndodhin çdo ditë dhe të përkujtojnë se dashuria dhe respekti kthehen me të njëjtën përmasë“.

Është interesant fakti që Vera ka qenë drejtoresha e parë në fushën e arsimit në Tivar dhe sipas informatave të saja, e dyta në Mal të Zi. Para se është bërë drejtoreshë në SHF „Sutjeska“, në Podgoricë në funksionin e njëjtë është zgjedhur Zora Bracanoviq nga e cila ka mësuar shumë. Momenti kryesorë në karrierën e Verës ishte zgjedhja e menaxhimit të institucionit arsimor. „Në atë kohë isha anëtare e kolektivit më të madh shkollor të SHF „Blazho Jokov Orlandiq“, dhe përkrahja ime ishte zgjedhja e njëzëshme për pozitën e drejtoreshës së shkollës, nga ana e kolektivit në të cilin kam punuar dhe kam qenë njëra ndër më të rejtat“, përkujtohet Vera.

Gjatë periudhës në punë nuk ka hasur në barriera të mëdha. Të vogla me siguri ka pasur, por Vera e kishte zakon të „lërë problemin të kalojë natën, sepse mëngjesi është gjithmonë më i urtë se nata“. Gjatë punës së sajë shumëvjeçare ka pasur mbështetjen e kolegëve tjerë drejtorë. Vera konsideron se

*„**Sekreti i suksesit tim është në punën vetëmohuese. Isha e gatshme gjithmonë që të pyes dhe të mësoj nga të tjerët. Mundohet të jem tolerante. Mendoj që kam patur sens për komunikim të mirë. Kam respektuar edhe çdo gjë të mirë që të tjerët kanë arritur. Jam munduar gjithashtu të respektoj dhe të i dua njëzëzit rreth meje. Prandaj mund të lavdohem që kurrë nuk kam përjetuar telashe“.***

çdo njeri i cili punon drejtë dhe me sinqeritet ka edhe aspirata që për punën e vet të fitojë edhe ndonjë mirënjohje. Kënaqësinë që e ka përjetuar kur ishte anëtare e kolektivit të SHF „Meksiko“ ishte fitimi i çmimit shtetëror „Oktoi“. Kënaqësi edhe më e madhe ishte kur shkolla „Blazho Jokov Orlandiq“ fitoi çmimin e njëjtë gjatë angazhimit udhëheqës të saj në këtë shkollë. Por kënaqësia më e madhe dhe plotësimi i dëshirës, ishte që edhe puna e saj personale të çmohej, prandaj çmimin „Oktoi“ të cilin e fitoi për meritat e saj personale në arsim, e konsideron realizmin e vet më të lartë. Para kësaj ka fituar shumë çmime, por kjo ishte kurora e të gjithave.

Përveç afirmimit të saj në fushën e arsimit, Vera qysh në moshë të re ka filluar të merret me punë shoqëro-politike dhe siç thekson – „asnjëherë nga interesi personal. Gjithmonë gjatë prurjes së vendimeve jam përcaktuar për atë që do t'i kontribuoj mirëqenies së qytetit tim“. Gjithashtu është aktive në fushën e kulturës - presidente e shoqërisë kulturoro-artistike „Jedinstvo“. Konsideron se me një organizim të mirë, çdo gjë mund të mbërrihet dhe nuk është mirë të lehet pas dore jeta private dhe as puna, sepse njëra pa tjetrën nuk japin njeriun e suksesshëm.

Vera është përpjekur gjithmonë të ndjek trendët moderne - „Kurrë nuk më ka pëlqyer kur kam dëgjuar nga të vjetërit si kemi qenë ne të mirë, e posaçërisht kur dëgjoj njerëzit tani të thonë: „E si ka qenë në kohën tonë“! Eksperienca ime më thotë që janë duke ardhur gjenerata shumë më të mira. Mendoj se gjithmonë kam pasur edhe mirëkuptim për profesorët e mi dhe veçanërisht për nxënësit e mi. Jam përpjekur të kuptoj çfarë bie koha e re. Nuk i takoj atyre që nuk janë të gatshëm të kuptojnë njerëzit rreth vetes dhe nuk kuptojnë që koha e re po vjen“.

Jetoni (me) zanatin tuaj!

*Milla Çordasheviq
Drejtoreshë e Bibliotekës popullore dhe
sallës së leximit „Ivo Vuçković“*



Milla Çordasheviq me profesion është profesoreshë e letërsisë dhe siç thotë vetë, sipas vokacionit adhuruese e librave. Nga muaji maj të viti 1990, udhëheq punën në Bibliotekën popullore dhe sallën leximi „Ivo Vuçković“ në Tivar. Për rezultatet e arritura ka fituar titullin e bibliotekares më të lartë, ndërsa për kontribut të afirmimit të ndërmarrjes bibliotekare, është laureate e çmimit më të lartë esnaf shtetërorë “Dr Niko Simov Martinović”, të cilën e ndanë Asociacioni i bibliotekarëve të Malit të Zi. Është autore dhe përgatitëse e disa publikimeve profesionale dhe përzgjedhëse shumëvjeçare dhe redaktore e programit letrarë të Festivalit ndërkombëtarë multi-medial “Barski ljetopis”.

Për zgjedhjen e profesionit të Milës, ka dominuar dashuria pa kufi ndaj librit dhe leximit. Që nga fëmijëria e hareshme, deri më tani, me zell të pa shuar zgjatë dashuria e sajë ndaj letërsisë, ndërsa momenti kryesorë në karrierën e punës, ishte vendi që të ndërroj vendin e banimit, kur pas 10 viteve të punës si profesoreshë në shkollë të mesme, ka filluar të merret me bibliotekari. Siç thotë ajo, kjo i ka mundësuar edhe më shumë t’i përkushtohet librit dhe popullarizimit të tij.

Periodha kur Mila filloi të punoj si bibliotekare, ishte koha e tranzicioneve dhe koha e krijimit të identitetit shtetëror të Mali ti Zi. Gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur njerëzit ishin të fokusuar në çështjet dhe proble-

„Nuk ka sekret të madhë të suksesit – duhet vetëm të dashuroni profesionin tuaj me gjithë zemër dhe të i përkushtoheni deri në fund“.

met shoqëroro-politike dhe kur standardi jetësor ishte i ulët në Mal të Zi, kultura dhe zhvillimi kulturor ishin lënë pas dore. Mila në atë kohë është dashtë të investojë shumë mundë dhe energji, që në skenën publike të prezantohen vlerat e vërteta artistike dhe librat shkencore, si dhe në „mungesën e përgjithshme e parave“ t’iu sigurojë adhuruesve të fjalës së shkruar një fond cilësor të librave dhe t’iu mundësoj takim me shkrimtarët eminent nga vendi dhe regjioni.

Arritjen e vet të veçantë, por ndoshta edhe më të madhen, e konsideron suksesin që ka pasur të ruajë traditën e krijimit të programit letrar vetëm në mënyrë kualitative, si dhe angazhimin në ngritjen e punës së bibliotekës së Tivarit, e cila sot konsiderohet si një ndër institucionet publike udhëheqëse malazeze, ndër bibliotekat popullore.

Kontributi i Millës për zhvillimin e komunitetit lokal shihet në mundin e sajë të madh, që të ruaj rrethin letrarë në Tivar. Duke bashkëpunuar me shkrimtarët nga vendlindja, në promovimin e librave të tyre, iu ka mundësuar që opusin e tyre krijues ta paraqesin edhe në mjediset e tjera, festivalet vendase dhe të huaja. Kjo, pa mëdyshje, ka reflektuar edhe në imazhin e mirë të komunitetit lokal, si dhe në avancimin e kulturës në Tivar. Të realizosh të gjithë këto nuk ishte kollaj, sepse në punë shpesh është përballur me stereotipe. Veçanërisht stereotipi gjinor në vitet e mëherëshme i ka krijuar vështirësi për përparim në karrierë, sepse si femër në një pozitë udhëheqëse, shpesh është dashur para meshkujve të tregojë se idetë, mendimet dhe propozimet e saja, janë të drejta. Mendon se paragjykime të këtij lloji sot ngadalë po tejkalohen, ndërsa *“gratë shumë më shumë provojnë që janë njëlloj të afta si edhe meshkujt, për kryerjen e të gjitha profileve të punës”*.

Për suksesin e Millës nuk ka sekrete, rëndësi kishte dashuria ndaj profesionit të vet, këmbëngulja, dëshira e madhe dhe organizimi i mire i kohës, që obligimet e punës t’i përshtatë me ato private. Grave të cilat e pëlqejnë letërsinë dhe artin në përgjithësi, veçanërisht atyre që kanë dëshirë të merren me profesion të njëjtë apo të ngjashëm, iu rekomandon që duhet me të vërtet ta duan punën e vet, të jenë të qëndrueshme dhe në mënyrë të qetë t’i tejkalojnë barrierat në rrugën drejt suksesit.

SHËNDETËSIA

Të ndikosh në shëndetin e grave dhe të gjithë anëtarëve të shoqërisë, është faktor shumë i rëndësishëm në përmirësimin e standardit të vetë shoqërisë. Nevojat e grave, mungesat e sistemit dhe drejtimet e politikave zhvillimore të shëndetësisë, më së miri i njohin vetë gratë. Në përputhje me Planin lokal të Veprimit për barazi gjinore, në fushën e shëndetësisë janë planifikuar aktivitete të ndryshme promovuese dhe edukative që të përmirësohet shëndeti i personave në mjediset rurale dhe fshatra (në veçanti), shëndeti reproduktiv i grave, në mënyrë që të përmirësohet njohuria e popullsisë mbi parandalimin e disa sëmundjeve si dhe çështja e të drejtave të pacientëve. Komuna e Tivarit ka suksese të mirëfillta në fushën e përmirësimit të shëndetit dhe kësaj gjendjeje i kanë kontribuar edhe gratë anëtare të shquara të komunitetit. Në vazhdim do të paraqesim disa nga tregimet e tyre.

Në jetë dhe në punë çdo gjë duhet punuar në mënyrën më të mirë që mundemi

*Prim. dr sci. mjek. Milica Vuksanoviq,
Specijaliste e mjekësisë biokimike – pronare
e Laboratorit biokimik-mikrobiologjik
„Dr Vuksanoviq“*



Zonja Milica Vuksanoviq lindi në Pozhegë, Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Beograd, ndërsa specializimin për mjekësi biokimike dhe studimet postdiplomike i kreu në Zagreb. Magjistraturën dhe disertacionin e doktoratës i ka mbrojtur në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Ka publikuar 32 publikime shkencore në kongrese të ndryshme të vendit dhe ndërkombëtare. Ka publikuar tri libra nga fusha e diagnostikimit kliniko-laboratorik. Në Tivar jeton dhe punon tash 36 vite. Është e martuar dhe familja e saj janë: bashkëshorti Vasiliqe, dy vajzat: Draginja dhe Jelena dhe djali Savo.

Që nga fëmijëria ka pasur dëshirë të merret me mjekësi dhe gjuhë të huaja. Në fund prapë se prapë vendosi të merret me mjekësi. Pas kryerjes së fakultetit dhe praktikës, erdhi në Tivar dhe punoi në Shtëpinë e shëndetit, ku me dëshirën e vet filloi specializimet nga mjekësia biokimike. „Unë thjesht kam pasur dëshirë të merrem me diagnostikim dhe punë hulumtuese. Ky specializim në masë të madhe ma ka mundësuar këtë dhe kurrë nuk jam penduar. Edhe atëherë si dhe tani me kënaqësi e punoj punën time“, thotë dr Vuksanoviq.

Në jetë ka takuar në barriera dhe moskuptime, por ka mësuar të shkoj pas ëndrrave të veta dhe në atë mënyrë

me sukses t'i tejkalojë pengesat. Është interesante shembulli kur pas doktoratës është dashur të shkoj në Finlandë në kongresin Evropian për diagnostikim laboratoro-klinik. Edhe pse të shkuarit në konferencë, një pjesë ishte e financuar nga Ministria e shkencës së Malit të

Këshilli për gra:

„Zonja të dashura, vlerësoni aftësitë tuaja, çfarë është ajo që më së miri e punoni. A mund kjo punë të jetë kost-efektive. A keni treg për produktet-shërbimet tuaja. Flisni me institucionet për zhvillim të biznesit të grave, të cilat janë të gatshme t'ju ndihmojnë. Nëse të gjitha këto i shqyrtoni mirë, me guxim grahjeni punës, dhe sukcesi pa dyshim do të vijë.“

Zi, prapë se prapë ka takuar në moskuptim nga ana e drejtoreshës e cila nuk ka lejuar që ajo të shkojë, me kërcënim se do ta pushoj nga puna. Ky ka qenë një moment shumë i rëndësishëm për karrierën e Milicës, megjithatë karakteri guximtarë dhe që nuk bindet, e i cili është karakteristik për çdo njeri të suksesshëm, nuk ia ka lejuar të pranoj ndalesat dhe t'i përshtatet situatës - kur ishte e bindur se është në të drejtë. Ka shkuar në kongres të paraqes punimin e vet shkencorë. Çdo vendim i ka edhe pasojat e veta, kështu që pas kthimit ka fituar përjashtim nga puna. Shumë njerëz ishin dekurajuar në këtë situatë, por jo edhe Milica - ajo ka nisur çështjen gjyqësore e cila ka zgjatur tre vite dhe në fund ajo e ka fituar çështjen dhe është kthyer të punoj në Shtëpinë e shëndetit, duke i treguar me këtë rast të gjithëve korrektësinë e këtij veprimi. Gratë e suksesshme i lëvizin kufijtë dhe i thyejnë barrierat. Gjatë këtyre tre viteve, sa zgjati çështja gjyqësore, nuk e ka humbur kohën por është marrë me punë shkencore dhe me shërim.

Momenti vendimtar në karrierën e dr Vuksanoviç ishte kthimi në Shtëpinë e Shëndetit. Në atë moment ajo vërtetoi se ka nevojë të ndërroj mënyrën e punës, sepse puna zhvillohej në korniza dhe pa stimulim, ku as dituria e sajë, as aftësitë dhe kreativiteti nuk vëreheshin. Shumë shpejt merr vendimin të lëshoj Shtëpinë e shëndetit dhe të filloj hapjen e laboratorit. Ishte ky viti 1999, kohë e vështirë për biznes privat, kohë e pasigurisë, kur kompanitë shtetërore po mbylleshin, ndërsa ato private akoma nuk ishin zhvilluar. Sikur gjithmonë, edhe në këtë punë ajo hyri me guxim. Shumë shpejt laboratorit arriti në kulm me cilësi dhe efikasitet në punë. I mirënjohur në Mal të Zi, rajon dhe më gjerë, edhe sot gjendet në maje me pajisje, kolektiv profesional, i cili mundëson që në mënyrë cilësore dhe efikase të kryhet një numër i madh i analizave biokimike dhe mikrobiologjike.

Me punë dhe përkushtim dukshëm ka kontribuar komunitetin lokal. Ishte këshilltare në Kuvendin e komunës së Tivarit dhe deputete në Kuvendin e Malit të Zi. Si specialiste e mjekësisë biokimike ka zhvilluar, sipas mundësisë, diagnostikimin laboratorik në Shtëpinë e shëndetit, e pastaj në laboratorin private ka zhvilluar diagnostikimin dhe mundësinë e zhvillimit të analizave më të komplikuar për qytetarët e Tivarit, por edhe për qytetet e tjera në Mal të Zi dhe rajon. Mbështetja e familjes ishte shumë e rëndësishme për suksesin e tillë në punë, sepse „për të gjitha sukseset në një familje, meritë kanë të gjithë anëtarët. Gjithmonë e kemi ditur se cili është prioriteti i secilit në jetë dhe i kemi ndihmuar njëri tjetrin“. Mbështetja e familjes është çelësi i suksesit edhe në sferën private dhe të biznesit. Sot arritjen e saj më të madhe konsideron fëmijët - të cilët sikur edhe ajo, kanë ndjekur rrugën e vetë, duke u përsosur personalisht dhe profesionalisht; poashtu edhe dy mbesat e saja. Në vendin e dytë gjendet biznesi i saj privat, laboratorit „Dr Vuksanoviç“ me të cilën mburret, ndërsa punën e vet edhe sot e punon me të njëjtin elan si edhe në fillim.

Sekreti i suksesit është ...

„Guximi, vendosmëria që të nisni biznesin e ri. Në jetë dhe punë, çdo gjë duhet të punohet ashtu siç më së miri mundemi. Përcillni zhvillimin e profesionit dhe shkencës, kështu do të jeni në rrjedhë të ngjarjeve të reja. Të respektosh njerëzit me të cilët punoni dhe bashkëpunoni dhe mbi të gjitha të kuptosh dhe të respektosh njerëzit për të cilët punon - ofron shërbime. Të jesh profesionale dhe të respektosh afatin. Një thënie e vjetër thotë: „Mos i bën tjetrit atë çfarë nuk ke dëshirë që të tjerët ta bëjnë ty“. Ky ka qenë dhe do të mbetet moto i jetës sime.“

Profesioni si dhe jeta juaj, le të kenë një mision të qartë

*Prim. dr mjek. Vesna Keca Đokvuçiq
Shefe e repartit Gjinekologjik-obstetri në
spitalin e përgjithshëm të Tivarit*



Dr prim. Vesna Gjokvuçiq, më shumë e njohur me emrin dr Keca, ka lindur në Tivar, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin me diplomën „Lluça“. Fakultetin e mjekësisë dhe specializimin në gjinekologji dhe obstetrikë e kreu në Beograd. Karrierën gjinekologjike-obstetrike e nisi në spitalin e përgjithshëm në Tivar, ku edhe sot punon. Nëntë vitet e fundit është në krye të repartit të gjinekologjisë dhe obstetrikës. Në kongreset e vendit dhe ato ndërkombëtarë ka publikuar 32 punime shkencore nga fusha e gjinekologjisë, ndërsa edukimin e ka fituar edhe në seminare dhe kongrese të shumta në territorin e ish Jugosllavisë dhe jashtë vendit.

Mjekësia gjithmonë ishte dëshira dhe qëllimi të cilin ka tentuar ta arrijë. Që në shkollën fillore ishte e vetëdijshme që kjo do të jetë dashuria e saj e madhe, zgjedhja dhe profesioni i saj. Vesna vjen nga një familje e njohur e cila e ka udhëzuar në rrugë të drejtë dhe ishte mbështetje e ambicioneve të saja. „Prindërit e mi ishin të arsimuar dhe modernë, kurrë nuk më kanë penguar sa i përket arsimit dhe zgjedhjes së profesionit“, thotë ajo. Ishte e vetëdijshme që mjekësia kërkon heqje dorë nga disa gjëra sa i përket jetës private dhe që roli i gjinekologji-obstetrikës është njëri ndër rolet më të rëndësishme dhe më të vështira në mjekësi. Megjithatë, dashuria ndaj punës së vet e ka udhëhequr të zgjedh këtë lloj specializimi. Gjatë përparimit në karrierë kurrë nuk ka ndier ndonjë barrierë të rëndësishme. Ishte e vetëdijshme që përpara mund të eci vetëm

„Sekreti i suksesit tim qëndron tek puna e madhe, edukimi i vazhdueshëm dhe përcjellja e trendeve“.

me meritat e veta, me përkushtim, ambicie dhe dashuri të sinqertë ndaj punës. Me vetëmohim ka hyrë në punë, shpesh duke i lënë pas dore obligimet private, kështu që kufiri në mes jetës së saj private dhe punës nuk vërehet lehtë: „*Telefoni im kurrë nuk është i fikur, pacientëve të mi iu jam gjithmonë në dispozicion dhe me kënaqësi iu ofroj mbështetje dhe siguri. Lindja apo ndonjë rast tjetër emergjent, në asnjë mënyrë nuk duhet t'ia dijë për kohën time të lirë. Këto janë situata për të cilat, gjatë zgjedhjes së profesionit dhe marrjes së vendimit, duhet të jeni të përgatitur. Dhe të përgatitur jeni atëherë kur e doni punën e vet*“. Këtë punë jashtëzakonisht të përgjegjshme dhe me rëndësi si gjinekologe obstetrike, dr Keca e kryen tash tridhjetë vite dhe të gjithë fëmijët e lindur shëndosh paraqesin suksesin e saj më të madh. „*Ndjenja kur me pacienten e cila është shtatzënë, i kaloni nëntë muaj duke u kujdesur për te, me kontakte të shpeshta dhe relacion shoqërie, jep një gëzim të papërshkrueshëm i cili kulmon në momentin kur foshnja vjen në jetë dhe kur ia jepni të ëmës në duar. Këto janë momente të bukura të cilat i përjetoni me secilën nënë*“. Në punë kishte edhe momente të vështira për shëndetin e foshnjës dhe nënës: „*Edhe pse jeni të vetëdijshëm që nganjëherë nuk mund të ndikoni në çdo gjë dhe që gjendja është jashtë kontrollit dhe fuqisë tuaj, ndjenja është shumë e rëndë*“.

Jashtë spitalit, i cili paraqet „*shtëpinë e sajë të dytë*“, Vesna është aktive edhe në fushën e politikës. Këshilltare në Kuvendin e komunës, anëtare e Këshillit qendror të DPS. Është një person i gjithanshëm e cila seriozisht e kupton rolin e saj në shoqëri dhe obligimin t'i kontribuoj shoqërisë me angazhim në fushëveprimin e vet. Grave iu këshillon të arsimohen, të zgjerojnë diturinë dhe njohjet në domenin e interesimit dhe veprimit të vet; të jenë të vetëdijshme dhe ekonomikisht të pavarura.

Mos iu druani sfidave

Dr Gina Masoniçiq
*Specialiste e mjekësisë interne, pro-
nare e IPSH „Dr Masoniçiq“*



Zonja Gina Masoniçiq me profesion është mjekë, specialiste e mjekësisë interne. Të merret me këtë profesion ka vendosur për arsye të gjërave pozitive që ky profesion bartë: humanizëm të madh, ndjesisë që mund të ndihmosh njeriun, ndjenja e kujdesit mbi shëndetin e tjetrit, mbi jetën e dikujt. Që këtë profesion e pëlqen jashtëzakonisht, tregon edhe fakti që dr Gina nuk punon vetëm sipas një kornize të rreptë pune, por që nga viti 2001 themelon OJQ “Povjerenje” e cila merret me punë sociale dhe humanitare. Doktoresha Masoniçiq për tridhjetë vite ka punuar në shërbim civil. Megjithatë, me reformën e mbrojtjes primare shëndetësore (në vitin 2011) vendi i saj i punës si specialiste e mjekësisë interne në Shtëpinë e shëndetit, mbyllet. Asaj i ofrojnë një opion të vetëm dhe për te të papëlqyeshëm, të bëhet mjekë e zgjedhur. Pasi që nuk i ka pëlqyer ky opion, atë e shpallin si të tepërt. Dituria, eksperiencia dhe afirmimi i dukshëm nuk kanë lejuar që rrethanat të shënojnë fundin e karrierës profesionale të saj, kështu që vendosë të filloj vetë të punoj dhe shpejt hapë Institucionin privat shëndetësor - ordinancën specialistike të mjekësisë interne “Dr Masoniçiq”. Përveç dashurisë ndaj profesionit të zgjedhur edhe arsyeve ekzistenciale (nënë e dy djemve, bashkëshorti i cili në atë kohe ndodhej i papunë), gjithashtu kanë ndikuar që “të fillojë nga fillimi”. Banesën e ka shndërruar në hapësirë pune, ka hapur ordinancë private, dhe ka vazhduar të punoj “atë çfarë më së shumti dashuron dhe më së miri punon”.

„Më herët shpesh kam dëgjuar që biznesmenët privat nuk kanë kohë të lirë dhe ky është fakt. Të duket gjatë gjithë kohës se edhe diçka më tepër mund të bëhet. Por nëse je e vetëdijshme cilat janë mundësitë dhe kufijtë tuaj dhe që jeta e jote është në duart tuaja, çdo gjë mund të organizohet ashtu që të mund të realizoni të gjitha obligimet: para së gjithash obligimet e gruas (nënës, bashkëshortes, vajzës, nuses, shoqes), mjekes profesionale dhe punëtores shoqërore“.

Barriera kryesore për fillim të biznesit të vet për doktoreshën Gina ishin mjetet financiare. Si moment kryesor dhe impuls pozitiv në vendimin që të vendos të hap institucionin privat shëndetësor, e thekson konkursin e BSC Tivar për mbështetjen kreditore me kushte të volitshme. Pikërisht gjatë këtyre ditëve të mëdyshjes së saj, konkursi kishte dalë dhe doktoresha aty shikoi shansin e vet. Me ndihmën e mjeteve kreditore ka arritur të rregulloj të gjitha nevojat dhe të sigurojë kushtet për punë dhe fitimin e lejes nga Ministria e shëndetësisë.

Ajo çfarë ka paraqitur problem të madh gjatë hapjes së IPSH-së, ishin “letrat”- lejet e ndryshme, marrëveshjet, të cilat shpesh varen nga individë dhe për marrjen e të cilëve nevojitet shumë kohë. Përgjithësisht, e rëndësishme ishte

mbështetja e familjes dhe miqve dhe në fund kur çdo gjë përfundoi, ordianca filloj të punojë, ndërsa mjekja Gina fitoj rastin të vazhdoj punën e vet; me më shumë liri të zgjerohet horizontet e interesimit të vet në kuadër të profesionit, të hulumtojë zgjedhjet e ndryshme inovative në mjekësi, të organizoj

“Sekreti i suksesit tim janë njerëzit e mirë që më rrethojnë – bashkëshorti im dhe fëmijët, familja, miqtë, por edhe njerëzit e panjohur. Thënia popullore thotë: bën mirë edhe kur nuk shihet - mendoj se e kam bërë këtë gjë pa pritur që të më paguhet e të më kthehet me ndonjë shërbim, por çdo gjë më është kthyer me të mirë kur e kisha më së vështiri“.

seminare në këtë fushë, t’u mundësoj mjekëve tjerë të vizitojnë ordinancën dhe të fitojnë një ditë për vizitat e tyre profesionale. Me një fjalë, atë çfarë ia ka mundësuar dituria dhe praktika shumëvjeçare, tani është në gjendje të ofroj në terrenin e vet, lirshëm të shtojë shërbime ekstra në mjekësi, programe në fushën e edukimit shëndetësor, siç janë p.sh. Programi “Pyet mjekun”, si dhe aktivitete tjera të shumta (matja falas e tensionit, sheqerit, kontrollimet preventive të gjirit, gjëndrës tiroide e të ngjashme). Në këtë moment arritjen e vet më të madhe e konsideron mundësinë që edhe më tutje të merret me punën që dashuron dhe “përmes së cilës jeton”, të jetë në shërbim të pacientëve të vet, duke iu dhënë ndonjë këshillë, fjalë të bukur dhe kujdes të sinqertë. Nga ana tjetër, satisfaksion të madh paraqet edhe besimi dhe relacioni miqësor të cilin ia dhurojnë pacientët e saj. Kësi relacioni me pacientë - siç thotë ajo, njerëz të mirë që e rrethojnë - si dhe mbështetja e të afërmeve, paraqesin sekretin e suksesit të dr Ginës.

Si stereotip më i madh, i cili dikur ishte aktual në mjekësi, ajo thekson atë që mjekësia është punë për meshkuj. “Por sot më shumë gra kryejnë mjekësinë. Është fakt që disa degë të mjekësisë, p.sh. degët e kirurgjisë, përveç diturisë së madhe kërkojnë edhe stabilitet psikik dhe forcë të madhe fizike, por ka gjithnjë e më tepër gra të cilat merren edhe me këto degë të mjekësisë. Këshilla për gra do të ishte: të mos frikësohen nga sfidat. Para së gjithash të edukohen, të kenë informata mbi biznesin, sepse mund të jenë më të mirat në fushën e vet, por tregu i ka ligjet e veta të cilat nuk i njohin. Për mua shumë domethënëse ishin puna dhe çdo edukim i mundshëm nga sektori i OJQ-ve”.

Sekreti i suksesit është në komunikimin e suksesshëm me njerëzit që ju rrethojnë

Ganimete Hoxha
*Specialiste e mjekësisë së përgjithshme,
Shtëpia e shëndetit në Ostros*



Dr Ganimete Hoxha është specialiste e mjekësisë së përgjithshme dhe punon në Shtëpinë e shëndetit Tivar - pika shëndetësore Ostros. Lindi në vitin 1960 në Klinë, Kosovë, Fakultetin e mjekësisë e kreu me 1987 dhe atë vit u martua në Katerkollë, ku edhe jeton tani. Nënë e dy fëmijëve. Punën e përhershme e fitoi në vitin 1997 dhe që nga atëherë punon në mjediset rurale Peçuricë dhe Ostros. Specializimin e mjekësisë së përgjithshme e kreu me sukses të shkëlqyer në vitin 2007, ndërsa liçencën për praktikë nga Dhoma e mjekësisë së Malit të Zi e fitoi në vitin 2011.

Në zgjedhjen e këtij profesioni ka dominuar *”ndjenja humane e theksuar dhe dëshira të ndihmoj të sëmurit, t’i shërojë dhe lehtësojë dhimbjen e tyre”*. Ganimetja mund të lëvdohet me punën e saj bujare dhe përpjekjet e saja, profesionalizmin dhe angazhimin në komunitetin lokal. Sekretin e suksesit e konsideron *”këmbënguljen, punën dhe komunikimin e suksesshëm me njerëzit të cilët e rrethojnë”*. Në marrëveshje me komunitetin lokal ka arritur të organizojë në Ostros tubime dhe ligjërata mbi diabetin, stilet e shëndosha të jetës, tumorin në gji dhe tema të ngjashme.

Duke pasur parasysh se punon në Ostros, vend rural i komunës së Tivarit në të cilin është vështirë të mbërrihet për arsye të largësisë dhe infrastrukturës së keqe të rrugëve, pengesa të veçanta në punën e saj ishin edhe kushtet e motit, të cilat në situata të caktuara është dashur t’i tejkalojë. Largësia e pacientëve deri tek të cilët është dashur të mbërrijë gjithashtu ishte një problem i madh të cilin ajo në bashkëpunim me komunitetin lokal është dashur ta zgjedh. Veçon rastin kur para katër viteve, për

shkak të gjendjes së jashtëzakonshme kur rrugët ishin të mbyllura nga bora, është dashur të gjendet mënyra që të sëmurit të transportohen deri në spital në Tivar. Për fat të mirë, në bashkëpunim me policinë lokale dhe vendasit, kjo gjë është kryer me sukses.

Në punën e vet Ganimetja ka hasur pengesa të ndryshme qoftë sociale, fetare apo ndonjë tjetër, por me këmbënguljen dhe aftësinë e vet me sukses i ka tejkaluar. Punën e vet të çmuar, relacionin miqësor me vendasit dhe respektin e tyre, i konsideron arritjet e veta më të mëdha. Gjithashtu, konsideron që me përkushtimin e vet personal, në masë të madhe ka siguruar donacione nga organizata ndërkombëtare TIKKA (Turqi) për të pajisur ambulancën në Ostros, si dhe donacionet e vendasve të cilët jetojnë jashtë vendit për blerjen e makinës për patronazhë dhe makinës së urgjencës. Këto dy gjëra i konsideron kontributin e vet më të madh për komunitetin lokal, ndërsa afirmim për përkushtimin e vet ka fituar gjatë vizitës së Ministrit të shëndetësisë në ambulancën e Ostrosit.

„Roli i mjekes duhet të jetë mirë i harmonizuar me rolin e nënës dhe bashkëshortes, sepse ky profesion nganjëherë kërkon edhe punë jashtë orarit të punës“. Ganimetja ka mbështetjen dhe mirëkuptimin e plotë të familjes, çfarë edhe ia mundëson që t'i përkushtohet punës në mënyrë të drejtë. Grave iu këshillon që të jenë punëtore me çfarëdo pune që të merren, të zgjedhin punën të cilën e duan dhe për të cilin kanë afinitet; të harmonizojnë mirë punën dhe jetën private dhe ta organizojnë mirë kohën.

KULTURA, MEDIAT DHE SPORTI

Kultura, mediat dhe sporti njihen për rëndësinë e vet si fushë e veçantë për të cilën duhet marrë masa dhe aktivitete të mëtejshme në mënyrë që të arrihet niveli i dëshiruar në fushën e barazisë gjinore. Përmes mediave kryhet informimi i publikut mbi gjendjen dhe nevojat për zhvillimin e barazisë gjinore, prandaj është e rëndësishme të edukohen gazetarët dhe gazetaret mbi shfrytëzimin e gjuhës së ndjeshme gjinore si dhe për vetë programin, masat dhe aktivitetet për zhvillim të barazisë gjinore në Mal të Zi. Kultura, mediat dhe sporti kanë rol të rëndësishëm në krijimin e opinionit publik sa i përket kësaj çështjeje, prandaj edhe munden të kontribuojnë shumë në eliminimin e stereotipeve dhe paragjyqimeve në shoqërinë tone, si dhe afirmimin e krijimtarisë femërore. Me programin e barazisë gjinore në këtë fushë janë paraparë aktivitete si: zhvillimi i programeve të mediave të cilat merren me këtë problematikë, hapjen e rubrikave të reja për gra në

mediat lokale, organizimin e shpërblimeve vjetore për gra, si dhe organizimin e ekspozitave, panairove dhe manifestimeve të krijimtarisë kulturore të grave. Në fushën e sportit, është e nevojshme të krijohen politikat nxitëse për zhvillim të sportit për gra si dhe për eliminimin e stereotipeve lidhur me ndarjen tradicionale të sporteve në ato “mashkullore” dhe “femërore”. Në vazhdim do të cekim tregimet e grave të suksesshme nga komuna e Tivarit, të cilat i lëvizin kufijtë e të menduarit tradicional dhe të cilat kanë arritur të afirmojnë punën dhe krijimtarinë e vet.

Ndiqni ëndrrat tuaja dhe këmbëngulni në realizimin e tyre



*Anastazija Miranoviq
Historiane arti*

Zonja Anastazija Miranoviq është nga Kotorri, por vite me radhë jeton në Tivar. Në kohën e fundit është e angazhuar me punë në Cetinë si drejtoreshë e Këshillit për mbrojtjen e të mirave kulturore të Malit të Zi. Profesionin e saj është arti/historiane e artit, me titull këshilltare e muzeut, kritike arti, dizajnuese e modës, master e turizmit kulturor dhe momentalisht doktor nga e njëjta lëmi në Fakultetin për turizëm Tivar. Zonja Miranoviq është gjithashtu edhe presidente dhe anëtare e shumë asociacioneve - presidente e “Organizatës së grave Tivar”, aktualisht “Zonja e kamelies”, anëtare e Rotary klub Tivar, anëtare e Këshillit Ndërkombëtarë të muzeve (ICOM)- rrjetit i cili bashkon mbi 30.000 profesionistë nga kjo fushë, Këshillit ndërkombëtar për mbrojtjen e monumenteve dhe vendeve historike (ICOMOS), presidente e Këshillit të shkollës fillore të arsimit muzikor “Petri i II Petroviq Njegosh” në Tivar, anëtare e bordit drejtues të fondacionit „Petar Llubarda“, anëtare nderi e FRAMOG (shoqëria e miqësisë gjermano-malazeze me seli në Nirenberg), anëtare e Maticës malazeze - dega e Tivarit, etj. Në politikë është e angazhuar si këshilltare e partisë DPS në Tivar, anëtare e bordit kryesor dhe ekzekutiv të DPS-it në Mal të Zi, anëtare e Presidencës ZHAD (Alijansa e grave DPS).

Sipas natyrës Anastazija është një person kreativ dhe i gjithanshëm dhe kjo e ka shtyrë që si profesion dhe angazhim shtesë të zgjedh fushën e kulturës dhe artit. “Jeta në Kotorr, ndikimi i prindërve, veçanërisht i

NIJE PREVEDENO NA ALBANSKI....

nënës, e cila edhe vetë është një person shumë i talentuar dhe kreative, kreativiteti dhe ndjenja për estetikë - kanë ndikuar që historia e artit të jetë vokacioni im profesional. Në rastin tim, predispozita, familja dhe rrethi ishin faktorë të vendimit tim”.

Pas marrjes së vendimit se në cilën fushë dëshiron të punojë, është orientuar kah edukimi kështu që rruga e sajë deri tek profesioni i sajë primar, që nga fillimi ishte e udhëhequr nga predispozitat e saj dhe arsimimi. Momenti kryesor në jetën e Anastazijës ishte vendimi i saj që përveç historisë së artit, të merret edhe me dizajn të modës, në momentin kur sipas përcaktimit të saj, kushtet u plotësuan për këtë gjë. Shtytjen për këtë ia ka dhënë familja e cila e ka mbështetur plotësisht. *“Familja është kryesore për kësi lloj vendimesh, ajo është shtytja, dikush që në momentin e duhur të mbështet, të ndihmon, dhe të nxit”*, thotë Anastazija.

Deri tani ka organizuar dhe prezantuar disa koleksione të modës: „Crno ili Bijelo“, „Sjaj Mediterana“, „Noć u slavu vijeka“, „Kaputom kroz stilove“, „Dolce Vita“, „Pod kapom Njegoševom“ i „Ukus božanskog“. Në shprehjen e vet artistike reflekton kulturën dhe traditën e Malit të Zi dhe shfrytëzon edhe qasje moderne, bashkëkohore dhe kreative ndaj historisë dhe artit.


Me punën dhe përkushtimin e vet ka dhënë kontribut të rëndësishëm për komunitetin lokal, që reflektohet në ngritjen në nivel më të lartë të jetës kulturoro-artistike të qytetit; në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fuqizimin e grave të shfaqin aftësitë e tyre kreative. Përmes angazhimeve të veta në sektorin e OJQ-ve dmth. përmes Organizatës së grave Tivar dhe Rotary klub, ka organizuar dhe ka marrë pjesë në projekte dhe programe të shumta me karakter humanitar si dhe aksioneve të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të komunitetit lokal, siç janë panairët, ekspozitat dhe manifestimet e tjera.

Arti është fushë e veprimtimit ku njëlloj realizohen edhe meshkujt edhe femrat, kështu që nuk ka pasur rast të takojë në stereotipe lidhur me profesionin e saj, si dhe në ndonjë barrierë tjetër serioze. Nga ana tjetër, duke u marrë me politikë ka takuar në pengesa. *“Në shoqërinë e malazezëve gruaja së pari akoma njihet në rolin e nënës dhe amvisës. Për fat të mirë, unë në familjen time nuk kam kësi lloj paragjykimesh, bile jam edhe pjesëmarrëse aktive e seminareve-puntorive për gra - trajnere në partitë politike, të cilat kërkojnë pjesëmarrje më të madhe dhe fuqizimin e grave në politikë”*. Për arsye të angazhimeve të shumta, e sidomos të natyrës politike, shpesh është dashur të vendosë balosnin në mes jetës private dhe punës. Mendon se vetëm me organizim të mirë dhe me ndihmën e të gjithë anëtarëve të familjes ka arritur balosnin e vërtetë.

Arritjen e vet më të madhe në jetë Anastazija i konsideron fëmijët e vet dhe të qenit prind. Në aspektin profesional mendon që akoma nuk ka arritur deri tek realizimi i sajë më i lartë. Sekretin e suksesit të saj është *“fuqia e personalitetit, energjia e madhe kreative, qëllimi i qartë, kredibiliteti/kapaciteti që të arrihet, vullneti i madh dhe këmbëngulja. Si parakusht për të gjithë këto janë dituria, talenti dhe rrethanat e volitshme dhe nënkuptohet mbështetja e familjes”*. Prandaj porosia e saj për të gjitha gratë të cilat dëshirojnë të merren me art si profesion është *“të ndjekin ëndrrën e tyre dhe të këmbëngulin që ta realizojnë!”*

Ndiqni talentin tuaj

*Radmilla Vojvodiq
Drejtoreshë Teatri*



Zonja Radmilla Vojvodiq është drejtoreshë teatri, dramaturge dhe profesoreshë në universitet. Në Fakultetin e arteve të dramës në Beograd ka diplomuar për regjisore në vitin 1985 dhe në të njëjtin fakultet ka nisur karrierën blues“ (2005) dhe „Everyman Djilas“ (2013). Është presidente e Shoqatës së artistëve të dramës të Malit të Zi (UDUCG) dhe themeluese e revistës për Teatër Arti dhe Kulture GEST (1999). Fituese e çmimeve profesionale dhe shoqërore dhe mirënjohjeve, si dhe e çmimit më të lartë të shtetit - çmimin e 13 korrikut (1997). Është profesoreshë e rregullt në Programin e Studimeve Regji Teatri dhe dekanë në Fakultetin e Arteve të Dramës në Cetinë. Anëtare e Akademisë së Shkencës dhe Artit të Duklës, ndërsa në fillim të prillit është propozuar, me shumicë të votave të anëtarëve të Senatit, për rektoren e Universitetit të Malit të Zi, për mandatin në periudhën 2014 - 2017. universitare në vitin 1988. Ka bërë regjinë e teksteve të dramaturgjisë klasike dhe bashkëkohore në shumë shtëpi referente të teatrit, në hapësirat kulturore të Jugosllavisë. Shfaqjet të cilat Radmilla Vojvodiq ka realizuar, kanë marrë pjesë dhe shpërblyer në festivale të shumta. Radmilla është autore e dramave „Princeza Ksenija od Crne Gore“ (1993), „Montenegrini“ (1998), „Montenegro

Dashuria ndaj artit e ka nxitur zonjën Vojvodiq të merret me këtë profesion. Barrierat në të cilat ka hasur gjatë zgjedhjes së profesio-

„Sekreti i suksesit tim është në përkushtimin e vërtet ndaj profesionit, pa lëvdime, pa marrë parasysh suksesin e arritur“.

onit janë reflektuar në moskuptim të caktuar në fillim tek prindërit. Ky moskuptim ishte shkaktuar nga brenga që profesionet artistike bartin pasiguri për karrierë. Por, Radmilla ishte një nxënëse e shkëlqyer, e përgjegjshme dhe e pavarur. Shpejt fitoi besimin e prindërve. Por, edhe nëse nuk do ta kishte fituar, njëlloj do të kishte zgjedhur të njëjtën gjë dhe do të kishte vazhduar të shkoj pas bindjeve të veta, sepse konsideron që nuk ekzistojnë pengesa të pakapërcyeshme nëse besoni në talentin personal. Momenti kryesorë në karrierën e sajë ishte viti 1992/1993 kur gjatë kohës së luftës dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, ka ndërprerë karrierën universitare në Fakultetin e dramaturgjisë në Beograd dhe ka ardhur të jetoj në Podgoricë, ku nuk ka ekzistuar as fakulteti dhe as teatri në ato vite (pasi Teatri Popullor ishte i shkatërruar nga zjarri). Në atë kohë ka vendosur të shkruaj dhe ka shkruar dramën e saj të parë „Princeza Ksenija e Malit të Zi“, e cila u bë shfaqja kryesore e skenës malazeze dhe një lloj i fenomenit të teatrit politik tek ne.

Arritjen e sajë më të madhe Radmilla e konsideron mëmësinë, ndërsa për arritjet më kryesore në profesion nuk mund të deklarohet. Në Tivar në atë kohë është marrë edhe me festivalin „Barski ljetopis“, por për arsye se me punë është e lidhur për Podgoricë dhe Cetinë, konsideron se mund të lëvdohet me kontributin domethënës për komunitetin lokal të Tivarit. Megjithatë, ajo vjen nga një familje e njohur e Tivarit dhe me arritjet e veta (puna në teatër, duke shkruar dhe regjisuar, duke u marrë me temat të cilat e interesojnë, përmes misionit pedagogjik në arsim të lartë artistik...), mund të konstatohet që „e zbukuron“ qytetin e Tivarit. Si stereotipe që ka takuar ajo thekson: “Kur kam diplomuar, ky profesion ishte profesion dominues i meshkujve, ndërsa për gra më natyrale ishte të ishin aktore”.

Duke marrë parasysh obligimet e shumta, Radmilla mundohet që të jetë sa më shumë në harmoni me vetveten dhe të jetë më solidare me njerëzit me të cilët jeton dhe punon. Konsideron që është me rëndësi që çdo gjë që punon njeriu, të besojë në vete dhe aftësitë e veta të vërteta!

Në „shkallën muzikore të suksesit“ ekzistojnë pengesa, por nuk janë të pakapërcyeshme, kur keni një vendim të qartë për profesionin tuaj

*Aleksandra Vojvodiq-Jovoviq
Drejtoreshë e SHAFM „Petri i
II Petroviq Njegosh“*



Soprano mr Aleksandra Vojvodiq-Jovoviq lindi me 06.03.1975 në Tivar. Arsimin muzikor e ka filluar në vendlindje, në shkollën për arsim fillore të muzikës “Petri i II Petroviq Njegosh”. Pastaj përfundon shkollën e mesme të muzikës “Vasa Paviq” në Podgoricë dhe atë në dy departamente: teorike dhe departamenti i solo këndimit në klasën e profesoreshës Llarisa Dashiç-Simoviq. Akademinë muzikore-departamentin teorik e ka kryer në Cetinë, pas së cilës regjistron Akademinë muzikore në Sarajevë, departamenti i solo këndimit në klasën e primadonës, profesoreshës Radmilla Bakoçeviq ku diplomoi në vitin 2006. Ka magjistruar në vitin 2013 në klasën e mr Alleksandra Ristiç. Ndërkohë ka punuar si profesoreshë e solfejgos, teorisë së muzikës dhe ka dirigjuar korin e shkollës së ulët muzikore në Tivar. Tani punon si drejtoreshë e SHAFM “Petri i II Petroviq Njegosh” në Tivar, jep solo këndim në shkollën për talente të muzikës „Andre Navara“ në Podgoricë dhe është aktive në skenën muzikore të Malit të Zi. Fituese e shumë çmimeve nga të cilat më të rëndësishme janë: çmimi i parë në garat republikane dhe çmimi i dytë në garat ndërkombëtare „Petar Konjoviq“ në Beograd. Pas vetes ka një numër të madh të shfaqjeve dhe koncerteve solistike në Mal të Zi dhe jashtë vendit. Në repertorin e saj mund të gjenden opera dhe arie nga oratoria, romancat ruse, këngët solo të shekullit njëzet dhe këngët solo malazeze të cilat i ka aranzhuar vetë për këndim opera dhe zë. Ka inçizuar CD-në „Rrënjët“, në të cilën gjenden këngët tradicionale malazeze. të përpunuara për zërin akademik në stilin New age. Me kolegun Aleksandër Basaraba ka përpunuar edhe himnin e Tivarit dhe pastaj e ka ekranizuar.

„Sekreti i suksesit tim rrin në vizionin e qartë, angazhim pa rezervë, organizim të mirë dhe dashuri të sinqertë ndaj punës, jetës dhe njerëzve të cilët më rrethojnë“.

Aleksandra qysh në fëmijëri ka treguar talent të jashtëzakonshëm për muzikë, të cilën e kanë vërejtur profesorët që në provimin hyrës në shkollën e ultë të muzikës. Në koret shkollore shpesh ishte soliste, dhe krahas me këndim ka marrë pjesë edhe në seksionet e ndryshme, nga drama deri tek recitimi. Kanë vazhduar më pas rezultatet e favorshme të arsimit të saj muzikor dhe çmime të shumta në gara, të cilët e kanë motivuar të shkojë më tutje, në nivel më të lartë të arsimit. Në „*shkollën muzikore të suksesit*“ nuk është ballafaquar me pengesa të rëndësishme. Gjithmonë është udhëhequr me talentin e vet, dashurinë ndaj muzikës dhe me vendim të qartë për profesionin e saj, kështu që si rrjedhojë logjike e ngjarjeve ishte edhe regjistrimi në akademinë muzikore dhe karriera e muzikës. Në këtë rrugë profesionale ka hasur në problem të moskuptimit nga ana e disa njerëzve nga fusha e saj, të cilëve çdo ndryshim dhe novitet iu ka penguar. Për fatin e saj të mirë, ka pasur edhe aso njerëzish fisnik dhe përparimtarë të cilët kanë ditur të vlerësojnë kualitetet e saja dhe përzemërsisht ta ndihmojnë të vazhdojë më tej. Tani kënaqet me punën me të cilën merret, por njëkohësisht edhe me rolet e shumta që i kryen, si: soliste, pedagoge, menaxhere, amvise dhe mbi të gjitha nënë e tre fëmijëve. *“Harmonizimi i të gjitha këtyre roleve nuk është i lehtë, por me mbështetjen e bashkëshortit dhe mirëkuptimin e familjes çdo gjë arrihet”*, thekson Aleksandra. Gjëja me e përzemërt në jetë është që është bërë nënë dhe që pas obligimeve të shumta në punë iu kthehet në shtëpi fëmijëve të vet dhe burrit. Aleksandra mendon që gruaja është shtyllë e familjes dhe e shoqërisë, por që të jetë e fortë dhe të përballojë të gjitha pengesat në jetë, ajo duhet të jetë e arsimuar dhe e pavarur. Përpos familjes të cilën e ka formuar, muzika është arritja e sajë më e madhe në aspektin profesional. Pa të nuk kishte mundur të ekzistoj dhe as të krijoj. Në muzikë e ndanë operën si artin më të bukur. *“Sa i përket interesimit tim, është qartë që në Mal të Zi kurrë nuk ka ekzistuar opera më parë. Që njerëzit t’i njoftoj me magjinë e artit më të madh dhe më të bukur - operën dhe këndimin e operës, kam filluar me edukimin e publikut, ashtu që jam nisur nga e njohura drejt të panjohurës”* - thekson Aleksandra. Në akademi ka mësuar solo këngë nga e gjithë bota dhe ka vërejtur që kompozitorët tanë nuk i kanë përpunuar këngët burimore, që është traditë e kahershme në vendet e jashtme – që këngët tradicionale të përpunohen për këndim në opera. Ka vendosur t’i përpunojë këngët burimore malazeze në mënyrë moderne dhe si këngë solo (zëri, piano). Ka inçizuar edhe spote muzikore, siç thekson, me qëllim që të mësojë publikun me këtë lloj këndimi. Idetë e saj janë realizuar. Ka hapur seksionin e këndimit në shkollën e ulët të muzikës, në të cilën kryen funksionin e drejtoreshës. Gëzim të veçantë paraqet që çdo vit nga njëzet nxënës regjistrojnë solo këndimin. *“Këta fëmijë ose do të merren me këndim, ose do të jenë publiku i ardhshëm i edukuar, i cili do të pëlqej këtë lloj arti”*. Aleksandra menaxhon shkollën e cila numëron 35 të punësuar dhe 427 nxënës. *“E gjithë energjia dhe koha që investoj në punën pedagogjike, paguhen kur në fund i përmbledh rezultatet nga shfaqjet dhe garat”*. Jep mësim të solo këndimit edhe në shkollën për talente të muzikës “Andre Navara” në Podgoricë, ku punon me fëmijë të cilët kanë vendosur të ndjekin shembullin e saj, d.m.th. që këndimi i operave të jetë profesioni i tyre. *“Kam besim në divat e ardhshëm malazeze të këndimit të operave. Shpresoj tek primadonat e ardhshme të këndimit të operave. Dhe shkoj më tutje, përgatis hapin e mëtejshëm, me shpresë që do të arrijë qëllimin kryesorë. Tani e kam publikun e besueshëm, shumë kam bërë, por edhe më shumë duhet të bëj. Lufta ime për këtë lloj arti dhe jeta ime në të akoma zgjasin. Dhe nuk do të heq dorë”* - është e vendosur Aleksandra.

Me hapa të lehtë por të sigurt, ecni drejt qëllimit

Vanja Pantoviq
*Themeluese e shkollës së baletit
„Princeza Ksenija“*



Zonja Vanja Pantoviq është profesoreshë e muzikës, themeluese dhe drejtoreshë e shkollës së baletit. E respekton shumë artin e Rikard Wagnerit dhe fokusi i saj në punë është i orientuar kah hulumtimi i të gjithë segmenteve të punës së këtij njeriu të madh, i cili në masë të madhe e formon jetën e saj profesionale dhe private. Zonja Pantoviq është e martuar dhe ka një djalë i cili është student i suksesshëm i historisë së artit. Nevoja që kreativiteti të shndërrohet në rezultat konkret dhe të ndjek instinktët e veta, e ka shtyrë në zgjedhjen e profesionit.

Barrierat janë të gjithëpranishme në shoqërinë tonë, kështu që ka pasur mjaft edhe në punën e saj. Në radhë të parë, barriera rreth realizimit të normave të parapara me ligj, të cilat në rastin e shkollës së Vanjës, si institucionit të parë arsimor privat, ishin vështirë të realizueshme. Bile është dashur edhe të udhëheq proces gjyqësor dhe në mënyrë pjesshme të krijojë kushtet për zhvillimin e punës në shkollë. „Këto ishin kohë të vështira. Më kanë humbur të gjithë dekadën. Nga viti 2010, çdo gjë vjen në vend të vet. „Princeza“ ka fituar subvencione dhe është nisur në fazën e stabilizimit të plotë“ thekson Vanja.

Vanja shijon kënaqësitë nga profesioni i vet dhe menaxhimi i shkollës private të baletit. Atmosfera në klasë nga dita në ditë, pandërprerë nxitë projekte të reja të zhvillimit. Shtytja në shpinë është e përhershme në pu-

“Sekreti i suksesit tim është këmbëngulësia, mosdorëzimi, gatishmëria që deri tek qëllimi të ngjitet me hapa të lehtë por të sigurt“.

nën e shkollës – „Princeshat e mia më inspirojnë dhe përkushtimi i tyre për punë dhe progres janë nxitësit më të mirë“. Në aspektin profesional për Vanjën, arritja më e madhe është themelimi i shollës. „Të gjitha sukseset e saja përbëjnë „koreografinë e madhe“ e cila gjithnjë

Këshilli për gra:

„Strategjia e mirë është çelsi i suksesit. Një plan pa gabime dhe pregaditja e përditshme! Agjenda me planifikim të mirë të çdo hapi. Shumë me rëndësi është edhe të investosh në vete. Në mënyrë konstante. Të përmirësosh resurset personale. Lexim, lexim, njohja e gjuhëve të huaja“.

rritet. Të gjitha premierat, të gjitha pjesëmarrjet në festivalet prestigjioze jashtë vendit, janë pjesë e suksesit madhështorë“. Kontributi për komunitetin lokal gjithashtu është pjesë e punës së vazhdueshme, e cila zgjat tash 13 vite. Kultivimi i numrit të madh të të rinjve dhe më gjerë, familjeve të tyre - publikut, paraqet një detyrë të madhe, delikate, por të rëndë dhe përgjegjëse. Vetë baleti është art i cili kërkon shkallë të lartë të edukimit në kuptimin më të gjerë. Mungesa e lojtarëve meshkuj në vendin tonë, i cili kultivon traditën heroike, në të cilën mashkulli nuk duhet të vesh kostum baleti, paraqet stereotipin më të madh. Disa djem që kanë pasur kurajo të hyjnë në sallën e baletit, shumë shpejt kanë rënë nën ndikimin e mjedisit. Nga ana tjetër, ata që e kanë përballuar këtë, kanë fituar çmime – angazhim dhe një të ardhme të bukur. Balanca në mes jetës private dhe punës së Vanjës është gjithmonë në mospërputhje, por mundohet që të arrijë çdo gjë. „Mundi i madh kërkon sakrificë të mëdha. Unë një kohë të gjatë gjendem në makinë e cila nuk më lejon aspak kohë pushimi. Normalisht, mundohem t'i arrijë të gjitha“, thotë Vanja.

Lidhni të bukurën dhe të dobishmen

*Jovanka Lubenko-Matunoviq
Themeluese e klubit artistik të
galerisë „Vega“*



Zonja Jovanka Lubenko-Matunoviq është gazetare-psikologe e diplomuar. Ka diplomuar në Fakultetin e shkencave politike në Beograd. Në karrierën profesionale ishte redaktore kryesore dhe përgjegjëse e Radios, korrespondente e gazetës „Pobjeda“, ndërsa në vitin 2000 ka themeluar galerinë private në Tivar. Një kohë të gjatë ka punuar si gazetare dhe në profesionin e saj dhe ka pasur “punë të përhershme”, megjithatë vitet e nëntëdhjeta kanë ndikuar që ajo të ndërroj zgjedhjen në jetë. I është dukur sikur kualiteti i punës së gazetarisë në atë kohë nuk vlerësohej. E lëshoi punën në kërkim të profesionit të ri i cili do të ishte “i mire për shpirt, i bukur për rrethinën, por njëkohësisht edhe fitimprurës”.

Ideja që të merret me kulturë ka ekzistuar gjithmonë tek ajo, edhe gjatë zgjedhjes së fakultetit kur ishte

„Sekreti i suksesit tim është këmbëngulja dhe vullneti“.

në mëdyshje a të zgjedh gazetarinë apo sociologjinë e kulturës. Jovanka nuk e ka zgjedh profesionin e tanishëm, por me sa duket ky profesion më vonë e ka zgjedhur atë. Meqë marrja me kulturë konsiderohet si diçka që nuk sjell fitim, vetëm dashuria ndaj artit e ka shtyrë që të hapë galerinë. Ekspozita e parë e madhe, në maj të vitit 2001, e cila ka mbledhur me qindra vizitues në rrugën më të vjetër të Tivarit, paraqet momentin kryesorë në karrierën e Jovankës. Kjo e ka nxitë që të vazhdojë punën duke i dhënë satisfaksion. Pas këtij sukcesi, eksperiencia e galerisë së saj i ka shtyrë dy student që të shkruajnë punimet e magistraturës në temën “Kultura si bazë poten-

cialë për biznes”. Mund të thuhet që në shembullin e eksperiencës së vet, Jovanka i ka shtyrë kufijtë e të kuptuarit tradicional të kulturës. Hapja e galerisë dhe interesimi që ajo ka nxitur, ka shtyrë edhe njerëzit e tjerë që të hapin galeritë e veta në Tivar, gjë që dukshëm ka përmirësuar ambientin kulturorë të këtij qyteti.

Realizimin më të madh në punën e saj Jovanka e konsideron projektin - librin e publikuar „Fytyra e re e rrugës së vjetër“, ndërsa si kontributin e vet më të madh për komunitetin lokal, ajo veçon rregullimin e hapësirës para galerisë në rrugën Marshall Tito – ku ka vendosur ulëse, skulptura, ka punuar katalogun e rrugës, pa donacione dhe ndihmë.

Këshillë për gra:

„Dozë e obligueshme e vetëbesimit, vendosmërisë dhe hapave të vegjël drejt qëllimit të dëshiruar!“

Stereotip e konsideron të menduarit se fusha e artit lidhet me personat pa aftësi domethënëse të organizimit, e që në shembullin e saj konkret nuk është rasti. Nuk ka pasur rast të takoj stereotipe gjinore dhe konstaton që gratë në punën e sajë janë të barabartë me meshkujt. Gjithashtu nuk i pëlqejnë privilegjet ndaj grave, siç nuk i pëlqen as barrierat: „Askush nuk duhet të kërkoj privilegj nëse vetë nuk e meriton“. Balancën në mes jetës private dhe punës, Jovanka e rregullon me një organizim të mirë, ndarjen në pjesën racionale të jetës dhe angazhim në favor të komunitetit.

Bëni praktikë të mirë, duke qenë vullnetarë - vetëm kështu do të kuptoni se çfarë ju pret në punë

**Vesna Shoshkiq
Gazetare**



Kompania amë në të cilën zonja Vesna Shoshkiq ka filluar karrierën e vet dhe për here të parë u takua me gazetarinë, është Radio Tivari. Në këtë stacion, njëri ndër më të vjetrit në Mal të Zi, ka mësuar shumë dhe kjo e ka ndihmuar më vonë në angazhimet e shumta, të cilat ishin në lidhje direkte apo indirekte me mediat dhe gazetarinë. Edhe sot ajo punon në këtë shtëpi, si redaktore dhe gazetare, ndërsa që nga viti 1999 punon edhe si udhëheqëse e tribunave letrare në Bibliotekën popullore „Radosav Lumoviq“, në Podgoricë. Nga viti 2000 punon si korrespondente e Televizionit të Malit të Zi (TVCG) nga Tivari.

Vesna karrierën profesionale e ka nisur si spikere në Radio Tivar. Emrat e njohur në gazetari, para së gjithash, Veselin Tomoviq dhe Darko Shukoviq, kanë punuar në këtë shtëpi informative dhe ndikimi i tyre dhe besimi të cilin kanë treguar ndaj saj, ishin të rëndësishëm që ajo të hyjë në botën e gazetarisë.

Kjo ishte edhe shtytje që të kryej fakultetin juridik dhe të angazhohet profesionalisht. Në punën e saj nuk ka takuar në stereotipe dhe barriera gjinore. Si barrierë në sensin profesional, ajo përmend vetëm kohërat turbulente në të ci-

„Grave të cilat planifikojnë të merren me gazetari, para se të vendosin që kjo të bëhet profesioni i tyre zgjedhës, iu rekomandojë që një kohë të caktuar të punojnë në ndonjë redaksi, që të njohin anët pozitive dhe negative të gazetarisë, sepse vetëm kështu do ta kuptojnë se çfarë i pret dhe a janë të gatshme për sakrificat të mëdha, dinamikë dhe jetë me stres, por kreative dhe më interesante se shumë profesione tjera.“

lat ka kaluar vendi ynë dhe të cilat veçanërisht u reflektuan në profesionin e gazetarisë, sepse ky profesion me vete gjithmonë bartë përgjegjësinë shoqërore.

Për Vesnën arritja dhe satisfaksioni më i madh paraqet ajo që gazetaria dhe puna në media i japin mundësinë që të jetë pjesëmarrëse direkte në shumë ngjarje të mëdha dhe të ofrojë ndihmë në vështirësi. Falë vizionit të qartë të Vesnës, shtëpia mediatike të cilën ajo e udhëheq, ka marrë pjesë dhe ishte nismëtare e aksioneve të shumta humanitare. „Ndoshta kjo e fundit ishte edhe arritja më e madhe, kur në kohën e krizës ekonomike dhe rënies drastike të standardit, përmes aksionit të Radio Tivarit janë mbledhur mbi 20.000 euro për shërimin e bashkëvendëses sonë të vogël Adelina Begziq, e cila u plagos rëndë në aksident me makinë. Duke pasur parasysh fuqinë dhe ndikimin e mediave në publik, gazetarët janë në gjendje të ndihmojnë komunitetin lokal në mënyrë të konsiderueshme“.

NIJE PREVEDENO NA ALBANSKI

Njëri ndër stereotipet më të mëdha lidhur me këtë punë është që gazetarët e mirë janë ato që janë provokues, depërtues dhe të cilët ngasin pas aferave dhe skandaleve,

duke u justifikuar me punën e gazetarisë hulmuese. Gazetarët gjithsesi duhet të zbulojnë dhe të tregojnë për negativitetin dhe të këqijat e shoqërisë, por kurrsesi nuk duhet të marrin rolin e gjyqtarit apo prokurorit. „Gazetare e mirë nuk është ajo e cila imponon mendimin e vet, por e cila me tekstin e vet, emisionin, me trajtim të plotë, duke konsultuar të gjitha palët apo pjesëmarrësit e ngjarjes, e shtynë publikun që vetë të bëjë gjykimin e drejtë“.

Vesna thekson që gazetaria është profesion pa orar pune, kërkon gatishmëri të plotë gjatë tërë kohës dhe shpesh edhe angazhim gjatë gjithë ditës, kështu që duhet investuar një mundë të madh që të ruhet jeta private. Prandaj mendon që gratë të cilat dëshirojnë të punojnë këtë punë, së pari duhet të bëhen vullnetare, apo nëse kanë mundësi të bëhen praktikante në ndonjë redaksie (psh. gjatë studimeve), që të njoftohen më përafërm me atë se çfarë i pret nëse dikur vendosin për karrierë profesionale në gazetari.

Thyeni barrierat

*Sanja Tripković-Gjurniq
Trajnere e KA „Sanja“*



Sanja Tripković-Gjurniq lindi me 14.05.1977. Është e martuar dhe nënë e tre fëmijëve. Fakultetin e ka kryer në Novi Sad dhe ka fituar titullin e trajneres së diplomuar për atletikë. Në Tivar ka themeluar klubin atletik „Sanja“ ku tani punon si trajnere.

Dashuria ndaj sportit, veçanërisht ndaj atletikës e ka shtyrë Sanjën të merret me këtë profesion. Me atletikë ka filluar të merret që në moshën 9 vjeçare dhe si garuese ishte shumë e suksesshme. *„Si dhe në të gjitha sferat e shoqërisë ashtu edhe në sport, dmth. në atletikë ekzistojnë stereotipe dhe paragjykime mbi rolet e meshkujve dhe femrave. Më kujtohet kur isha 15 vjeçare dhe isha prezente në një mbledhje të KA MORNAR. Në mbledhje flitej pikërisht për mua, karrierën time dhe mbi atë se çfarë duhet bërë dhe në çmënyrë që të vazhdoj me rezultate të shkëlqyeshme. Isha pioniere dhe sapo kisha filluar të fitojë medalje në kampionatet e Jugosllavisë. Në mbledhje u dakorduan që është gabim të investojnë në mua, sepse jam femër. Me këtë konfirmuan që tradicionalisht sporti shihet si segment mashkullor i shoqërisë. Gëzohem që kam arritur të rrëzoj stereotipet që në atë kohë kanë mbizotëruar në atletikë dhe kam tre-guar atëherë si një atlete e suksesshme ashtu edhe tani si një trajnere e suksesshme, që edhe gruaja duhet të jetë e barabartë me meshkujt“*, thekson Sanja.

Këshilla për gra:

“Mjafton që të besoni në aftësitë e veta sepse do të jeni të sigurt në vete aq sa ia lejon vetes të jeni të sigurt. Jini të guximshme dhe këmbëngulni në realizimin e qëllimit të vet.”

Me fitimin e çmimeve të shumta në garat ndërkombëtare, Sanja ka kontribuar për komunitetin lokal. Si anëtare e reprezentacionit të Jugosllavisë, ka përfaqësuar qytetin e vet dhe shtetin në garat ndërkombëtare. Ishte fituese e vendit të parë në Ballkan në 400 m me pengesa, pjesëmarrëse e kampionateve Evropiane dhe Botërore për junior. Dy herë me radhë ishte sportistja më e mirë e Tivarit.

Pas mbarimit të fakultetit ka filluar të punojë si trajnere në Klubin atletikë “Mornar” në Tivar. Mendon që çdo njeri në rrugën drejt suksesit takon në pengesa të shumta. Njëra ndër barrierat të cilën Sanja me sukses e ka tejkaluar, është kur disa njerëz janë munduar që ta ndalojnë të merret me atletikë, pas largimit nga KA “Mornar”. Megjithatë, ky moment ka paraqitur për Sanjën një kthesë në karrierë, sepse ajo themeloi klubin e vet atletikë “Sanja” Tivar. Klubi në vitin 2013 është treguar si klubi më i suksesshëm atletik në Tivar dhe Mal të Zi, në kategorinë e pionierëve dhe pionierëve dhe gjithashtu ka edhe përfaqësues senior të Malit të Zi, sportistë me perspektivë dhe me disa rekorde në Mal të Zi. Sanja konsideron që kjo është mënyra më e mirë e paraqitjes dhe promovimit të qytetit të vet, përmes arritjes së rezultateve të shkëlqyeshme.

Sekreti i suksesit të Sanjës gjendet, para së gjithash, në dashurinë ndaj punës me të cilën merret, dëshira ndaj suksesit, organizimi i mirë dhe mbështetja e madhe e familjes. Arritjen më të madhe për te, paraqet fakti që pas karrierës së suksesshme në atletikë, ka kryer fakultetin, është martuar dhe është bërë nënë e tre fëmijëve. *“Puna e trajneres kërkon shumë, dhe krahas obligimeve që një grua dhe nënë ka, kërkon punë të vështirë si në pistë ashtu edhe jashtë sajë”*, thekson Sanja.

EKONOMIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Hulumtimet e shumta tregojnë që gratë në biznes janë në përgjithësi më përgjegjëse, më analitike, të sakta dhe më të dedikuara në krahasim me meshkujt. Gratë në biznes anojnë më shumë kah bashkëpunimi, më shumë kujdesen për marrëdhëniet ndërpersonale, janë më të gatshme për kompromis dhe më mirë i kuptojnë interesat e palëve të ndryshme të interesuara; janë më të balancuara në analizën e menaxhimit të rreziqeve, më pak rrezikojnë dhe janë më precize gjatë planifikimit të punës. Mesatarisht janë edhe më të arsimuara në krahasim me kolegët e tyre meshkuj, megjithatë, janë shumë më pak të përfaqësuar në pozita udhëheqëse në biznes, në krahasim me meshkujt. Çështjen e relacionit në mes grave dhe zhvillimit ekonomik, e kemi shqyrtuar hollësisht sipas statistikës, në pjesën e dytë të publikimit. Padyshim kemi konstatuar që pjesëmarrja e grave në zhvillimin ekonomik është e nevojshme për zhvillim të shoqërisë si dhe për hyrjen në trendet evropiane dhe botërore. Në këtë pjesë do të bëjmë fjalë për gratë që kanë arritur të lëvizin kufijtë në botën që kryesisht dominohet nga meshkujt dhe kanë arritur të bëhen drejtoresha, pronare, menaxhere, fermere. Në vazhdim ndodhen rrëfimet e grave që ndanë me neve përvojat e veta.

Lëvizni kufijtë e mundësive tuaja

Vera Lekoviq
ndërmarrëse, pronare e agjencisë
„Royal Human Resources & Training
Consultancy“ sh.p.k.



Zonja Vera Lekoviq është ekonomiste e diplomuar me eksperiencë shumëvjeçare në turizëm dhe hotelieri. Në dhjetor të vitit 2009 mbeti pa punë dhe pas kësaj, si anëtare e vetme e Asociacionit të grave afariste, vendosi të filloj biznesin e vet. Në dhjetor të vitit 2010 hapi agjencinë turistike „Royal Club Travel“ në Podgoricë.

Fakti që rrethanat e tanishme në turizëm nuk janë në favor të zhvillimit të biznesit të agjencive dhe njëkohësisht vërehet mungesa e madhe e stafit profesional, e nxiti Verën që të themelojë agjencinë për ndërmjetësim gjatë punësimit, trajnimit praktik dhe specializim edukativ në sferën e turizmit dhe hotelerisë.

Agjencioni Royal Human Resources & Training Consultancy DOO është themeluar në vitin 2012 me seli në Tivar dhe është licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Malit të Zi. Agjencia ka katër persona të punësuar të përhershëm dhe tre bashkëpunëtor-konsulentë me të cilët, për një kohë të shkurtër ka arritur të zhvilloj punën dhe të krijoj një bashkëpunim të mirë, veçanërisht me brendet e njohura hotelerie në Emiratet e Bashkuara të Arabisë.

Kjo i ka mundësuar të rinjve që të rrisin diturinë dhe përvojën, por

„Në punën e deritanishme, fatkeqësisht, nuk më kanë kursyer për as edhe një barrierë të njohur apo të evidentuar në kuadër të biznesit të grave dhe vështirë është të ndash njëren prej tyre të cilën e kam përballuar më së lehti. Mund vetëm të them që më së vështiri më bie mungesa e mirëkuptimit dhe besimit ndaj biznesit të grave. Por edhe kjo si dhe të gjitha barrierat e tjera mund të tejkalohen në të njëjtën mënyrë, me këmbëngulësi dhe qëndrueshmëri në punë.“

gjithashtu të fitojnë njohuri të reja internacionale. Deri më tani, përmes ndërmjetësimit të agjencisë RHR, janë udhëzuar për punë mbi 30 aplikantë në Emiratet e Bashkuara të Arabisë, ndërkohë mbi 50 të rinj presin kontratën, kryesisht ato që kanë diplomën e Fakultetit për turizëm dhe hotelieri.

Kontribut të madh për këtë biznes me rëndësi dhe përgjegjësi, ka dhënë vajza e Verës Lucija, e cila pas kryerjes së studimeve në Zvicër, që nga viti 2010 punon për hotelet Marriot në Dubai. Satisfaksion të veçantë Vera gjen në faktin që një numër i konsiderueshëm i të rinjve, si nga Mali i Zi ashtu edhe nga rajoni, këtu sheh një sfidë të madhe dhe mundësi për krijim të një karriere të mire dhe të suksesshme.

Momenti kryesorë në karrierën e biznesit të Verës ishte mbledhja e Asociacionit të grave afariste, në të cilin ka vendosur të filloj biznesin e vet dhe të hap agjencinë turistike në Podgoricë. Njohja dhe të shoqëruarit me gratë e forta dhe të suksesshme në biznes, ka krijuar tek ajo dëshirën që të jetë pjesë e ekipit dhe të kontribuoj zhvillimin e biznesit të grave.

Arritjen më të madhe në karrierën e deritanishme, Vera e konsideron bashkëpunimin dhe nënshkrimin e kontratave të para me hotelet e Emirateve të Bashkuara të Arabisë, pastaj edhe me fakultetin për menaxhim hotelier The Emirates Academy në Dubai, i cili është Agjent i regrutimit.

Janë arritur rezultate domethënëse, si në numrin e bashkëpunëtorëve në Emiratet e Bashkuara të Arabisë, ashtu edhe në numrin e të rinjve dhe njerëzve me kualitet të cilët kërkojnë dhe shfrytëzojnë shërbimet e agjencisë RHR. Gjithashtu, duke patur parasysh që Tivari me portin e vet paraqet një vend të veçantë në kuadër të ofertës turistike të Malit të Zi, Vera e konsideron të rëndësishme angazhimin e vet në përmirësimin e kualitetit të resurseve njerëzore në këtë fushë. Këtë e dëshmon edhe fakti që studentët e Universitetit “Mediterran” Fakulteti për turizëm nga Tivari, treguan interesim të madh të punojnë dhe të specializohen praktikisht në hotelet e klasit të lartë, të cilët gjinden në njërin nga destinacionet më atraktive - në Dubai.

Balancën në mes jetës private dhe punës, Vera e arrin me një organizim të mirë, qëndrueshmëri në punë dhe me shoqërim dhe bashkëpunim me njerëz në biznes dhe të besës. Shumë të rëndësishme e ka mbështetjen e familjes e cila është reciproke. Kur bie fjala për fëmijë dhe karrierën e tyre, Vera në përgjithësi ka një shikim më të gjerë për situatën. Mendon që në shoqëri është shumë i theksuar stereotipi lidhur me rezistencën e prindërve ndaj qëllimit dhe vendimit të fëmijëve femra, që të shkollohen dhe të ndërtojnë karrierën e vet jashtë vendit dhe veçanërisht në Emiratet e Bashkuara të Arabisë. Për tejkalimin e këtij stereotipi në mënyrë të konsiderueshme ka kontribuar me shembullin e vet si prind, i cili i ka udhëzuar dhe mbështetur fëmijët e vet në rrugën e përvetësimit të diturisë dhe përvojës, përmes shkollimit dhe punës jashtë vendit, para së gjithash në Dubai.

„Sekreti i suksesit tim është kreativiteti, dashuria dhe përkushtimi ndaj familjes, punës, miqëve dhe bashkëpunëtorëve, veçanërisht të rinjve nga fusha e turizmit dhe hotelierisë.

Këshilli im për gra është...

Suksesi i konkurensës është edhe suksesi i juaj dhe njëkohësisht shansi të dalloni dhe të jeni më i mirë“.

Edhe hobi i juaj mund të shndërrohet ne biznes të suksesshëm - bëhuni të guximshme dhe tregoni se çfarë mundeni

Gordana Mijoviq
ndërmarrëse, pronare e biznesit individual artizanal „Dekupazh studio“ dhe drejtore-shë e IPP, „Vukosava Ivanoviq-Mashanoviq“



Zonja Gordana Mijoviq me profesion është mësuese e arsimit parashkollorë dhe me pozitë për shumë vite drejtoreshë e IPP „Vukosava Ivanoviq-Mashanoviq“. Në mënyrë vullnetare kryen funksionin e kryetares së organizatës komunale Kryqi i Kuq në Tivar, ndërsa dashuria e saj e madhe dhe hobi nga i cili ka zhvilluar biznesin e vet, është teknika dekupazh (Decoupage). Gordana është nënë e tre fëmijëve të rritur, dhe nga të gjitha rolet, roli më i dashur është të qenurit gjyshe. Pas kryerjes së shkollimit dhe kryerjes së funksionit si edukatore për 10 vite, ndodhej para një sfide: a të pranojë funksionin e drejtoreshës, në një veprimtari kaq të komplikuar siç është organizimi dhe udhëheqja e punëve të institucionit parashkollorë. „Duke pasur parasysh që në jetë më pëlqejnë sfidat, edhe këtë e pranova dhe tash 20 vite po e udhëheq institucionin tim. Gjithashtu, njëra ndër sfidat e mëdha për mua, ishte edhe realizimi i asaj çfarë kisha në shpirt e kjo është puna kreative si sinonim

„Sekreti i suksesit tim është përcaktimi i vizionit dhe qëllimit si dhe këmbëngulja që të arrihet deri te ky qëllim, pa marrë parasysh se në çfarë pengesash takoni. Shumë është vështirë, para së gjithash të vendoset kufiri e pastaj edhe balanca në mes jetës private dhe punës. Unë kam pasur sukses të arrijë këtë falë mirëkuptimit të madh të familjes sime, sepse shumë kohë kam „vjedhur“ nga fëmijët e mi dhe familja në përgjithësi. Gjithmonë kam pasur dorën e shtrirë për çfarëdo lloj ndihme. Komentet e tyre dhe buqetat e luleve pas çdo suksesi, më kanë dhënë fuqi të vazhdoj më tutje.“

i mirë për profesionin tim themelor. Unë kam gjetur plusin dhe minusin tim të cilat së bashku në mua përbëjnë personin i cili është realizuar në ato segmente, që gjithmonë kam dashur“, thekson Gordana.

Në momentet e duhura para të gjithëve ekzistojnë barrierat. Në angazhimin profesional barriera për te ishte mosnjohja e stafit dhe harmonizimi i vizionit të sajë të menaxhimit me atë të stafit. Megjithatë konsideron që këtë harmonizim e ka arritur sepse stafi i saj konsiderohet për staf punëtorë dhe i suksesshëm, i cili shtynë kufijtë në kuptimin profesional. Sa i përket zhvillimit të hобit të saj, marrja me teknikën dekupazh, barriera më e madhe e cila është paraqitur, para së gjithash ishte dilema: e Gordanës a është në rregull kjo që po punon dhe a do të pranohet në rrethin ku jeton. Përvoja ka treguar që dilema ishte e pa bazë dhe komentet pozitive e kanë shtyrë krijimtarinë e saj në masë edhe më të madhe. Motivi kryesorë i realizimit të hобit në biznes të vërtetë, ishte konkursi për biznesin më të mirë tek BSC Bar, kur ka vendosur të aplikoj dhe kur biznes plani i saj u vlerësua si i mirë. Atëherë u hapën edhe mundësitë e reja të rregullimit të statusit ligjor të hобit të sajë të deriatëhershëm. Produkt i gjithë kësaj ishte hapja e dyqanit artizanal „Dekupazh studio“ i cili tani me sukses ekziston në treg.

„Këshilla ime për të gjitha gratë do të ishte: që së pari të jenë të guximshme, t'u tregojnë njerëzve që i rrethojnë mundësitë e tyre dhe të kenë dëshirë të madhe të realizojnë atë çfarë kanë vendosur si qëllim dhe sukcesi do të jetë i garantuar“.

Sa i përket stereotipit në fushën e punës kreative të Gordanës, më origjinalja i përket komenteve të disa personave që, për punën e saj unike, thonë se bëhet fjalë për *“mbledhësit e pluhurit”*. Por, *“kur pastaj fitoni mundësinë të shpjegoni procesin e punës në dekupazh dhe kur ato të njëjtit shohin sa punë ka dhe sa zgjat ky proces, atëherë fitoni lëvdim që keni krijuar vepër arti“*.

Gordana thekson se arritja e saj më e madhe në planin personal, është lindja dhe edukimi i tre fëmijëve, të cilët tani janë njerëz të rritur dhe të cilët *“Kanë gjetur vendin e vet nën dritën e diellit”*. Ndërsa në aspektin profesional, para së gjithash respekti nga stafi i saj si një vizionare dhe udhëheqëse e mirë, si dhe mirënjohja e *“dekupazh studio”* si pioniere në Mal të Zi në botën e dekupazhit. Kënaqësinë më të madhe paraqet situata kur në rrugë fëmijët dhe prindërit e përshëndesin duke ia drejtuar një buzëqeshje të sinqertë dhe përshëndetje të ngrohtë.

Forcë lëvizëse ndodhet tek ne

Mirjana Babiq
ndërmarrëse, pronare e biznesit individual artizanal „Olivmont“



Zonja Mirjana Babiq me profesion është ekonomiste. E martuar, ka tre fëmijë dhe bashkëshortin dhe është shumë aktive në jetën shoqërore. Jeton në fshat, i pëlqen natyra e cila është inspirimi kryesorë dhe burim i ideve të saja.

Familja e Mirjanës posedon disa qindra rrënjë ullinj dhe prodhon vajin e ullinjve të virgjër. Gjatë marrjes me ullinj vite me radhë, ka vërejtur që për prodhuesit e vajit të ullirit, pjesën më të vështirë e paraqet realizimi i produktit final sepse blerja e vajit të ullirit është e paorganizuar, ndërsa çmimet e shitjes me shumicë janë shumë të ulëta. Ky fakt e ka shtyrë të mendoj në drejtim të prodhimit të ndonjë produkti nga vaji i ullirit dhe kështu ka ardhur në idenë që të ringjallë dhe modernizojë prodhimin e sapunëve nga vaji i ullirit. Biznesin e vet e ka regjistruar me mbështetjen e Biznes Qendrës nga Tivari. Që nga paraqitja e parë në treg, ka kuptuar që duhet të ketë kujdes për çdo detaj dhe të gjejë mënyrën që të fitojë besimin e blerësve. Për një kohë të shkurtër është dashur të krijoj imazh të një ndërmarrëse serioze dhe me kualitet. Ishte e vetëdijshme që nuk ka shumë kohë të paraqitet dhe nuk ka shumë hapësirë për gabime. Në këtë biznes e ka kyçur edhe familjen. I ka vendosur themelet e mira për dyqanin artizanal „Olivmont“ dhe sapunin nga vaji i ullirit.

„Shumë gra si justifikim për paaftësinë e fillimit të biznesit të vet, numërojnë shumë gjëra sikur: nuk mund se nuk kam para, kam familje, fëmijë të vegjël... por prapë se prapë, deshëm ta pranojmë apo jo, çdo gjë është punë vendimi dhe zgjedhjeje. Fatkeqësisht, më së lehti është të kalosh përgjegjësinë tek tjetri, por kjo nuk shkon kështu nëse me të vërtetë dëshironi të bëheni ndërmarrëse. Të kesh biznesin e vet do të thotë para së gjithash të shesësh veten, do të thotë që së pari jemi ne ato që duhet të dukemi profesionale, pastaj të besojmë në prodhimin e vet, pastaj të njohësh aftësitë e prezantimit dhe shitjes.“

Sot, me të madhe njihet në vend dhe rajon. Dashuria ndaj punës, tendenca drejt përkryerjes së përhershme dhe krijimit të prodhimit cilësor, u valorizuan me sukses me ftesën që në kuadër të shënimit të javës së ndërmarrësisë, të marrë pjesë në panairin e ndërmarrësisë në Bruksel në vitin 2010, ku fitoi çmimin si njëra ndër ndërmarrëset më të mira nga Mali i Zi. Në kuadër të panairit u krijua edhe broshura „Sekretet e suksesit“ ku produkti origjinal i Mirjanës u paraqit si shembull i mënyrës tradicionale të prodhimit, i cili nuk dëmton mjedisin natyror. Këtë moment e konsideron si pikën kryesore në zhvillimin e biznesit të vet. Përveç pjesëmarrjes së lartpërmendur në panairin e Brukselit, pikë tjetër kryesore në karrierën e saj ishte edhe bashkëpunimi me kompaninë Aman Resort, e cila drejton hotelet në Sveti Stefan. Klientët e kënaqur të cilët kanë kritere të larta, e kanë shtyrë të vazhdojë me prodhimin e produkteve sa më cilësorë. Mirjana është vizitore e rregullt e panairove, ku përveç produkteve prezanton edhe qytetin e vet, Tivarin. Gjithashtu, ajo blen vajin e ullirit nga vendasit e vet dhe me këtë kontribuon edhe zhvillimin e tyre ekonomik. Si një nga stereotipet ajo veçon të menduarit që produkti i saj është vetëm sapun për higjienë. Ka arritur të provoj që sapuni mund të jetë edhe më shumë se kjo. Sapuni në vete mund të përmbajë shumë karakteristika të një krahine dhe përveç tjerave mund të jetë suvenir origjinal. Kështu sapuni Olivmont së shpejti ka bartë shenjën e „suvenirit malazez“ dhe si i tillë ishte pjesë e dhuratës për vizitorët e ngjarjeve të ndryshme nacionale. Sapunët e firmës „Olivmont“ kanë shpërndarë aromën e vet gjer në Rusi, bile edhe në Tajvan dhe Republikën Afrikës së Jugut.

Mirjana thekson që njëra ndër barrierat më të mëdha të biznesit të Olivmont-it është konkurrenca jolojale. Do të thotë, paraqiten njerëz të cilët prodhojnë sapunë te shtëpia, nga lëndë të para jocilësore dhe pa deklaratën adekuate. Produktet e tyre për këtë

Këshillë për gra:

„Le t’ju udhëheqë ideja dhe jo dëshira për fitim. Provoni të zbuloni se ku jeni më të mirët. Nëse nuk keni sukses menjëherë, provoni prapë deri kur të gjeni gjënë e vërtetë për ju dhe mos lejoni askënd t’ju ndalojë. Vitet nuk janë të rëndësishme. Mos imitoni të tjerët. Provoni të jeni origjinale.“

arsye janë më të lirë. Shërbimet e inspeksioneve akoma nuk i japin rëndësi kësaj çështjeje, ndërsa Mirjana mendon që mënyra e keqe e prodhimit e dëmton atë dhe prodhuesit tjerë në komunitetin lokal. Këtë barrierë ajo e tejkalon me promovim sa më të mirë të produkteve të veta dhe me edukimin e blerësve mbi vet produktin si dhe me faljen e disa mostrave, ashtu që tregu të mund të vërejë dallimin në kualitet. Sekret i suksesit të Mirjanës është dëshira të mësojë dhe të shkëmbejë përvojat. Kah fundi i viti 2011 ishte ftuar të merrte pjesë në realizimin e projektit „Rrjeti kombëtar i këshilltarëve për gratë ndërmarrëse në Mal të Zi“. Si njëra ndër këshilltares, vetëmohueshëm ka ndarë dituritë dhe eksperiencat dhe i ka motivuar ndërmarrëset e tjera për zhvillim të biznesit dhe udhëheqje të suksesshme të biznesit. Është anëtare e Asociacionit të grave afariste në Mal të Zi, Shoqatës së grave ndërmarrëse të Malit të Zi, Shoqatës së grave të iniciativës Adriatiko-Joniane. Mirjana thekson që për një biznes të suksesshëm, është shumë me rëndësi të lidhesh me ndërmarrësit e tjerë, sepse në këtë mënyrë vjen deri te shkëmbimi i ideve dhe përparimi i biznesit.

Sekreti i vogël i suksesit të madh/premtioni më pak dhe jepni më shumë



*Millanka Gjuranoviq dhe Bilana Dabiq
Bashkëpronare e agjencisë turistike „Ave tours“*

Angazhimi profesional i zonjës Millanka Gjuranoviq është turizmi. Tash njëzet vite punon në industrinë e turizmit. Në fillim, si edhe pjesa më e madhe e angazhimit të saj, ishte e punësuar në agjencinë turistike e cila ka vepruar në territorin e Jugosllavisë së dikurshme, çfarë ishte një përvojë me vlerë. Pas disa vite pune në fushat e tjera ekonomike, u hap mundësia drejt së cilës ka anuar gjatë gjithë kohës. Kështu Millanka iu kthye punës në turizëm dhe në një agjenci turistike dhe me idetë e saja në biznes u lidh me kolegen e saj Biljana Dabiq, gazetare e cila vite me radhë punon dy punë. I bashkuan ambicionet në punë, diturinë, përvojat dhe së bashku erdhën në idenë që të hapin agjencinë e tyre. Dituria e fituar dhe vitet e përvojës sot i zbatojnë në agjencinë private „Ave tours“, të cilën në partneritet e hapën para katër viteve.

Që në kohën e zgjedhjes së profesionit të ardhshëm, Biljana ka pasur dëshirë të bëhet gazetare. „Lehtësia e të shprehurit, perceptimet më të qarta për atë çfarë ju intereson, stimulim i përherëshëm që të jeni në rrjedha të ngjarjeve, nevoja për dituri të reja dhe dinamika e punës, e karakterizojnë gazetarin dhe në përgjithësi këto karakteristika janë në balancë me natyrën time“, thekson Bilana. Gjatë raportimit shumëvjeçarë për

„Të dy punët kanë sfidat e veta, mendojë që do të shkruaj deri sa të ekzistoj, ndërsa biznesi privat kërkon që të jeni tërë kohën në kondicion pune dhe në fund bartë thelbin e vërtetë – keni sa keni fituar dhe nuk vareni nga tjerët“.

gazetat ditore, Bilana për pesë vite ka punuar për revista të specializuara për turizëm në Mal të Zi e rajon dhe kjo i ka mundësuar që ta njoh këtë fushë nga shumë aspekte. Puna në agjencinë turistike, të cilin gjithashtu e ka përjetuar si kreative, dinamike dhe fitimprurëse, e ka nxitur të fillojë biznesin e vet privat. *„Me praktikën e duhur dhe vullnetin e fortë, të sigurojë ekzistencën. Nuk e mohoj tezën që jeta është regjisori më i mirë. Jeta ka skenuar që për shumë vite të punoj dy punë, jo vetëm për arsye të ambicionit tim por edhe për arsye të statusit si prindër i vetëm. Në kohën kur shpenzimet jetësore u rritën bashkë me rritjen e fëmijëve të mi, të cilët në atë kohë ishin në prag të studimeve, pronarët e agjencisë turistike ku kisha punuar, vendosën ta mbyllin zyrën në Tivar. Pak para këtij akti të papëlqyeshëm, në epilogun e mbylljes së zyrës, në skenën e jetës sime profesionale u shfaq Millanka Gjuranoviq, bashkëpunëtorja ime. Vendosëm që punën tonë ta ndërtojmë së bashku me gjithë diturinë dhe eksperiencat tona dhe kështu themeluan ndërmarrjen IN-Bar, në kuadër të cilës vepron agjencia turistik Ave tours. Nuk i pëlqej plagjiatorët, por me të vërtetë edhe neve vitet na filluan me muajin janar që nuk është kohë karakteristike e hapjes së agjencive turistike në bregdet. Furtuna e mbylljes së agjencisë ku punuam të dyja, na ka nxitur, apo na ka shtyrë (siç shpesh dëgjohet në territorin e Ballkanit), të fillojmë biznesin e vet“*, thekson Biljana.

Fillimi i biznesit privat nuk ka ardhur papritur si ide, sepse kësaj i kanë parraprirë analizat, këshillimet, kalkulimet...“*Për mua, çdo biznes serioz nuk guxon të fillohet „aksidentalisht“. E vlerësoj shumë kur gjërat kuptohen dhe përkushtimin ndaj tyre“* thekson Bilana. Edhe gjatë kohës kur kanë punuar në agjenci, pronari i së cilës ishte personi i tretë, Millanka dhe Bilana kanë menduar mbi këtë ide dhe mbi përparësitë dhe mangësitë e saj. Ishin të përgatitura për të ashtuquajturat anët negative të biznesit.

„Barriera ka gjithmonë, por çdo pengesë e tejkaluar është një lloj fitoreje. Sot barriera në maje të piramidës është kriza ekonomike e cila rezulton me jolikuiditet absolut, kështu që me punën me të cilën merreni është e nevojshme paralelja „gjimnastika e sistemit mendor“ që të tejkaloni borxhet e të tjerëve, të cilat në kushte normale absolutisht nuk është dashur të ishin çështje analize. Megjithatë, fatkeqësisht, barriera më e madhe janë njerëzit e paditur dhe sipërfaqësor të cilët paditurinë e fshehin me „frustracione“ dhe humbje në punën që kryejnë, e cila në mënyrë negative manifestohet në sistemin tonë. Në çdo veprimtari është kënaqësi të takosh profesionistë të cilët e njohin mirë punën e vet“.

„Barriera e parë të cilën duhet vetë me vete ta tejkaloni në punë, është që nuk keni kohë të lirë. Kur turisti, klienti i agjencisë turistike ka nevojë për bileta avioni, hotel – unë nuk shikoj sa është ora. Gjithsesi, në praktikë nuk varet çdo gjë nga agjencia turistike – por qetësia dhe qëndrueshmëria gjithmonë në fund paguhen. Vullneti dhe këmbëngulja sjellin sukses“.

Këshillë për gra:

„Punoni punën që ju pëlqen. Nëse merreni me diçka që nuk ju plotëson, drejtohuni nga puna që ju pëlqen - dëshirat edhe mund të plotësohen. Duhet të jeni optimist, por mos dilni nga kornizat reale“.

Këto dy ndërmarrëse e duan punën në agjencinë turistike, e përjetojnë si punë kreative, dinamike dhe interesante. Nga vendi i punës, për arsye të natyrës së punës, komunikoni me njerëzit nga e gjithë bota, bëni negociime të udhëtimit, organizoni udhëtime turistike. Atëherë ju vijnë turistët e kënaqur, plot me mbresa të bukura dhe eksperiencat e cilat duken sikur vet t'i përjetoni. Puna në një agjenci turistike të bën më fisnik dhe hap mundësi të reja përmes njohjes me shumë njerëz. *“Është bukur kur keni mundësi që njerëzve që njihni por edhe atyre të panjohurve, t'iu rekomandoni si dhe ku t'i kalojnë pushimet, me çfarë t'i plotësojnë pushimet verore, pushimet dimërore, ditët e lira, ndërsa kënaqësia e tyre përcjell tek unë energjinë pozitive. Nga ana tjetër arritja më e madhe në punë, është mundësia që në këtë kohë të mund të jetoni nga puna e vet”,* thekson Millanka. Si nënë, arritjen

më të madhe i konsideron fëmijët e vet dhe është e lumtur që falë punës dhe përpjekjeve të saj, është në gjendje t'i shkollojë dhe t'i udhëzojë në rrugë të drejtë dhe pastaj t'i kontribuojnë jetës modeste të familjeve të veta. *“Kur do diçka, çdo gjë mund të arrihet. Jam e lumtur që kam mbështetje dhe mirëkuptim nga familja ime dhe kjo balancë është e plotë, pasi në zyre nuk kam tensione por kam marrëveshje dhe plotësim kolegjial”* thotë Millanka. Ndërsa Bilana thekson që në vendosjen e balancës në mes jetës private dhe punës, e ka ndihmuar shumë *“orari fleksibël i punës”*, duke i lënë mundësinë që të punojë nga shtëpia. Shumë shpesh i ka ndodhur që paralelisht me shkrimin e reportazhit, të *“zihet darka”*. Përmbushjen e misionit të punës së agjencisë turistike, të dyja e konsiderojnë si kontribut ndaj komunitetit lokal - ofrimin e ofertave turistike, kulturore dhe përmbajtjes së komunitetit lokal për turistët. Nga ana tjetër bashkëvendësi i mundësojnë që të njohin botën në mënyrën më të rehatshme, të udhëtojnë me kosto të ulët, organizojnë bujtjen në destinacionin e kërkuar... Bilana kontributin e vet në fushën e gazetarisë e sheh në mundësinë e informimit të publikut dhe regjistrimin e ngjarjeve me rëndësi, të cilat dëshmojnë për kohën në të cilën jetojmë dhe përbëjnë kronikën e hapësirës së caktuar.

Këshilli për gra:

„Asgjë nuk është e shtrenjtë sa të bësh diçka në mënyrë të gabueshme! Investimi në dituri nuk mund të jetë investim i gabueshëm, dhe duhet të dijsh të njohësh edhe nga kush mund të mësosh. Të gjitha vendimet para se të realizohen duhet të kalojnë nëpër proces të të menduarit. Në sistemet e rregulluara njerëzit ndërrojnë disa punë gjatë jetës. Kini guxmishmëri dhe zhvilloni aftësitë që të krijoni sistemin në të cilin do të mund të punoni atë çfarë ju pëlqen dhe nga e cila mund të jetoni. Që të arrini këtë, punoni në vete çdo ditë sepse vleni aqë sa dini“.

„Sekreti i suksesit tonë:

Virtytet efektive të cilët i posedojmë të gjithë duhet njohur dhe zhvilluar me qëllim të arritjes më të mirë. Kur e kuptoni që zinxhiri është aqë i fortë sa edhe hallka e sajë më e dobët, keni njohur një segment të rëndësishëm të biznesit në turizëm i cili bazohet në punën ekipore. Autoriteti nuk vendoset por arrihet, mendimet dhe sygjerimet konsiderohen dhe shpesh respektohen. Bashkëpunorët e mirë dhe të besueshëm, besimi reciprok, puna dhe rendi janë themelet stabile për sukses. Sekreti i vogël i suksesit të madhë në turizëm – premtori pak, dhe jipni më shumë”.

Besoni në veten tuaj dhe asgjë nuk mund t'ju demoralizojë

*Danica Dada Dobërkoviq
ndërmarrëse, pronare e agjencisë për
kontabilitet „DADA“*



Zonja Danica Dobërkoviq lindi në Lovqencë me 1949. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në Tivar. Fakultetin filozofik në Beograd, dega pedagogji. Drejtimin Andragogji (edukim dhe arsim i të rriturve) e regjistroi në vitin 1968. Rrethanat e ndryshme ndikuan që profesionin të cilin e ka pëlqyer në rini të mos bëhet zanati i saj jetësor. Pas dy viteve studim dhe regjistrimit të vitit të tretë, vendosi të ndërprente studimet dhe të kthehet në vendlindje, në Tivar. Në këtë periudhë të jetës së saj, i ka dhënë rëndësi kthimit tek rrënjët e saja dhe themelimit të familjes. Mendon që kthimi në Tivar ishte momenti vendimtar në jetën e sajë. Kishte vetëm 21 vjet, kishte ndërprerë studimet, ishte martuar dhe kishte nisur martesën me bashkëshortin i cili gjithashtu nuk punonte. Situata në të cilën gjendej, dëshpërimi i prindërve të cilët nga ajo kishin pritur të përfundonte studimet dhe pastaj t'i përkushtohej familjes, e kanë shtyrë që të provojë në rastin e vet „që edhe të rinjtë mund të punojnë dhe vet të krijojnë kushtet për jetën e tyre“. Shumë shpejt pas kthimit, në vitin 1972 punësohet në firmën „Ndërmarrja komunale-banesore“ si kontabiliste. Kjo ishte koha kur nuk kishte kompjuterë dhe as kalkulatorë të avancuar, kështu që çdo gjë llogaritej me dorë. Me rëndësi ishte të dëshiroje dhe të dije të punosh me numra. Kurrë nuk kishte menduar për kontabilitetin, si profesionin e saj jetësorë, por gjatë punës shumë e ka dashuruar dhe ka arritur të realizohet në këtë

Këshillë për gra:
„të keni një qëllim dhe të besoni në vetëvete“!

punë. Përveç punës në ndërmarrjen shtetërore, kur u paraqitën kushtet e volitshme, nisi biznesin e vet privat dhe regjistroi agjencinë për kontabilitet „Dada“. Vendimin mbi themelimin e biznesit privat e ka marrë së bashku me familjen. Arsyeja ishte që ajo dhe burri i saj kanë dashur t’iu sigurojnë fëmijëve të gjitha ato gjëra që vetë ato nuk i kanë pasur kur ishin të rinj.

Në këtë periudhë, Danica ishte njëra nga gratë e rralla të cilat kanë hapur biznesin e vet privat dhe shpesh ka hasur në stereotipe ngjashme me mendimin që, dikush që punon në ndërmarrje shtetërore nuk duhet të ketë firmën e vet private, sepse „*fiton mjaftueshëm për bukë*“. Ishin këto kohëra tjera. Barrierat dhe stereotipet e ngjashme shumë, shpejt i ka tejkaluar sepse është ambicioze si në jetën private ashtu edhe në punë. Gjithmonë është udhëhequr me moton që duhet të besoj në vete dhe atëherë asgjë nuk mund ta demoralizojë.

Në periudhën kur punonte dy punë, puna e saj kërkonte të hiqte dore nga shumë gjëra, kështu që sot suksesin e saj më të madh e konsideron atë që ka arritur të udhëheq një jetë familjare të harmonizuar dhe të rrisë dy djem, të cilët tashmë janë bërë njerëz familjarë. Për Danicën familja është faktori kryesorë i suksesit. Me familje ka marrë vendime të rëndësishme; nga familja ka fituar mbështetje dhe ndihmë kur ka pasur nevojë. Mendon që rol të madh në mbajtjen e kësaj harmonie në jetën e saj, kishte vendosja e mirë e balancës në mes të jetës private dhe biznesit. „*Jeta private është diçka që duhet ndarë nga puna. Ditën kur asgjë nuk ju shkon në punë, kurrë mos e bini me vete në shtëpinë tuaj dhe anasjelltas*“, thotë Danica.

Kontributin e vet ndaj komunitetit lokal, gjithmonë e ka dhënë përmes relacionit të drejtë ndaj komunitetit, promovimit të qytetit ku jeton dhe përmes (siç thuhet në zhargonin e kontabilistëve) „*pagimit të rregullt të obligimeve*“. Mundohet që relacionin e saj ndaj punës: saktësinë, precizitetin dhe ndërgjeshmërinë në punë, t’iu përcjellë punëtorëve të vet dhe klientëve. Gjithmonë me vetëmohim ofron mbështetje dhe këshillime për të rinjtë, të cilët dëshirojnë të fitojnë eksperiencë dhe të punojnë që të sigurojnë një jetë më të mirë.

Sot, pas shumë vite pune, Danica udhëheq një biznes të suksesshëm, ku kualitetit i punës së saj paraqet rekomandimin më të mirë për klientët, ndërsa kënaqësia e të punësuarve të saj është dëshmi që ka arritur t’iu përcjell të tjerëve diturinë dhe dashurinë ndaj punës. Pas shumë viteve, edhe më tutje lufton ndaj stereotipeve, pasi që tani është në pension dhe akoma merret me biznes privat. Tani stereotipet nuk i përjeton si barriera por si situata të cilat gjithmonë i zgjidhë në mënyrë interesante. Të gjithëve që dëshirojnë të realizohen në fushën e biznesit privat, iu rekomandon që të vendosin qëllimin e vet dhe të besojnë në vetvete - atëherë edhe sukseksi do të vijë!

Fuqia është në biznesin familjar



Vesna Orllandiç
ndërmarrëse, pronare e „IN SPE“ Sh.P.K

Zonja Vesna Orllandiç lindi në Tivar me 21.03.1959. Ka dy djem: Sërgjanin dhe Nikollën dhe vajzën Milicën. Me bashkëshortin Vllastimirin, në vitin 1992 hapi firmën IN SPE sh.p.k Tivar. Ndërmarrja me sukses punon tash 22 vite. Familja është krejtësisht e angazhuar në punë kështu që edhe fëmijët e Vesnës pas kryerjes së fakultetit filluan të punojnë në biznesin familjar dhe të kontribuojnë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. IN SPE sh.p.k njihet si e vetmja kompani prodhuese në Mal të Zi me çertifikatë organike të BE-së, çertifikatën nacionale organike dhe bartëse e standardit HACCP dhe ISSO 22000.

Vesna në rini është marrë me sport dhe ka promovuar stilin e shëndoshtë të jetës, gjë që dukshëm ka ndikuar në zgjedhjen e saj të mëvonshme - që të merret me punën e cila është ngushtë e lidhur me natyrën – korrje, mbledhje, përpunim të bimëve organike të egra, mjaltit edhe prodhimeve të tjera nga bleta dhe prodhimeve të produkteve të gatshme nga këto lëndë të para. Personi i cili më së shumti ka ndikuar që të hyjë në kësi lloj biznesi dhe të hap farmacinë e bimëve “Bio shop ELIKSIR” (në vitin 1992, në periudhën e trazirave të ndryshme në ish-shtetin e atëhershëm e që nuk ishte aspak e lehtë), ishte bashkëshorti i Vesnës. Fillimi i kësaj lloji pune dhe prodhimit, në atë kohë ishte mjaft i panjohur. Megjithatë, këmbëngulja, puna e madhe dhe mbajtja konstante e kualitetit, kanë

„Arritjen më të madhe e paraqet familja e gëzueshme dhe e suksesshme dhe si rezultat i kësaj kompania e suksesshme familjare“.

ndikuar që produktet të bëhen të njohur si në tregun e vendit ashtu edhe jashtë vendit. Brendi i kompanisë IN SPE sh.p.k – prodhim i natyrës, është i mbrojtur nga Enti për pronësi intelektuale, sikur dhe produktet të cilat i ofron kjo kompani. Familja e Vesnës ka luftuar vet për mbijetesë dhe nuk është dorëzuar as kur ishte më së vështiri.

Këshillë për gra:

„Mos u dorëzoni, jini luftëtare dhe të gatshme për shumë barriera dhe vështirësi në punë. Këmbëngulja dhe qëndrueshmëria e juaj do të sjellin suksese“.

Moment vendimtar në zhvillimin e mëtejshëm të biznesit, ishte informata kthyesë pozitive, nga tregu për produktet e IN SPE si dhe reklama „nga goja në gojë“ nga konsumatorët. Në punën e vet, Vesnën më së shumti e ka motivuar fitimi i çmimeve dhe njohjeve në panairët e ndryshme ndërkombëtare (Novi Sad, BIOFEST, Suboticë, Gjenevë), rritja e vëllimit të prodhimit, si dhe fakti që anëtarët e rinj të familjes e gjetën veten në këtë punë. IN SPE sh.p.k. punëson 10 punëtor dhe ekziston tendenca e punësimit të mëtejshëm. Në panairët e shumta ndërkombëtare Vesna ka paraqitur jo vetëm kompaninë, por edhe qytetin dhe shtetin nga i cili vjen. Është munduar që produktet e saja të dallohen nga të ngjashmit në treg, përkatësisht me fitimin e çertifikatës organike UE dhe HACCP dhe ISSO 22000. Sekretet e suksesit të Vesnës janë përfitimet e biznesit familjar. Ajo konsideron që brenda familjes për çdo gjë mund të arrini marrëveshje dhe të keni sukses, kur të gjithë anëtarët bashkojnë mundin, aftësitë dhe diturinë.

Nga blegtoria mund të jetohet

*Voska Stefanoviq
Fermere*



Voska Stefanoviq ka 60 vjetë. Jeton në Sutomore dhe merret me kultivimin e dhive. I do kafshët dhe kujdeset për to. Familja e Voskës tradicionalisht është marrë me blegtori dhe Voska si e re me vite ka punuar punë sezonale. Në momentin kur ka kuptuar që punën që bënë në vëllim më të vogël dhe për nevoja të sigurimit të qumështit dhe prodhimeve nga mishi për shtëpinë e vet, mund ta zgjerojë edhe për nevoja të tregut e kështu të rrisë të ardhurat dhe të sigurojë një jetë më të mirë për veten dhe familjen e vet, vendosi që seriozisht t'i përkushtohet kësaj çështjeje. Nga ana tjetër, do të ndihej më e sigurt sepse do të punonte punën në të cilën ka përvojë, por më seriozisht, në vëllim më të madh dhe me qëllim të qartë i cili do t'a udhëhiqte. Duke analizuar të ardhurat e familjes dhe nivelin në të cilin kishte pasur dëshirë të rris vëllimin e prodhimit, konstatoi që me një angazhim të madh në këtë punë, njeriu mund të jetë i kënaqur dhe të sigurohet financiarisht. Tani Voska prodhon ushqim ekologjik dhe të shëndoshtë - djathë dhe, qumësht dhe mish. Ka filluar me kultivimin e katër dhive dhe pastaj me kohë ka rritur numrin në kope dhe tani ka shtatëdhjetë dhi. Duke marrë në konsideratë faktin që fëmijët janë bërë të pavarur dhe që kanë punët e vet, në punë e ndihmon vetëm kunata. Ato të dyja punojnë dhe i kryejnë të gjitha obligimet lidhur me kultivim, pastaj prodhojnë qumështin, djathin


„Puna me të cilën merrem kërkon shumë dhe është e vështirë, por vullneti dhe këmbëngulja në fund shpaguehen dhe rezultatet gjithsesi ju gëzojnë“.

dhe mishin. Voska me kohë ka menduar për plasmanin e produkteve të qumështit dhe mishit. Duke marrë në parasysh konkurrencën në Tivar dhe standardin më të mirë në qytetin fqinjë, në Budva, ka vendosur që Budva të bëhet tregu i saj kryesorë. Blerësit kryesorë janë hotelierët në Budva dhe nuk ka problem me shitjen e prodhimeve. Është e kënaqur me profitin e realizuar, veçanërisht gjatë sezonit.

Interesant është fakti që Voska kurrë nuk ka marrë hua, por për zgjerimin e kopesë ka shfrytëzuar kursimet e veta, kryesisht të fituara me këtë punë. Si moment fatkeq gjatë viteve të marrjes me kultivimin e dhive, ajo thekson situatën kur rrufeja ka goditur në kope dhe i ka mbytur disa dhi. Me rastin e kësaj fatkeqësie, ka fituar ndihmë simbolike dhe ka vazhduar më tutje. Voska thekson se e kontribuon për komunitetin lokal me vet prodhimin e produkteve dhe ofrimin e ushqimit ekologjik dhe të shëndoshtë. Sekretin e suksesit të sajë është dashuria ndaj punës të cilën e punon dhe angazhimi i madh. Kjo punë kërkon kujdes konstant, duke lejuar vetëm që dikush për një kohë t'ju ndërrojë në punë, sepse punët që duhet kryer, nuk mund të presin. „Por nëse jeni të gatshëm, ju pëlqen puna që e bëni dhe jeni të vetëdijshëm që puna është vetëm e juaja dhe që vetë e krijoni dhe e udhëhiqni me vendimet e veta, me siguri do të shpërbleheni me sukses“, thekson Voska.

Jini aktive në shoqëri dhe ndihmoni familjen tuaj dhe komunitetin lokal

*Senada Ramusheviq
fermere*



Zonja Senada Ramusheviq jeton në Ostros. Me bujqësi merret që në fëmijëri, për nevoja të familjes. Është e martuar dhe ka dy fëmijë. Kultivon perime, gështenja, ullinj, përkatësisht çdo gjë që është karakteristike dhe që rritet me sukses në vendin e saj, por merret edhe me blegtori, kultivim të lopëve dhe deleve. Përveç këtyre, Senada është shumë e suksesshme edhe në thurje me grep, që paraqet hobin e saj të cilën e praktikon në çdo moment të lirë. Punon të ashtuquajturën “qëndisje të Ostrosit” e cila me dukjen e vet, tregon mjaft për angazhimin dhe kohën që duhet t’i kushtohet për ta punuar.

Është shumë komunikative, e shoqërueshme, e gëzueshme dhe aktive. Është kryetare e organizatës së re joqeveritare, përmes së cilës në bashkëpunim me gratë e tjera nga Ostrosi planifikon të promovojë produktet vendase dhe artizanatet. Edhe pse me modesti thekson që “nuk ka kryer shumë shkollë”, Senada është dhe shumë ambicioze. Ka ndjekur kurset për aftësi kompjuterike dhe puntorinë për punime me teknikën dekopazh, ku u tregua shumë e suksesshme. Pas puntorisë, ka përgatitur produkte të punuar me teknikën e posa mësuar në panairin e artizanateve. Me mbështetjen e Biznes Qendrës, të njëjtat i ka promovuar në panairin e artizanateve në Tivar dhe Podgoricë. Planifikon që edhe në të ardhmen të ndjek panairët dhe manifestimet e tjera dhe përmes tyre të promovojë mundin e duarve të vet dhe vendin e vet. E ka vërejtur rëndësinë e kyçjes në projekte të ndryshme dhe programe për mbështetje, kështu që në kuadër të një projekti, ishte në vizitë

studimore në Banja Llukë dhe Sarajevë. Qëllimi i vizitës ishte njohja me gratë në biznes nga këto vende dhe shkëmbimi i përvojave. Me këtë rast, së bashku me pjesëmarrëset e tjera ka vizituar fabrikat që prodhojnë vaj kungulli, çips nga molla, sera të ushqimit organik, etj.

Duke pasur parasysh që Senada vjen nga një vend ku veçanërisht janë të rrënjosura botëkuptimet konservative, në fillim ndaj saj kanë treguar mosbesim. Megjithatë, ajo që nuk iu ka dhënë rëndësi këtyre gjërave, por e ka shfrytëzuar rastin që të zgjerojë horizontet e saja. Nuk ishte tipike për një grua nga fshati të ndjek kurset, të shkojë në vizitë studimore dhe të hap me gratë e tjera OJQ-në; që në mbledhjen e hapur të flas para këshilltarëve për kërkesat e caktuara dhe të luftojë për të drejtat e saja. Së shpejti edhe komuniteti lokal ka vërejtur përparësitë e këtyre aktiviteteve. Angazhimi i saj ka kontribuar për informimin më të mirë të pushtetit lokal mbi nevojat e grave nga Kraja si dhe mbi mënyrat e reja që të përmirësohet jeta në Ostros.

Marrja me bujqësi dhe blegtori është traditë e Ostrosit, kështu që edhe Senada e ka pranuar këtë si zgjedhje të vetme. Megjithatë, konsideron që jeta në qytet është shumë më komfore dhe dy djemtë e sajë i udhëzon kah shkollimi dhe jeta në mjediset urbane, vetëm për arsye praktike siç janë: largësia, qarkullimi i dobët i transportit, probleme me furnizim me ujë dhe të ngjashme. Për vete thotë që krahas kësaj, ajo e ka gjetur veten në këtë lloj jetese dhe veprimtarie, por që edhe më mirë do të ishte sikur Ostrosi të kishte transport publik të organizuar deri në qytet dhe më shumë ujë. Atëherë edhe prodhimtarinë e vet kishte mundur ta çojë një në nivel më të lartë dhe të plotësojë nevojat e tregut më të gjerë, por edhe ta realizojë në mënyrë më të lehtë. Senada mendon jo vetëm për perspektivat personale, por edhe për interesin e komunitetit të Ostrosit dhe thekson: *“Në rast të infrastrukturës më të mirë, gratë nga këto vende me kënaqësi do të lidheshin dhe së bashku do të punonin punë të vlefshme, sepse puna jonë individuale në këto kushte nuk shpërblehet mirë”*. Të gjithë grave iu rekomandon që të jenë aktive në shoqëri, të besojnë në aftësitë e veta dhe të luftojnë për të drejtat dhe qëllimet e tyre sepse pas kësaj, suksesi duhet të vijë.



Publikimi „Gratë që i lëvizin kufijtë- shembuj të praktikave të mira në komunën e Tivarit“, është pjesë e projektit „Gratë e fuqizuara-Shoqëria më e pasur“ të cilën e implementon Biznes Start Qendra Tivar në bashkëpunim me Komunën e Tivarit dhe Ministrinë për të drejtat e njeriut dhe pakicave në Mal të Zi. Qëllimi i këtij publikimi është të paraqes gratë që me aktivitetet e tyre i lëvizin kufijtë në sferën shoqëro-politike, kulturoro-arsimore dhe ekonomike në Komunën e Tivarit.

Pregaditja e këtij publikimi finansohet me mbështetjen e popullit amerikan 2013 DEMOCRACY COMMISSION SMALL GRANTS, U.S. Embassy Podgorica, Public Affairs Section.